



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 12 MARS 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 12.
MARTA 2009. GODINE

MARS – MART
2009

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetari i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar Kryeministër,
Zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotshme. I hapim punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Konstatoj se në sallë janë 93 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotshme plenare.

Fillojmë me rendin e ditës:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 26 shkurt 2009,

Deputetja Gjylnaze Syla e ka kërkuar fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!
Lidhur me pikën e parë, unë i kam disa vërejtje në procesverbal, në faqen 41 dhe 81, por do të punoj me administratën për ta rregulluar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, vërejtjet nuk qenkan në procesverbal po në transkript. Faleminderit!
Fjalën e ka kërkuar deputeti, Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri Kryetar,
Unë lutem që, së paku në tekstin e diskutimeve të mia të korrigjohet përemri afirmativ “zotëri”, unë e përdori kurdo edhe kudo “zotëri”, jo “zoti”. Prandaj, s’kam të drejtë për të kërkuar për të tjerat, po së pakut unë ashtu e përdori dhe me qenë se gabimisht shkruhet “zoti”, unë kërkoj nga administrata ta korrigjojë, ta bëjë “zotëri”, “zotëri”, “zotëri”, kur është femra, “zonjë” ose “zonjushë”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë nëse ka defekt, regjia, mjeshtrit e tyre le t’i rregullojnë.

A ka ndonjë vërejtje tjetër? Nuk ka.

Konsideroj se me vërejtjet që do t’i ketë parasysh administrata për transkript, konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 26 shkurt 2009.

Pika e dytë e rendit të ditës është:

2. Koha për pyetjet parlamentare

Ne i kemi një varg pyetjesh, por nëse më lejoni, të fillojmë me pyetjet për ministrin Nenad Rashiq, janë dy pyetje, për shkak se ka një aktivitet zyrtar. A mund t’ia fillojmë me këto dy pyetje? A jeni dakord? Kush është “për”? Faleminderit! “Kundër” s’ka.

Pyetja e 18-të, deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq.

Deputet Smaka, mund ta parashtroni pyetjen!

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri Kryetar,
Auditorium i nderuar,

Pyetja konsiston në këtë: Pyetje kuvendore për përgjigje gojore, përkitazi me pezullimin e implementimit të kontratës kolektive. Shpjegimet, ju lutem, edhe objektivat për implementimin e kësaj kontrate që është një dokument tepër i rëndësishëm për punë, marrëdhënie pune. faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Gospodine predsedniče,
Poštovani gospodine premijeru, zamenice premijera,
Kolege ministri,
Dame i gospodo, narodni poslanici,
Poštovani gospodine Smaka,

Što se tiče kolektivnog ugovora koji je bio potpisan, ja pre svega moram da vam kažem da tripartitni Savet koji je postojao ranije, sad je transformiran u Savet ekonomiko – social, što bi značilo što bi značilo da pose 4 godine, taj savet je ponovo profunkcionisao, i mi ćemo... kolektivu vor. Ja znam da se ne ispunjavaju svi delovi tog ugovora, ispunjava se samo onaj deo od tri meseca, plaćenom za trudničko bolovanje, i mi smo nošeni time, ne ispunjavanjem tog kolektivnog ugovora, da uradimo još jednu obnovu tog samog ugovora, da zajedno sa našim socijalnim partnerima nadjemo način kako možemo napraviti ugovor, koji može biti implementisan u društvu. Jer, znate i sami, da generalni razlog ne ispunjavanja ugovora je bio taj nedostatak finansijskih sredstava, odnosno limitiran budžet, tako da ćemo ubuduće nastojati da u tom kolektivnom ugovoru, da u ovom postojećem uradimo još jednu analizu, još jednu obnovu tog ugovora, da vidimo šta je ono što možemo realno ispuniti. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër! Deputet, a ke pyetje shitesë?

RIZA SMAKA: Rashiq i nderuar, do të kisha pyetur për afërsisht, Ministria kur llogaritet që do të bëhet kjo punë tepër e rëndësishme për këtë sferë shoqërore delikate, do të thotë objektivi programor i mundshëm apo jo, mos të bëhet kjo do bëjmë, do të përpiqemi, nastojacëmo, a e di, se kjo po i bie përpjekje që mund të mos realizohen kurrë. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Minstër, e keni fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Gospodine Smaka, mi faktički sutra imamo na dnevnom redu Vlade Predlog ili Udhëzimi administrativ, koji treba da reguliše načine kako ćemo odrediti socijalno-ekonomomske predstavnike u tom odredjenom savetu. Znači, mislim da smo na početku završetka tog jednog, možda organizovanije saradnje sa svim partnerima, koji bi trebali biti uključeni u tom Socijalno-ekonomskom savetu ili u tom socijalno-ekonomskom dialogu. Vlada apsolutno shvata, i Ministratstvo, da je to jedan vrlo bitan akt, jedan vrlo bitan pravac, tako da ćemo sa posebnom pažnjom i posebnom

odgovornošću pratiati svaki dalji razvoj i uložiti sve naše znanje da to uradimo na način na koji će biti najbolje funkcionalan za društvo Kosova.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër! Përsëri deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq.

RIZA SMAKA: Pyetje kuvendore për përgjigje gojore, konform me nenin 26, paragrafi 2 të Rregullës së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës përkitazi me shkallën enorme të papunësisë në vendin tonë. Në vendin tonë, sipas të dhënave zyrtare, sepse nuk kemi mjerisht statistikore, shkalla e papunësisë është 43% ose 334.598 veta. Unë mendoj se kjo është e ulët në krahasim me atë reale, por në bazë të të dhënave që i kam, siguria i kam në fusnotë, kjo shkallë. Ky është një problem i madh. Si e vlerëson, ne e dimë që ministria nuk i punëson, por politikat e punësimit çfarë janë që mund të prezantohen, në mënyrë që të valorizohen edhe nga opinioni. Ju faleminderit shumë!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsjedice!
Poštovani poslaniče Smaka,

Kao što znate, svi smo toga svesni da je nezaposlenost jedan od velikih problema našeg društva i mi u Ministarstvu stvarno pokušavamo različitim projektima da tu nezaposlenost smanjimo. Mi imamo odredjene rezultate, s tim što znam da to još nije dovoljno. Svesni smo toga, ali to je, složiteće se, vrlo tesno povezano sa ekonomskim razvojem na Kosovu. Znači ne možemo zapošljavati veliki broj ljudi, ako je ekonomski rast usporen. Mi sada, kao Ministarstvo, već smo napravili jedan drafat, nacrt strategije, nacrt jednog strateškog dokumenta, koji će biti prevashodno usmeren za zapošljavanje i profesionalno osposobljavanje. Verovatno znate i sami, ja ću dati jedan primer možda, jedan stari primer iz Japana, kada je posle Drugog svetskog rata, japanska privreda obnovila samu sebe samo za nekih 10 ili 15 godina. Na žalost, mi nismo japanci u ovom slučaju, ali možda kroz edukaciju, profesionalno obučavanje možemo dostići u određenom vremenskom roku jedan značajan uspeh. Prema tome, ono što smo mi radili zadnjih godina, samim tim i u toku perioda od 2001. do 2008., Ministarstvo je ukupno uspešno da uposli 44.919 onih koji su tražili posao, dok u vremenskom periodu 2002.-2008 profesionalno su obučeni 20.554 ljudi, s obzirom da se, moram da kažem, nedovoljno sredstava ulaže u taj fond za profesionalno obučavanje, što u kontretnijim iznosima godišnje je 100 hiljada euro. Mislim da i taj progres koji smo ostvarili značajan. Opet, još jednom kažem, s obzirom koliko je sredstva uloženo.

Naglasicu vam nekoliko projekata koji su u toku, koji su bitniji: sa UNDP, recimo sa UNDP imamo jedan projekat koji se zove Aktivni program tržišta rada za zapošljavanje mladih. Taj projekat je financiran od strane Vlade Norveške. Takodje, drugi projekat koji imamo u saradnji sa Federalnim centrom za zapošljavanje u Nemačkoj, je zapošljavanje sezonskih studenata, takodje u Nemačkoj, zatim u saradnji sa Vladom Luksemburga takodje radimo na podizanje profesionalne osposobljenosti mladih na Kosovu. Ponovo sa UNDP-om, na zapošljavanju osoba sa ograničenim sposobnostima. Samo Ministarstvo radi na...

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë? Nuk ka. Faleminderit!

Po ia nisim prej pyetjes së parë. Me kërkesë të ministrit e bëmë këtë ndryshim.

Deputetja Nerxhivane Dauti, pyetje për ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, zotni Kryetar!

Përshëndetje, zoti Kryeministër Thaçi dhe të gjithë kolegë të nderuar,

Duke u bazuar në Rregullën 26.2 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë lidhur me Ligjin për detyrimet. Ligji për detyrimet është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2004, nuk është nënshkruar nga PSSP-ja dhe është kthyer në rishqyrtim te propozuesi. Ky ligj është me rëndësi të veçantë. Miratimi dhe zbatimi i tij do të krijojë kushtet që Kosova të shkëputet nga legjislacioni i sistemit të kaluar dhe që raportet juridiko - civile të subjekteve të së drejtës në Kosovë të rregullohen me rregullativë juridike nga fusha e detyrimeve, që bazohet në standarde ndërkombëtare. Prandaj, duke pasur këtë që u theksua më lartë, për ministren e Drejtësisë parashtroj këtë pyetje: Ku qëndrojnë shkaqet që Ligji për detyrimet nuk procedohet në Kuvendin e Kosovës për miratim? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zonja ministre, e ke fjalën!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: E nderuar zonja deputete, prof. dr. Nerxhivane Dauti. Është e vërtetë se Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për detyrimet qysh në vitin 2004, mirëpo ai ligj nuk ka qenë i shpallur nga Përfaqësuesi i Sekretarit të Kombeve të Bashkuara, kështu që nuk konsiderohet Ligji i zbatueshëm. Nga ana tjetër, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Qeveria ka vendosur që të gjitha ligjet që nuk janë nënshkruar nga Përfaqësuesi civil, Përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, të kthehen në riprocedurë, kështu që ky ligj është në strategjinë legjislative të Ministrisë së Drejtësisë dhe këtë vit do t'i përcillet Kuvendit, për miratim, pasi që të miratohet në Qeveri.

KRYETARI: Faleminderit, ministre!

Deputete, ke pyetje shtesë? Regjia, fjalën e ka deputetja Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit për përgjigjen, zonja ministre!

Unë strategjinë legjislative të Qeverisë e kam përpara dhe këtu figuron data 15 dhjetor 2009. Duke marrë parasysh faktin se ligji i ka 1372 nene, kërkoj që të përshpejtohet kjo procedurë sa më shpejt. Ju e dhatë përgjigjen shumë mirë, por kërkoj që të bëhet përshpejtimi i procedurës në mënyrë që grupet punuese që janë në formim apo janë formuar, ta kenë në konsideratë faktin se është një ligj bazik dhe një platformë shumë e mirë për investime dhe për ekonominë e tregut. Ju falënderoj!

KRYETARI: Faleminderit! Ministre, më duket nuk ka nevojë për përgjigje.

Vazhdojmë, deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Tregtisë dhe të Industrisë, zotin Lutfi Zharku. Deputet, mund ta bëni pyetjen.

RIZA SMAKA: Respekt për Kryetarin edhe auditorin.

Në Kosovë ekzistojnë shumë organizata biznesore të themeluara në sistemin e shoqërive aksionare. Në shoqëritë aksionare, ndër të tjera, rolin dominant e luajnë për transaksione letrat komerciale apo instrumentet negociatore. Ato transaktohen nëpërmjet shitblerjeve, shkurt thënë, në bursë. Bursë në Kosovë nuk kemi. Ka pengesa të mëdha për ekonominë e tregut mungesa e bursës. Nuk ka pengesa ligjore për t'u themeluar bursa. Pse nuk është

themelua deri sot apo, së pakut, kur planifikohet të themelohet, së paku bursa për letrat komerciale në Kosovë? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Zoti ministër, e ke fjalën!

LUTFI ZHARKU: I nderuar Kryetar,
Kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra, deputetë,
I nderuar deputet Smaka,
Dëshiroj një mirëkuptim nga ana e juaj, pasi që e kemi marrë pyetjen e juaj vonë dhe i adresohet edhe ministrit Shala, edhe mua bashkërisht. Ministri Shala nuk është këtu, kështu që nuk kemi mund ta kemi një përgjigje të përbashkët. Unë ju kërkoj mirëkuptim për mbledhjen e ardhshme.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti.
Deputet, mund ta bëni pyetjen!

RIZA SMAKA: Zotëri Kryetar,
Pyetja i referohet numrit enorm të automjeteve motorike të vjedhura gjatë vitit 2008. Numri është hiq më pak se 472 automjete motorike. Numri më i madh i këtyre nuk është zbuluar, nuk është gjetur fare. Si qëndron gjendja me këtë numër të madh të vjedhjeve të automjeteve në rrethanat paqësore, do me thanë, ku ka kushte për pasiguri edhe pa fije dyshimi, thotë fjala, të njëfarë papërgjegjësie apo ineffikasiteti.

KRYETARI: Ministri e ka fjalën, veç pyetjet bëni me rend, qysh i keni parashtruar, zoti deputet.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministër,
Kolegë të nderuar deputetë,
Zoti Smaka, bazuar në informacionet zyrtare të policisë, gjatë vitit 2008 janë paraqitur 463 raste të veturave të vjedhura. Nga ky numër i veturave, falë angazhimit operativ të njësisë të policisë, pronarëve iu kanë kthye 252 vetura, kurse për vetura tjera procedurat kanë qenë hetimore në vazhdim. Ndërsa, në vitin 2009 janë paraqitur 90 raste të veturave të vjedhura, nga të cilat 31 janë gjetur dhe këtyre pronarëve, kurse për të tjerat janë procedurat hetimore që vazhdojnë.

Po ashtu, më lejoni t'ju informojë se me datë 5 mars 2009, sipas planit operativ të koduar me emrin "Taureg" është zhvilluar një operacion nga shtylla e hetimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe i koordinuar me të gjitha drejtoritë rajonale dhe Departamentin e Policisë Kufitare. Ky operacion kishte shtrirje rajonale të ndryshme në gjithë territorin e Kosovës. Gjatë realizimit të këtij plani janë kontrolluar dhe konfiskuar, janë verifikuar 257 automjete, janë konfiskuar 9 automjete, me targa që u përmendën, është konfiskuar një lloj arme, është arrestuar një person, janë konfiskuar 70 palë targa, 3 libreza qarkullimi zvicerane, një librezë qarkullimi gjermane, 15 libreza qarkullimi të Kosovës. Ky operacion është zhvilluar si mbështetje e planit operativ të koordinuar nga Qendra Rajonale "Sekicenter", Qendër Rajonale për luftimin e krimit transkufitar, me seli në Bukuresht. Duke u mbështetur në koordinimin dhe shkëmbimin e informatave që kemi të bëjmë me mbështetjen në këtë operacion, me sigurimin e informatave edhe për shtetet

e rajonit, si Maqedonia dhe Shqipëria, ky operacion dëshmoi gatishmërinë e Policisë së Kosovës, që të vlerësohet po ashtu si partner në regjion për luftimin e krimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, ke pyetje shtesë. Kisha kërkuar vërtet që deputetët të bëjnë pyetjet ashtu siç i kanë parashtruar. Pyetja 10.51 është lexuar para pyetje 10.22. Shkojmë më tej. Deputeti Naim Rustemi, pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme. Naim Rustemi, nuk është këtu. Mirë! Për Ahmet Shalën paska qenë pyetja.

Deputetja Nurishahe Hulaj, pyetje për ministrin e Arsimit, zotin Enver Hoxhaj. Deputete e ke fjalën!

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, Kryetar i Kuvendit,

E nderuara Qeveri,

Të nderuar deputetë,

Çështja: Niveli higjienik-sanitar në mjediset e shkollave të Republikës së Kosovës është i pakënaqshëm dhe nuk i plotëson kriteret dhe standardet higjienike të domosdoshme për nxënësit dhe, si pasojë, paraqiten dhe evidentohen sëmundje ngjitëse të kontaktit, siç është verdhëza te nxënësit parashkollorë dhe shkollorë mjaft të përhapur.

Në vitin 2007 janë evidentuar 955 raste të verdhëzës, 1271 raste në vitin 2008 dhe 353 raste vetëm në janar të vitit 2009, kryesisht fëmijë parashkollorë dhe shkollorë. Pyetja: Zoti ministër, në kuadër të objektivave programore të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë për shkollat a keni bërë hulumtime konkrete për gjendjen higjienike-sanitare nëpër shkollat e Republikës së Kosovës. Nëse keni të dhëna në baza hulumtuese, çfarë keni ndërmarrë? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti Kryetar,

Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Shumë të respektuar deputetë,

Sa i përket pyetjes që e shtroi zonja deputete, një përgjegjësi e tillë realisht është përgjegjësi e komunave të Republikës së Kosovës me gjitha ligjet që i kemi në fuqi, edhe me Ligjin për arsimin fillor, mirëpo edhe me Ligjin për arsimin lokal në komunat tona. Zakonisht, drejtoritë komunale merren me mirëmbajtjen e objekteve shkollore dhe departamentet e inspeksionit e mbikëqyrin edhe çështjen e gjendjes higjienike në shkollat tona. Kur është fjala tek përhapja e verdhëzës, e cila nuk është një fenomen që na ka përcjellë vetëm gjatë këtij viti, por mjerisht edhe viteve të kaluara, unë personalisht kam qenë në disa komuna, kam biseduar me disa kryetarë komunash dhe kam kërkuar që, thjeshtë, gjendja higjienike në shkollat e Kosovës të jetë shumë më në nivel.

Dua të them që për disa komuna, nuk kam dëshirë t'i përmendi komunat me emër, shkaktari i verdhëzës duhet të kërkohe brenda për brenda objekteve shkollore, mirëpo në kushtet e ujit të pijes të cilat janë të pranishme në disa fshatra të Republikës së Kosovës,

do të thotë, burimi i sëmundjes s'kanë qenë shkollat, po ka qenë, thjeshtë, gjendja e ujësjellësit në fshatrat e caktuara të Kosovës.

Sa iu përket përgjegjësi të Ministrisë së Arsimit, dua të them që ne, si Ministri, e kemi strategjinë - shkollat e shëndetshme, ku së bashku me ministrin Gashi, me ministrin Yagcilar dhe me ministrin e Kulturës jemi të gatshëm që për këtë strategji të fillojë implementimi që në këtë vit. Po ashtu, kemi edhe doracakë, të cilët iu shpërndahen mësimdhënësve, iu shpërndahen menaxhmentit shkollor, që të informojnë nxënësit për kushtet higjienike të cilat duhet të jenë të pranishme në shkollat e Kosovës. Realisht, ne si pushtet qendror jemi duke bërë punën tonë, mirëpo kemi kërkuar nga kryetarët e komunave të Republikës së Kosovës që departmentet e inspeksionit vërtet të jenë shumë më aktive që ta mbikëqyrin edhe gjendjen higjienike në shkolla, por veçanërisht t'i luftojnë shkaktarët e verdhëzës nga fillimi deri në fund. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputete, ke pyetje shtesë? Urdhëro!

NURISHAHE HULAJ: Kisha për të pyetur, a ka filluar të implementohet tani strategjia - shkollat promovuese të shëndetit?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Strategjia ka filluar të implementohet, meqë ekziston një grup ndërmintor, i cili punon në implementimin e kësaj strategjie, ekziston edhe një plan veprimi dhe vetëm doracakët të cilët janë në përdorim, janë faza e parë e implementimit të strategjisë, mirëpo mendojmë që ta kemi edhe një grup punues në nivel shteti, një grup punues në nivel kombëtar, i cili vërtet çështjen e shkollave të shëndetshme e promovon shumë më tepër se sa që ka ndodhur deri më tash.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Pyetja e radhës, deputetja Nerxhivane Dauti, pyetje për ministrin e Kulturës, zotin Valton Beqiri. Deputete, mund ta bëni pyetjen.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Në bazë të Rregullës 26 pika 2 të Rregullores së Punës së Kuvendit, parashtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë.

Çështja: Ligji numër 2004/45 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të përafërta, i miratuar në Kuvend më 29 qershor 2006 dhe i shpallur më 24 gusht 2006, është një ndër ligjet e para i harmonizuar me standardet dhe praktikën më të mira evropiane, i cili rregullon pronën intelektuale. Implementimi i këtij ligji kërkon nxjerrjen e disa akteve nënligjore.

Pyetja: Pyes ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, zotin Valton Beqirin, se cilat veprime i ka marrë Ministria për të zbatuar nenin 169 pika 1 dhe 169 pika 2 të këtij ligji, sipas të cilit Ministria e Kulturës është dashur të nxjerrë rregullore për zbatimin e këtyre dispozitave...

KRYETARI: Zoti ministër. e ke fjalën.

MINISTRI VALTON BEQIRI: I nderuari zoti Kryetar,
I nderuar Kryeministër, zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
E nderuara deputete Dauti,

Para se të jap një përgjigje, më lejoni që para të gjithëve ta lexoj nenin 169 pikë 1 dhe nenin 169 pikë 2, meqë i gjithë Parlamenti ndoshta ka dëshirë dhe nevojë ta dijë se çka përcakton ky nen. Pra, neni 169.1 thotë: “Qeveria e Kosovë do të themelojë Zyrën për të drejtat mbi pronën intelektuale, më tutje: Zyra, brenda 18 muajsh nga shpallja e këtij ligji”, dhe neni i ardhshëm është se në pritje të themelimit të kësaj zyre, Ministria e Kulturës do të ushtrojë funksionet administrative të caktuara kësaj zyre dhe me anë të këtij ligji edhe Ministria e Kulturës do të miratojë rregullore për zbatimin e këtyre dispozitave brenda 6 muajsh. Ne si Ministri, natyrisht, kemi punuar në këtë aspekt, kemi përpiluar dy draftrregullore: Draftrregulloren për funksionimin e Zyrës dhe Draftrregulloren për procedurën e zgjedhjes së bordit këshillëdhënës. Pra, këto janë draftrregullore të cilat mundësojnë fillimin e funksionimit të kësaj zyre. Po ashtu, kjo çështje është ngritur edhe nga Komisioni Parlamentar për Arsim Shkencë dhe Kulturë dhe kemi mbajtur 2 takime për këtë çështje dhe kemi evidentuar se shumë shpejtë duhet në nivel të Qeverisë të ngrihet kjo çështje në mënyrë që të merret kompetenca gjegjësisht përgjegjësia se kush do ta mbajë të drejtën për ta themeluar zyrën.

Në kuadër të Qeverisë, meqë në këtë ligj implikohen, në realizimin dhe zbatimin e këtij ligji implikohen edhe shumë ministri tjerë, si Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë dhe Ministria e Kulturës, prandaj ne do të ngrehim këtë çështje shumë shpejt në njërën nga mbledhjet e ardhshme të Qeverisë, në mënyrë që të marrim kompetencën për themelimin e kësaj zyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ke pyetje shtesë, deputete?
Regjia, fjalën e ka deputetja Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI: Bashkëpunimi i ofruar nga Ministria e Kulturës me Komisionin Parlamentar është për t’u përshëndetur. Unë mendoj se zoti ministër ka parasysh faktin se ligji është shumë i rëndësishëm dhe mendoj se implementimi i këtyre gjërave duhet të bëhet sa më shpejt. Mendoj se në seancën tjetër të radhës do t’ju bëj pyetje tjetër e cila është e lidhur mu për këto çështje. Ju falënderoj për përgjigjen!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë pyetjen e radhës.
Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!
Çështja është: Të ardhurat totale nga procesi i privatizimit të ndërmarrjeve në pronësinë shoqërore kanë arritur shumën rreth 400.000.000 euro, prej të cilave 59.5% janë kapital i jashtëm, 25.6% kapital vendor dhe 14.9% janë kapital i emigrantëve tanë, do të thotë nga diaspora. Kur kihet parasysh fakti se diaspora çdo herë dhe në kohërat më të vështira ishte e gatshme të ndihmojë Kosovën, çudit fakti i pjesëmarrjes kaq të vogël të diasporës në procesin e privatizimit në Kosovë.

Zoti ministër, ku qëndron arsyeja për një pjesëmarrje kaq të vogël të diasporës në procesin e privatizimit.

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar, zoti Kryetar,

Të nderuar të pranishëm,

E nderuara, zonja deputete,

Mbase, përgjigje më tepër do të ishte për Agjencionin Kosovar të Privatizimit, por me qenë se kam marrë pjesë në atë proces, konsideroj që ndjejë përgjegjësinë edhe si ministër i Ekonomisë dhe Financave për t'u përgjigjur në këtë pyetje, e konsideroj mjaftë interesante dhe element i cili është debatuar shumë herë edhe gjatë kohës, kur unë kam qenë zëvendësudrejtor i Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

Shënimet të cilat ju i thoni, në fakt, nuk korrespondojnë me shënimet që i ka pasur Agjencioni Kosovar i Privatizimit dhe nuk e di se kah kanë ardhur ato, por më lejoni t'i jap disa shënime që unë, me kërkesën time, i kam marrë nga Agjencioni ditëve të fundit dhe del që, përafërsisht, diaspora kosovare ka marrë pjesë me 42% në procesin e privatizimit, edhe si shumë, edhe si numër. Ka qenë shumë vështirë për ta vërtetuar saktë, e kam fjalën te një tenderues ka qenë vëlla i dikujt, që është në Kosovë, në Vushtrri, në Prizren, në Gjakovë apo blerësi pra ka qenë nominalisht i Kosovës, ndërsa paratë mund të ndodh që kanë ardhur shumica prej vëllait, kushëririt apo partnerit të vetë nga jashtë. Prandaj, ka qenë shumë vështirë që ne përmes sistemit bankar të vërtetojmë se cila ka qenë saktësisht shuma e caktuar që ka ardhur drejtpërdrejtë nga diaspora. Gjithsesi, shënimet më tepër konfirmojnë se rreth 42% të gjithë procesit të privatizimit është në favor të kosovarëve, përkatësisht diasporës kosovare. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë? Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Zoti ministër, të ju jap sqarim. Unë të dhënat i kam marrë nga Raporti i Bankës Qendrore të Kosovës. Dhe, një gjë që kam vërejtur se të dhënat që i paraqet Banka Qendrore dhe të dhënat që i disponojnë nga Qeveria shumë herë nuk përputhen. Edhe kjo kishte për të qenë ndoshta një pyetje për ju, nuk e di pse. Përndryshe, të dhënat janë kështu. Do të ishte shumë e kënaqshme 42%.

KRYETARI: Ministër, a ke përgjigje?

MINISTRI AHMET SHALA: Të thashë, ka qenë relativisht vështirë për të përcaktuar saktë rrjedhën e parasë. Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit ka korresponduar me të dhënat që i merr në xhirollogarinë e vet. Në qoftë se pagesi i parave ka qenë nga një xhirollogari e jashtme, në qoftë se ka qenë një rrjedhë e tillë nga xhirollogaria e jashtme, duke hequr disa privatizime të mëdha, siç ka qenë Ferronikeli, apo Birraria, apo disa ndërmarrje shumë të fuqishme, shumica e ndërmarrjeve janë privatizuar me kapital të përzier, qoftë të diasporës kosovare, apo të kosovarëve në regjion. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Myrvete Pantina ka edhe një pyetje për ministren e Ministrisë së Energjetikës dhe të Minierave, zonjën Justina Pula-Shiroka. Ajo nuk është këtu. Doni ta bëni pyetjen? Ju faleminderit! Vazhdojmë.

Deputeti Ibrahim Makolli, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi.

Deputet Makolli, mund ta bëni pyetjen.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar,

I nderuar, zoti Kryeministër,

Të nderuar kolegë

Pyetja ime është kështu: Kuvendi i Kosovës, me datën 7 korrik të vitit 2005, në seancë plenare diskutoi lidhur me gjendjen e pensionistëve në Kosovë dhe nxori 5 rekomandime. Këto rekomandime i drejtohen Qeverisë së Kosovës, që në mënyrë të përsheptuar të hartojë Ligjin për sigurimet pensionale, ligj me të cilin do të rregulloheshin shumë shqetësime që sot i kanë pensionistët e Kosovës.

Pyetja është kjo: Zoti Kryeministër, që nga viti 2005 nuk është ndërmarrë asgjë në këtë drejtim. Kur parasheh Qeveria juaj që ta ketë në agjendë zgjidhjen e hallit të pensionistëve?

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, zoti deputet Makolli,

I nderuar Kryetar i Parlamentit, Krasniqi,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Në vitin që jemi, Projektligji i përmendur ka qenë i përfshirë në Strategjinë legislative të Qeverisë së Kosovës. Pas përfundimit të gjitha procedurave, Projektligji në fjalë nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Punëve dhe Mirëqenie Sociale është proceduar në Ministrinë e Ekonomisë dhe e Financave dhe në Agjencinë për koordinim të zhvillimit dhe integriteteve Evropiane, për sigurimin e deklaratës financiare, përkatësisht të deklaratës së pajtueshmërisë me Legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Pas marrjes së këtyre deklaratave, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, do ta procedojë Projektligjin në fjalë në Shërbimin e Njësisë së Zyrës së Kryeministrit, për shqyrtim në Qeverinë e Kosovës.

Skemat pensionale, që menaxhohen dhe administrohen nga Departamenti i Administratës Pensionale në Kosovë, është: pensionet bazë -139.392 qytetarë, pensionet e personave me aftësi të kufizuar -17.464 qytetarë, pensioni bazë kontribut pagues -28.135, pensionet “Trepça” -4.536, dhe sa i përket procesit fillestar, pensionet e ish pjesëtarëve të TMK-së aktualisht deri tash -56.

Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, përveç skemave pensionale të cekura më lartë, të cilët kanë qenë dhe janë në vazhdimësi duke zbatuar për periudhën kohore 2008-2009, ka filluar me zbatimin edhe të pensionit bazë kontribut pagues nga 40 në 75 euro, për ish shfrytëzuesit e pensionit të pleqërisë dhe invalidor, si dhe për të gjithë ish të siguruarit që i kanë plotësuar kriteret e moshës 65 vjet dhe më së paku 15 vite stazh.

Gjithashtu, me Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 02/51, datë 23.01.2009, skemat pensionale të cilat kanë rritje, janë si më poshtë:

- pensionet bazë, nga 40 në 45,
- skemat e pensioneve kontribut pagues, nga 75 në 80,
- skemat e pensioneve të aftësisë së kufizuar, nga 40 në 45,
- skemat e asistencës sociale, të cilat skema kanë rritje në bazë të numrit të anëtarëve të familjes.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, Kryeministër!

Zoti deputet, ke pyetje shtesë? Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pyetje. Deputetja Luljeta Shehu, pyetje për ministrin e Bujqësisë, zotin Idriz Vehapi. Deputete, e keni fjalën.

LULJETA SHEHU: Ju faleminderit!

I nderuar Kryetar i Kuvendit!

I nderuar Kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Çështja është: Tjetërsimi i tokës bujqësore po ndodhë çdo ditë. Komuna e Prizrenit ka pasur rreth 1200 hektarë vreshta, të cilat janë tjetërsuar tërësisht.

Pyetja është: Çka ka ndërmarrë ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me këtë problem?

KRYETARI: Zoti Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: Ju faleminderit, zoti Kryetar,

Zoti Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Zonja deputete Shehu,

Administrimi i tokës bujqësore ndanë përgjegjësitë të një numër institucionesh qendrore dhe të atyre lokale. Ministria e Bujqësisë, dihet se ka bërë përgatitjen e infrastrukturës ligjore, Ligjin për tokën bujqësore me të gjitha aktet nënligjore, por për shkak se Kosova ende nuk e ka një planifikim hapësinor të përgjithshëm, por edhe komunal, bazuar në Ligjin për tokën bujqësore numër 02L/26 kapitulli VIII, citoj nenin 44: “Deri në nxjerrjen e Planit hapësinor, shfrytëzimi i tokës bujqësore për qëllime jobujqësore mund të bëhet vetëm në bazë të kuvendit komunal”. Ne si Ministri kemi pasur kontakte të vazhdueshme me të gjitha komunat e Kosovës në mënyrë që bashkëpunimi jonë të çojë në ruajtjen e tokës bujqësore në përgjithësi. Mirëpo, pasi që Kosovës i mungon një plan hapësinor i përgjithshëm, po ashtu mungojnë edhe planet urbanistike për komunat e Kosovës, atëherë ndërtimet bëhen nëpër vende nga njëherë edhe të palejueshme.

Ne, si Ministri, kemi për obligim vetëm të japin pëlqimet për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore dhe aty ku konsiderojmë se nuk plotësohen kushtet urbanistike, ne nuk i japim ato pëlqime.

Sa i përket regjionit vreshtar të Prizrenit, dihet se shumica e atyre sipërfaqeve kanë qenë pronë publike dhe me këto toka që i përkasin sektorit publik, deri në vitin 2008 ka menaxhuar AKM-ja dhe prej atëherë, do me thënë, që prej themelimit të AKP-së me këto toka menaxhon AKP-ja. Këtu ne nuk kemi kompetenca, për zonat vreshtare jo vetëm në komunën e Prizrenit, por për të gjitha tokat publike, do me thënë, që i kanë takuar sektorit publik. Ato presin privatizimin dhe kur do të ndodhë ai, ajo është çështje e AKP-së. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputete ke pyetje shtesë. Faleminderit edhe nga ana e juaj!

Deputete, keni edhe një pyetje për ministrin e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, zotin Fatmir Limaj. Doni ta lexoni pyetjen.

LULJETA SHEHU: Kur të jetë prezentë ministri, atëherë do ta parashtroj.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin e Arsimit, zotin Enver Hoxhaj. Deputete, e keni fjalën.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje për të gjithë,

Zoti ministër, çfarë është duke ndodhur me 80 mjekët e regjistruar për doktoratë mjekësore, 130 magjistra të shkencave mjekësore dhe qindra mjekë të rinj, të cilët duan të bëhen doktorë shkencash. Pse po ju mohohet e drejta për shkollim të mëtutjeshëm në shkencë, kur dihet se 80 prej tyre kanë qenë të regjistruar në mënyrë të rregullt që nga 25 tetori i vitit 2005?

Ju lutem, zoti ministër, a ka mundësi të na shpjegoni se çfarë është duke ndodhur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryetar, Kryeministër, zëvendëskryeministër,

Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete,

Më lejoni që për një pyetje të tillë vërtet ta prezantoj gjendjen ashtu se si është. Me reformat e Bolonjës parashihet që Universiteti i Prishtinës, i cili është me reformat Bolonjës që disa vite, ta ketë një rregullore, e cila rregullore do të duhej t'i harmonizonte nevojat dhe kërkesat e secilit fakultet veç e veç për studimet e doktoraturës. Kjo rregullore është miratuar në vitin 2007 dhe me rastin e hartimit të kësaj rregulloreje ka qenë i kyçur edhe vetë Fakulteti i Mjekësisë dhe aty është i precizuar edhe numri i studentëve se për sa studentë ka nevojë Fakulteti i Mjekësisë për doktoraturë.

Së dyti, ekziston një këshill qendror që merret me programet të doktoraturës dhe në këtë këshill qendror, po ashtu, Fakulteti i Mjekësisë e ka një përfaqësues, i cili përfaqëson interesat e mjekësisë.

Së treti, një informatë e tillë për këtë rregullore ekziston edhe në Web faqet e Universitetit të Prishtinës, ku mund të kuptohet cilat janë rregullat sa i përket doktoraturës.

Sa i përket Ministrisë së Arsimit, në vitin e kaluar, në korrik të vitit të kaluar, kemi hartuar një bazë ligjore, një udhëzim administrativ, i cili rregullon çështjen e diplomave të para Bolonjës dhe me të Bolonjës. Dhe, nëse e përcillni debatin në Shqipëri, aktualisht,

ata kanë realisht problem tek tash me këto diploma, përderisa ne si Ministri kemi mbërri që vitin e kaluar ta harmonizojmë një çështje të tillë.

Sa i përket konkursit në fjalë, dua të them që nuk është gati praktikë në asnjë vend të botës që studimet e doktoraturës të organizohen me konkurs për një arsye se, kur dikush paraqitet me studim të doktoraturës, shkon në fakultet dhe nëse fakulteti ka profesor të thirrur që të ofrojë një lëndë të tillë, realisht kandidati pranohet për studime të doktoraturës. Ajo se çfarë mund t'ju them unë, zonja deputete, është që ne kemi vendosur që ta dërgojmë Inspektionin e Ministrisë së Arsimit, që ta shoh se sa është zbatuar ligjshmëria dhe Rregullorja me rastin konkret dhe, së dyti, për vitin e ardhshëm akademik, me qëllim që mos të ndërhyjmë në autonominë e Universitetit të Prishtinës, ne jemi në gjendje që të rrisim numrin e profesorëve, jemi në gjendje që t'i rrisim kapacitetet hulumtuese shkencore, me qëllim që këta të rinj thjeshtë të kenë potenciale dhe të vazhdojnë studimet e doktoraturës.

Për vitin aktual, realisht, ne nuk preferojmë që për çdo punë që ka vetë Universiteti i Prishtinës, Ministria e Arsimit të merret me konkurset dhe programet e doktoraturës. Ajo çka mund t'ju premtoj unë juve, është që për vitin e ardhshëm akademik, ne do të bëjmë...

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputete, keni pyetje shtesë? Nuk ke. Edhe pse realisht kjo çështje nuk është vetëm për pyetje parlamentare.

Vazhdojmë, deputeti Hëset Cakolli, pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti.

HESET ÇAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Çështja: Pyetje parlamentare e referuar aplikimit të dispozitave të neneve 56 dhe 57 të Ligjit nr. 03-N-035 për Policinë.

Me dispozitat e sipërpërmendura është përcaktuar se Policia e Kosovës punëson zyrtarë policorë dhe staf civil, të cilëve marrëdhënia e punës iu rregullohet me Ligjin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Pyetja është: Zoti ministër, sa i konsideroni të përshtatshme dispozitat ligjore të stafit civil dhe të zyrtarëve policorë dhe, nëse ju vlerësoni se të njëjtat nuk janë të përshtatshme, çfarë synoni në funksionim të harmonizimit të natyrës dhe të karakterit normativ legal të tillë me specifikat e Shërbimit policor?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti deputet,

Parimisht, marrëdhënia e punës në Policinë e Kosovës rregullohet me Ligjin e Policisë për dy kategori të të punësuarave në Polici, si për zyrtarët policor, ashtu edhe për stafin civil.

Në rast se ndonjë nga çështjet që ka të bëjë me marrëdhënien e punës nuk është e rregulluar me Ligjin e Policisë, atëherë dispozitat e nenit 56 të këtij ligji parashohin

aplikimin e Ligjit për shërbyesit civilë. Shumica e neneve të Ligjit të Policisë, në pjesën që rregullon marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, i referohen zyrtarëve policorë e jo stafit civil. Kjo vërehet qartë tek nenet përkatëse që rregullojnë sistemin e gradave, të drejtave, të drejtat e zyrtarëve policorë, kompensimin për punë të veçanta policore, konfliktin e interesave, transferin, e tjerë.

Për stafin civil, për më tepër, marrëdhënia e punës rregullohet me dispozitat e Ligjit të Shërbimit civil, për shkak të natyrës së punës së tyre. Staf i civil në Policinë e Kosovës kryen funksione administrative, mbështetëse dhe teknike, funksione këto të ngjashme me të gjithë shërbyesit civilë tjerë të punësuar në kuadër të Administratës Publike në nivel të vendit. Ndërsa, zyrtarët policorë kanë autorizime policore, detyra policore, prandaj kjo e bën specifike punën e tyre që domosdo kërkon një rregullim tjetër normativ në krahasim me shërbyesit civilë.

Ka disa shembuj të cilët tregojnë për veçantitë. Për shembull, procedurat e rekrutimit dhe seleksionimit janë pothuajse të ngjashme, me disa përjashtime kur kemi të bëjmë me procesin e testimit për zyrtarët policorë. Për shembull, aplikohet tek rekrutimi i zyrtarëve policorë, aplikohet testi i shkathtësive fizike, kontrolli mjekësor, kontrolli psikologjik e tjera, të cilat nuk janë të theksuara në ligjin tjetër. Pastaj, procesi i themelimit të marrëdhënies së punës për zyrtarët policorë përfshinë edhe trajnimin themelor teorik dhe praktik, i cili nuk mund të aplikohet edhe për stafin civil.

Në bazë të këtyre shembujve, thjeshtë, konkludojmë se është shumë më drejtë që Ligji për Shërbimin civil të rregullojë shumicën e çështjeve për stafin civil, me përjashtim të disa çështjeve të cilat janë të rregulluara me Ligjin për Policinë, siç është procedura disiplinore për dy kategoritë, e tjera. Pra, tash për tash konsiderojmë se janë mirë të harmonizuara këto. Nuk kemi pasur asnjë ankesë që do të na çonte deri te ndonjë ndryshim ose plotësim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti ministër! Deputet, ke pyetje shtesë? Ju faleminderit! Pyetja e fundit, deputeti Naim Maloku, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti ministër, si objekti i Ferronikelit, ashtu edhe xehja e Ferronikelit janë një nga asetet më të çmuara që i ka Kosova. Siç dihet më parë, ju keni qenë në procesin e privatizimit në pozicionin më të lartë nga vendorët.

Zoti ministër, sa është efekti i afarizmit të Ferronikelit në Buxhetin e Republikës së Kosovës? Para se të përgjigjeni në pyetje, shfrytëzoj kohën prej 3 minutave dhe t'ju them, zoti ministër, se kjo pyetje nuk e anulon kërkesën time që krejt procesi i privatizimit të Ferronikelit të bëhet publik dhe transparent për opinionin. Ju faleminderit, ministër!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Edhe një herë përshëndetje, zoti Kryetar,
Përshëndetje Kabinet qeveritar,
I nderuari zoti deputet, Maloku,

Për sqarim të opinionit, pozicioni më i lartë në AKM ka qenë Bordi dhe nënkryetar i Bordit ka qenë ministri Dugolli dhe ministrat e tjerë. Kam pasur pozicion ekzekutiv, përkatësisht zëvendës drejtor, pa dashur që të debatohet tash për procesin e vendimmarrjes. Sido që të jetë, në pyetjen e juaj, ndërmarrja e re Ferronikelit SHPK “Drenas”, ratifikimi i kontratës së shitjes është bërë më 20 prill 2006. Përfundimi i periudhës së zotimit është dashur të jetë dhe është 20 prill 2009.

Çmimi i ofertuar ose i ofertës fituese ka qenë 30.554.371 euro. Zotimi për investime 20.000.000 euro dhe zotimi i punësimit 1000 punëtorë brenda vitit të caktuar, me obligim të mbajtjes për dy vite ose deri në fund të periudhës zotuese.

Deri me 31 janar 2008, Ferronikeli ka raportuar investime kapitale në shumën prej 59.677.464 euro, përkatësisht është 298% më shumë se sa obligimi i kontraktuar, i cili përfundon me 20.04.2009, si dhe ka punësuar drejtpërdrejt 1074 punëtorë, pra obligimi ka qenë 1000 punëtorë, dhe ka të punësuar në mënyrë indirekte si kontraktues diku varësisht prej zezonës, sipas informatave që kemi ne, 250 deri në 400 punëtorë të tjerë.

Sa i përket pjesës së kontributit të Ferronikelit në Buxhetin e Republikës së Kosovës, ju njoftoj që kompania e lartpërmendur gjatë vitit 2008 ka eksportuar produkte në vlerë prej 83.406.079,64 nga të cilat 80.841.066, 37 si reeksport dhe 2.557.000 euro eksporte të rregullta, përkatësisht importi i xeheve të nevojshme është diku mbi 17%.

Nga të dhënat e ATK-së, bëhet e ditur se një kohë Ferronikeli, me numër të regjistrimit të biznesit 702673 është i regjistruar me datën 19.05.2005 në MTI. Gjatë periudhës 2006-2007 deri në korrik 2008, ka kërkuar rimbursim të TVSH-së në vlerë prej 80.826,94 centë dhe kërkesa për rimbursim për vitin 2008 është 12.268.212.06 centë.

Tatimi në të ardhurat e korporatave, tatimi i paguar për vitin 2006, 2007, 2008, 2007, pardon, është zero, natyrisht ende nuk është në fazën e fitimit dhe humbja e deklaratës për vitin 2008...

KRYETARI: Regjia, ia vazhdoni fjalën!

... nuk është dorëzuar ende deklarata vjetore, obligimi për dorëzimin e deklaratës vjetore është me 31 mars 2009, ndërsa tatimi i mbajtur në fitim është për 502.728, 85 centë. Interesi i dividendës dhe renta janë 44.183 euro dhe për vitin 2006, 2007 dhe 2008, pensionet, përkatësisht kontributet për pensionet janë 842.348,49 centë, si dhe pagesa në të ardhura personale diku rreth 15.000.000 euro.

Në qoftë se dëshironi, unë mund të jap edhe detaje të tjera. Këto konsideroj që ishin themelore për kontributin në Buxhetin e Kosovës. Kam edhe shënime tjera. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputet, a ke pyetje shtesë?

NAIM MALOKU: Po! Zoti ministër,

Unë sa munda të kuptoj nga ato që ju i thatë, pyetja ishte: Sa fiton buxheti i Kosovës nga të gjitha taksat dhe tvsh-të dhe tatimet që duhet t'i paguajë Ferronikeli, diku doli rreth 20 milionë euro, plus diku 15 milionë euro, thatë, për paga punëtorëve. Ju duhet t'i zbritni humbjet që i ka KEK-u me Ferronikelin dhe Hekurudhat e Kosovës, të cilat

mbulohen nga buxheti i Kosovës. Pra, këtu ndahen ato mjete nga buxheti, nga taksapaguesit për t'u mbuluar ato humbje dhe, këto të hyra, minus humbjet, ky është fitimi që Kosova e ka nga Ferronikeli. Pra, a është negativ, ose pozitiv. Po, ky është i tërë fitimi që Kosova dhe qytetarët e Kosovës e kanë nga një prej aseteve më të çmuara që e ka Kosova. Plus, ne nuk e dimë se sa taksa paguhen në xehen e shfrytëzuar, a paguhet a jo? Kërkohej një informatë më e plotë, zotëri ministër. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, a keni përgjigje lidhur me këtë?

MINISTRI AHMET SHALA: Më siguri ka nevojë për ndonjë auditim të saktë për të dhënë secilin element të kësaj. Të dhënat janë të dhëna nga Administrata Tatimore dhe e Doganave, për të cilat, unë kam besim të plotë se janë të sakta. Çdo trajtim akademik tjetër ka nevojë për debate, ndoshta, të niveleve tjera. Në qoftë se kërkohen të dhëna më detaje, sigurisht që Administrata Tatimore, Dogana e Kosovës dhe Ministria e Ekonomisë dhe e Financave do të jenë gjithnjë në disponim për t'i dhënë. Ana tjetër është që kjo ende mbikëqyret nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Pra, edhe kjo është një çështje tjetër që s' mund të zgjidhet me pyetje parlamentare.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimet e sanksioneve penale.

Komisioni ka hartuar Raportin dhe ka rekomanduar që i njëjti të shqyrtohet në seancë plenare.

Raporti me rekomandime u është shpërndarë deputetëve, më 23 shkurt 2009.

Sipas radhës, fjalën e ka kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, zoti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, duke i përmbushur obligimet që ia përcakton Rregullorja e Punës, duke u mbështetur edhe në objektivat e Kuvendit të Kosovës, në Raportin e progresit për Kosovën, që në kuadër të fushëveprimtarisë së vet t'i monitorojë edhe ligjet të cilat i nxjerr Kuvendi i Kosovës dhe të cilat janë të dekretuara nga Presidenti i Kosovës, ka marrë për obligim që të monitorojë Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale për vitin e shkuar, kurse për këtë vit do të monitorojë edhe Ligjin penal për të mitur edhe Ligjin për falje.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në bashkëpunim me Institutin Nacional Demokratik, ka hartuar në fillim Planin e veprimit, ka hartuar komplet procedurat e veprimit të Komisionit, në bashkëpunim me gjithë anëtarët e Komisionit, me anëtarët e

organizatave të cilat e kanë mbështetur Komisionin. Gjatë vizitave që i ka bërë: Gjykatës së Qarkut në Pejë, Gjykatës Komunale në Ferizaj, organeve drejtuese të enteve ndëshkimore, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, ka hartuar një raport, të cilin e keni para vetes, por për detalet e raportit për të gjeturat faktike, për rekomandimet, do të flasë deputeti Ibrahim Makolli. Pra, unë vetëm do të ngre disa shqetësime, të cilat nuk do t'i vëreni në raport, mirëpo të cilat shqetësime, konsideroj që janë të rëndësishme t'i kuptojnë deputetët e Kuvendit të Kosovës, por gjithsesi edhe Qeveria e Kosovës.

Me rastin e vizitave që kemi pasur, kemi konstatuar dhe e kuptojmë që ekzistojnë dhe është mungesë e kapaciteteve edhe nëpër gjykata, edhe nëpër prokurori, edhe në entet ndëshkimore, është mungesë e kapaciteteve njerëzore për të përfunduar ashtu si duhet, ndoshta, monitorimi në praktikë i ligjeve ekzistuese, mirëpo për ne shqetësuese ka qenë dhe, ndoshta, duhet të jetë në objektiva të Qeverisë së Kosovës që në të ardhmen të krijohen vende adekuate për njerëzit të cilët mbahen në paraburgim. E kuptojmë që për mungesë të hapësirës, sot në Entin Ndëshkimor në Dubravë mbahen mbi 100 veta, të cilët janë në paraburgim, gjë e cila është e ndaluar edhe me konventat ndërkombëtare, gjë e cila është e ndaluar edhe me këtë ligj të cilin po e monitorojmë.

Një çështje tjetër shqetësuese për ne është fakti se kemi hasur në njerëz të privuar nga liria, të cilët mbahen me vite të tëra në burg, pa pasur një aktgjykim të formës së prerë. Kjo është çështje shumë shqetësuese kur dihet fakti se Kodi i Procedurës Penale në nenin 395 e përcakton qartë se për sa kohë duhet të hartohet aktgjykimi i formës së prerë.

Pra, po potencoj se janë shkelur në këtë rast të drejtat dhe liritë e njerëzve të privuar nga liria, që është në kundërshtim me parimet e drejtësisë, por po shkelet edhe një parim që taksapaguesit që jemi ne të gjithë, po duhet të paguajmë për këta njerëz të cilët po mbahen me vite të tëra në burg, pa aktgjykim të formës së prerë dhe mbasandaj ka raste që edhe lirohen prej burgut si të pafajshëm.

Meqë zoti Ibrahim Makolli do të flasë për të gjeturat dhe për rekomandimet e Komisionit, unë kërkoj nga ju, zoti kryesues, t'ia jepni fjalën zotit Makolli, por i ngrita si shqetësime të Komisionit. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli, që në emër të komisionit parlamentar ta paraqet fjalën shtesë.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Sikur u tha edhe në paraqitjen e Kryetarit të Komisionit, monitorimi i këtij ligji është një pajtim me rolin e Kuvendit të Kosovës në mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe të zbatimit të ligjeve.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me qëllim të njohjes së drejtpërdrejtë me gjendjen faktike, ka mbajtur disa takime mbikëqyrëse me institucionet implementuese të ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale. Për këtë qëllim, Komisioni ka vizituar disa nga institucionet, siç janë: Shërbimi Korrektues i Kosovës, Burgu i Dubravës në Istog, Gjykata e Qarkut në Pejë, Gjykata Komunale në Ferizaj, sikurse edhe subjektet e tjera të përfshira në zbatimin e këtij ligji.

Gjatë vizitave dhe kontakteve të drejtpërdrejta me zbatuesit e ligjit, komisioni ka identifikuar probleme të natyrave të ndryshme të cilat, ose e kanë vështirësuar, ose e kanë bërë të pazbatueshëm këtë ligj. Unë do të përmend vetëm disa nga problemet e identifikuara.

1. Mosnxjerrja e të gjitha akteve nënligjore për zbatimin e ligjit sipas nenit 196.1 të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,

2. Mosmiratimi nga Ministria e Drejtësisë i rregullave për rendin e brendshëm në institucionet korrektuese, sipas nenit 196.2.

3. Mosmiratimi nga Ministria e Drejtësisë i rregullave për rendin e brendshëm në shërbim sprovues të Kosovës.

4. Mosmiratimi i ligjeve për falje dhe amnisti, kjo është e kaluar, Ligji për falje, ndërkaq Ligji për amnisti edhe më tutje nuk i është ofruar Kuvendit të Kosovës.

5. Moszbatimi fare i dispozitave të nenit 69, pranimi i pakove, kërkesat e të dënuarave gjithnjë në rritje për zëvendësimin e dënimeve me gjobë, me dënime me burg-përballë kapaciteteve të vogla të burgjeve ekzistuese, shkaktojnë që disa dënime, ose të mos ekzekutohen me kohë, ose të mos ekzekutohen fare, të parashkruhen.

6. Mangësitë në spitalet e burgjeve për trajtimin e të paraburgosurve dhe të personave të dënuar, sipas nenit 185.6

8. Problemet për ekzekutimin e dënimeve me kusht, me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues, sipas nenit 155.

9. Problemet për ekzekutimin e trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm, sipas nenit 182.

10. Vështirësitë për zbatimin e nenit 15.2
Komisioni, po ashtu, ka paraparë nevojën edhe për ndryshimin e nenit 21, sikurse edhe plotësimin e tij.

Neni 22.1 duhet të ndryshohet dhe të plotësohet, në mënyrë që të ketë mundësi të përmbushjes së kërkesave.

Neni 23 duhet të ndryshohet dhe të plotësohet.

Përfundimet e Komisionit

Komisioni për Legjislacion e Gjyqësi, pas përfundimit të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, ka nxjerrë këto përfundime:

1. Mangësitë dhe vonesat për nxjerrjen e legjislacionit sekondar nga Ministria e Drejtësisë për zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, zvogëlojnë efektivitetin e Ligjit dhe përmasat e zbatimit të tij.

2. Në zvogëlimin e efektivitetit të Ligjit kanë ndikuar edhe disa dispozita procedurale të ligjit, të cilat kanë nevojë të ndryshohen dhe të plotësohen.

3. Kapacitetet fizike, profesionale, njerëzore dhe materiale të pamjaftueshme, reflektojnë dukshëm në zbatimin e ligjit në burgje dhe gjykata.

4. Zbatimi i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale kërkon sendërtimin e kapaciteteve të veçanta për ekzekutimin e sanksioneve penale në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Ai sektor duhet t'i hartojë strategjitë, projektet dhe programet për zbatimin e Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale. Nëpër gjykata, ekzekutimi i sanksioneve në perspektivë duhet të organizohet si njësi e veçantë e specializuar dhe e pajisur me kuadër të gjykatës.

Propozimet e Komisionit

Rekomandimet për Qeverinë e Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë:

1. Të nxirren të gjitha aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, neni 196.1.

2. Të miratohen rregullat për rendin e brendshëm në institucionet korrektuese, sipas nenit 196.2.

3. Të miratohen rregullat për rendin e brendshëm në Shërbimin Sprovues të Kosovës.

4. Të ngrihet efikasiteti në dorëzim-pranimin e shkresave nga gjykatat te personat e dënuar, me theks të veçantë të atyre shkresave që dërgohen me postë.

5. Të krijohen kushte të domosdoshme për ekzekutimin e dënimeve me gjobë, sepse në të kundërtën dënimet në gjobë po shndërrohen në dënime me burgim dhe ekzekutimi i tyre po paraqet vështirësi edhe për institucionet ndëshkuese dhe një numër i tyre po parashkruhet.

6. Të ngrihen kapacitetet ekzistuese të kujdesit, të trajtimit shëndetësor në Burgun e Dubravës.

7. Ngritja e institucioneve të kujdesit shëndetësor në pajtim të nenit 182 dhe të nenit 185 të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

8. Krijimi i një sektori të veçantë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe të sektorëve të veçantë në kuadër të gjykatave për ekzekutimin e sanksioneve penale.

9. Të fillohet procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, të atyre dispozitave të cilat pengojnë ose pamundësojnë zbatimin efikas të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe, rekomandimi i fundit.

10. Ministria e Drejtësisë t'i raportojë një herë në vit Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për zbatimin e ligjeve nga fushëveprimi i vet në pajtim me Rregullën 53 të Rregullores së Punës së Kuvendit.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Ftoj shëfat e grupeve parlamentare ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ta marrin fjalën.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Në fillim, nuk e përmenda, unë fola edhe në emër të Grupit Parlamentar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Armend Zemaj e ka fjalën. Urdhëroni, zoti deputet.

ARMEND ZEMAJ: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Në raport janë të paraqitura mbledhja e informatave nga vizita në institucionet kompetente, vlerësimit i të dhënave dhe gjetjet faktike, dhe nga të gjitha këto, nxjerrja e rekomandimeve specifike për Qeverinë. Duke marrë parasysh se me këtë ligj rregullohet një fushë shumë komplekse e cila deri vonë apo nga gjysma e mandatit të kaluar ishte kompetencë e UNMIK-ut, Grupi Parlamentar mendon se me këto rekomandime për zbatim gjithnjë më efikas të ligjit, lind nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit në fjalë, për shkak të rrethanave të reja të krijuara, ku disa dispozita procedurale kanë ndikuar në zvogëlimin e efikasitetit të ligjit.

Ne e mbështesim raportin dhe inkurajojmë Ministrinë e Drejtësisë, konkretisht Qeverinë e Republikës së Kosovës, që t'i fillojë këto procedura. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Nga Grupi Parlamentar i AKR-së, nuk është i pranishëm deputeti.

KRYESUESI: Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, Bajram Kosumi e ka fjalën.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi ynë parlamentar i mbështet rekomandimet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Ne kemi qenë pjesë e ekipit në hartimin e këtij raporti dhe ndaj mendimin edhe e mbështesim plotësisht atë që thuhet në raport.

Unë në fjalën time do t'i kisha ndarë katër çështje, të cilat duhet të kihen parasysh prej Ministrisë së Drejtësisë dhe ministrive tjera që ndërlidhen me çështjet konkrete.

Së pari, një prej problemeve që kemi identifikuar në funksionimin e gjykatave në Kosovë në raport me ekzekutimin e sanksioneve penale, është i natyrës administrative në gjykata. Gjykatat nuk kanë persona, nuk kanë administratë të mjaftueshme për të komunikuar me personat, me qytetarët që kanë punë me gjykatën. Kështu, për shembull, në Gjykatën e Ferizajt, sa i përket qytetit të Ferizajt, gjykata ka njerëz të vetë që komunikon me

personat që janë në kontakt me gjykatën, do të thotë, janë pjesë e gjykimeve të ndryshme. Por, sa po të kalohet prej qytetit, gjykata komunikon me personat nëpërmjet PTK-së. Menjëherë zinxhiri shkëputet, gjykata kurrë nuk është e sigurt a e ka marrë personi i caktuar një ftesë apo nuk e ka marrë, a i ka shkuar personit ftesa për të ardhur në gjykatë, apo nuk i ka shkuar, a ka personi i caktuar adresë, apo nuk ka adresë? Nuk e ka të saktë adresën. A është personi në shtëpi, apo nuk është që kur kthehet letra, që nuk është në shtëpi, e tjera? Do të thotë, mungon një zinxhir i komunikimit gjykatë, person fizik, mungon kjo dhe gjykatat një pjesë të madhe të punëve nuk mund ta kryejnë, sepse mungon ky komunikim. I inkurajoj Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Shërbimeve Publike dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme që të bashkëpunojnë, që të gjejnë një zgjidhje se si mund të komunikojë gjykata në mënyrë të plotë me personat fizikë.

Çështja e dytë, që duam të bisedojmë, është një problem i theksuar shumë në të gjitha takimet që kemi pasur nëpër gjykata, e që është shndërrimi i dënimit me të holla në dënim me burg. Do të thotë, për shumë vepra, personat dënohen me të holla. Ata nuk kanë mundësi të paguajnë ose nuk duan të paguajnë, nuk kanë para të paguajnë dhe kërkojnë që dënimi me të holla t'u shndërrohet me dënim me vuajtje të burgut. Kjo është një shfaqje për analiza më të thella se ndoshta jemi ndër vende të rralla që ndodh një shfaqje e tillë, do të thotë njeriu nuk paguan me para, por kërkon të shkojë në burg për ta vuajtur dënimin me burg. Problemi shfaqet tash te ky elementi i dytë, burgjet e Kosovës nuk kanë hapësira të mjaftueshme që t'i pranojnë të gjithë këta njerëz dhe këtu krijohet një problem i madh. Njerëzit kërkojnë që t'u shndërrohet dënimi prej dënimit në të holla me dënim me burg, gjykatat e bëjnë këtë, ndërsa në burgje nuk ka vend dhe njerëzit mesin duke u endur andej e këndej. E inkurajoj Ministrinë e Drejtësisë që të shikojë në ndryshimin e Ligjit penal dhe të Ligjit për sanksionet penale, që të fusë një paragraf të ri, që të shikojë mundësinë e dënimit me punë të detyrueshme në të mirë të publikut. Këta persona që kërkojnë shndërrimin e dënimit nga dënimi me të holla, në fakt të mos dënohen me burg, por të dënohen me punë të detyrueshme në të mirë të publikut. Në shumë vende demokratike kjo normë ekziston, është shumë në rregull të jetë edhe në Ligjin tonë penal dhe në Ligjin për sanksionet penale.

Çështja e tretë, ndërlidhet me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Shëndetësisë, me këto dy ministri, është lidhur me problemin e personave që dënohen me shërim të detyrueshëm. Edhe në raport është përmendur kjo çështje, me këtë problem jemi ballafaquar kudo që kemi vizituar gjykatat. Problemi që ta thjeshtësoj, është ky. Në Kosovë nuk ka një vend, spital, nuk ka një spital ku mund të trajtohen personat e dënuar me shërim të detyrueshëm. Këtu kryesisht bëhet fjalë për kriminelët, por që kanë çrregullime mendore, ose për ata që dënohen për shkak të narkomanisë, ose çfarëdo qoftë shërimi që gjykata mund të shqiptojë dënim me shërim të detyrueshëm. Në Kosovë nuk ka një vend ku trajtohen personat pasi të janë dënuar. Nuk po flas për fazat paraprake, por pasi të jenë dënuar, ndërsa anëtarët e Komisionit që kemi qenë, praktikat çka ndodh me këta persona, janë shumë të çuditshme në Kosovë. Do të thotë, gjykatat shqiptojnë këtë dënim, e shqiptojë dënimin për vepër, do të thotë, shërim të detyrueshëm, mund që një person të ketë bërë vepra kriminale, vrasje për shembull, i shqiptohet dënimi me shërim të detyrueshëm dhe ai s'ka ku e vuan dënimin. Ose dërgohet në burg, ose ka praktika edhe më të këqija, lihet në liri. Është, do të thotë, një shfaqje shumë e dëmshme, shumë e rrezikshme dhe i inkurajojmë Ministrinë e Drejtësisë dhe të Shëndetësisë që ta përshpejtojnë punën në themelimin dhe ndërtimin e një spitali që do t'i trajtojë personat e dënuar me shërim të detyrueshëm.

Dhe, çështja e fundit, ka të bëjë pak me vizionin për ekzekutimin e sanksioneve penale. Efektiviteti i ligjeve varet nga efikasiteti i sanksioneve të tij. Ky është një përkufizim i njohur për ligjet demokratike në përgjithësi. Nëse një ligj nuk ka efekt në ekzekutimin e sanksioneve të tij, ligji nuk është i mirë. Në Kosovë, pak për shkak të pasojave të luftës, pak për shkak të regjimeve totalitare komuniste të mëhershme, pak për shkak se ende institucionet tona nuk kanë mund të stabilizohen si duhet, por të gjitha nga pak kanë ndikuar që drejtësia dhe ekzekutimi i sanksioneve penale në Kosovë ta ketë vetëm një fytyrë, e kjo fytyrë është ndëshkimi. Ndërsa, sanksionet penale në botën demokratike e kanë edhe fytyrën tjetër. Fytyra tjetër e sanksioneve është përmirësimi, rehabilitimi i atyre që kanë bërë krime ose shërimi. Sanksionet penale në Kosovë ende nuk e kanë këtë fytyrë të dytë dhe ne inkurajojmë Qeverinë e Kosovës që të fillojë të mendojë dhe të ndërmarrë veprime konkrete që të shihet edhe fytyra e dytë e ekzekutimit të sanksioneve penale, do të thotë, përmirësimi i njerëzve të dënuar, rehabilitimi i tyre, shërimi i tyre. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Adem Salihaj e ka kërkuar fjalën.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, përkundër angazhimeve të mëdha dhe numrit të madh të ligjeve të cilat kanë kaluar nëpër këtë komision, përkundër punës së madhe me intervistime dhe përzgjedhje të kandidatëve për organe, komisione dhe agjencione të ndryshme, ka pasur një angazhim dhe monitorim të punës së Ministrisë së Drejtësisë, veçanërisht në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale. Zbatimi i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale është kompleks dhe kap segmente të Ministrisë së Drejtësisë, të Gjyqësorit dhe të institucioneve për mbajtjen e dënimit. Puna e Komisionit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale nuk ka qenë e lehtë dhe herë-herë ka pasur edhe vështirësi. Së pari, na është dashur të presim rreth 3 muaj për një përgjigje të Ministrisë së Drejtësisë në kërkesën tonë që ta vizitojmë Burgun e Dubravës dhe, pasi nuk kemi marrë një përgjigje, ne kemi bërë një shkresë të dytë, ku në mënyrë decitive kemi caktuar datën dhe kemi caktuar një vizitë në Nurgun e Dubravës. Megjithatë, Komisioni e realizoi vizitën në Burgun e Dubravës dhe mori mjaft të dhëna të dobishme për hartimin e këtij raporti.

Me këtë rast dëshiroj ta cek angazhimin serioz të komisarit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, si dhe të drejtorisë së Burgut të Dubravës, të cilët na ofruan kushte të domosdoshme që ta kryejmë me sukses punën tonë. Në Burgun e Dubravës morëm informata të bollshme lidhur me punën dhe problemet me të cilat ballafaqohen gjatë ekzekutimit të sanksioneve penale. Vizituam shumicën e pavijoneve, Qendrën mjekësore ose spitalore dhe biseduam me shumë të burgosur. Të burgosurit nuk u ankuan për kushtet dhe trajtimin. Ne nuk hasëm në raste të keqtrajtimit të të burgosurve, por kujdesi shëndetësor nuk ishte në nivelin e paraparë me ligj, sepse nuk kishte mjekë të mjaftueshëm dhe, në fakt, nuk funksiononte spitali, i cili parashihet të jetë me ligj. Të burgosurit trajtohen në spitalet publike, vendosen në të njëjtat dhoma dhe reparte me të sëmurë që nuk janë të dënuar, gjë që paraqet problem, jo vetëm për qendrat spitalore publike, por edhe për institucionet për ekzekutimin e sanksioneve penale. Ajo që ra në sy dhe ishte problem serioz ishte mungesa e madhe e udhëzimeve administrative, të cilat është dashur që moti t'i hartojë apo miratojë Ministria e Drejtësisë. Prej rreth 16

udhëzimeve administrative, Ministria e Drejtësisë kishte hartuar vetëm 3 sosh, edhe pse afati ligjor për hartimin e tyre ka kaluar që moti. Mungesa e këtyre udhëzimeve administrative shkakton probleme serioze për zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale. Një prej çështjeve që nuk ishte rregulluar me udhëzim ishte edhe çështja e pakove ushqimore dhe higjienike, të cilat kanë të drejtë t'i marrin të dënuarit nga familjet e tyre. Në fakt, atyre nuk u lejohet marrja e këtyre pakove, si pasojë e mungesës së udhëzimit përkatës administrativ, edhe pse kjo u lejohet me ligj. Një kërkesë të veçantë dhe këmbëngulëse të burgosurit e Burgut të Dubravës e kishin lidhur me aprovimin sa më të shpejtë të Ligjit për faljen dhe të atij për amnisti, të cilët u ishin premtuar nga Presidenti i Kosovës dhe ministria e Drejtësisë. Nga biseda me përgjegjësit e Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe me ata të Gjykatës Komunale në Ferizaj, pamë se gjykatat ballafaqohen me probleme të shumta gjatë zbatimit të dispozitave të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale. Ato janë të dukshme, veçanërisht në dërgimin e ftesave të cilat u përmendën këtu disa herë, dhe të vendimeve për ekzekutimin e dënimeve- një pjesë të cilave e bëjnë vetë gjykatat, kurse një pjesë bëhet nëpërmjet postës. Shpesh ato ftesa dhe vendime dërgohen me vonesë të madhe, apo ndonjëherë nuk mund të dërgohen fare, si pasojë e kushteve joadekuate në të cilat punojnë gjykatat.

Po ashtu, problem të veçantë paraqet ekzekutimi i dënimeve me të holla, respektivisht shndërrimi i këtij dënimi në dënim me burg. Në këtë aspekt, Ministria e Drejtësisë, burgjet dhe gjykatat duhet të angazhohen më tepër në mënyrë që të vendoset rregulli i domosdoshëm për ekzekutimin e këtij lloji të dënimit.

Në fund, Grupi Parlamentar i LDD-së, duke përkrahur këtë raport dhe rekomandimet që dalin prej tij, kërkon një angazhim më serioz nga Ministria e Drejtësisë që të eliminohet ngecja shumë e madhe për hartimin e udhëzimeve të domosdoshme administrative, të cilat janë bërë pengesë serioze për zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale. Kërkojmë që të krijohen kushte të domosdoshme për gjykatat përkatëse, në mënyrë që të mos ketë ngecje në zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale. Siç e thamë, ato ballafaqohen me vështirësi të shumta. Vlen të theksohet në mënyrë të veçantë gatishmëria e Gjykatës Komunale dhe e Prokurorisë Komunale në Ferizaj, të cilat na ofruan ndihmën e nevojshme për hartimin e suksesshëm të këtij raporti. Falënderojmë, po ashtu, komisarën e Shërbimit Korrektues dhe drejtorinë e Burgut të Dubravës për angazhim serioz dhe ndihmën që na e dhanë që misioni ynë të kryhet me sukses.

Grupi Parlamentar i LDD-së konsideron se ky raport dhe rekomandimet që dalin prej tij do të shërbejnë për përmirësimin e kushteve për zbatimin më me sukses të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Dozvolite da vas pozdravim, gospodine predjedavajući, kao i prisutne ministre i kolege,

Ja ću se pridružiti prethodnim diskutantima jer sam i sam član Komisije za zakonodavstvo i pravosudje, tako da smo zaista u ovom periodu koji je iza nas i ima veoma mnogo aktivnosti koje su ovde iznete, jer smo posetom najvećem zatvoru na Kosovu, posetom Okružnom zatvoru u Peći, potom u Ferizaju i svim onima što nam je omogućeno i što smo videli na licu mesta, mogli smo da napravimo vrlo solidan izveštaj i

da dodjemo do preporuka koje su danas prenete ovde. Mislim da je komisija imala za cilj i da je to i postigla da vrši kontrolu sprovođenja Zakona o izvršenju krivičnih sankcija i mislim da je nivo uslova koji smo videli zaista na jednom zavidnom nivou i mislim da smo bili u mogućnosti da neposrednim razgovorom sa različitim strukturama zatvorenika, sa različitim strukturama dužine na koji su oni osudjeni, mogli da se uverimo iz prve ruke sa uslovima u najvećem zatvoru na Kosovu. Potom, aktivnosti Komisije koja je trajala permanentno čitavu godinu dana, mislim da je rezultirala time što je izveštaj urađen analitičan i stručan kao i preporuke koje će pomoći daljnje izvršenje, odnosno izvršenje ovog Zakona o krivičnim sankcijama.

Parlamentarna grupa „7+“ prihvata preporuke izveštaja. U verziji na drugom službenom jeziku potkrajene su mnoge tehničke, jezičke i lektorske greške i nadamo se da u daljem postupku one će biti otklonjene. Mi i izveštaj i preporuku u potpunosti podržavamo. Hvala vam!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputeti Bojan Stojanoviq. E keni fjalën, deputet!

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala vam, gospodine predsedavajući i uvaženi ministri, poštovani kolege poslanici, Parlamentarna Grupa „7+“ je razmotrila ovaj izveštaj i podržaće usvajanje u Skupštini i, naravno, Komisija je dobro odradila svoj posao. Ja ne bih mnogo da dužim, sve ono što su prethodni govornici rekli, u potpunosti se slažem. Komisija je evidentirala probleme i neophodno je da se oni reše. Smatram da će Ministarstvo pravde imati kapacitete kao i do sada u onome što je radila i da će da radi na zakonu koji će kvalitetniji biti i koji će omogućiti bolje izvršenje tih krivičnih sankcija. Međutim, želim da iskoristim priliku da kažem samo da trebamo da razumemo da postoje i mnogi ljudi koji čekaju da se pravda zadovolji, tako da bi uporedo možda trebali da radimo i na tom zakonu, da sudovi ubrzaju malo svoj rad i da ti postupci budu efikasniji kako bi pravda bila zadovoljenija i ujedno implementacijom ovog zakona i poboljšavanjem uslova za izvršenje krivičnih sankcija steći će se uslovi da svi ti ljudi koji su se ogrešili o zakonu, znači zato jednostavno plate i, naravno, slažem se da ova lakša krivična dela, pogotovo u saobraćaju i slične oblasti, budu zamenjena sa nenovčanim kaznama ili smeštajem u zatvorskim prostorijama, već sa društveno korisnim radom. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka kërkuar pas përfaqësuesve të grupeve parlamentare, ministria Nekibe Kelmendi. E keni fjalën zonja Kelmendi.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Raportin e dërguar nga Komisioni për Legjislacion, Gjyqësi, unë e kam lexuar më përpara në gazeta, e më pastaj e kam marrë zyrtarisht prej këtij komisioni. Mendoj se nuk është në rregull që një raport para se të dërgohet në procedurë parlamentare, t'u dërgohet gazetave, nëse s'ka ndonjë qëllim të caktuar, megjithatë unë do të përqëndrohem në raport.

Në raport thuhet se Ministria e Drejtësisë nuk qenka përgjigjur në shkresën e Komisionit me të cilën kishte kërkuar për ta vizituar Burgun e Dubravës më 24.6.2008, gjë që për pasojë e paska vonuar realizimin e vizitës në Burgun e Dubravës. Më vjen shumë keq që Komisioni qenka vonuar për vizitë, por kjo nuk është bërë me qëllimin e Ministrisë. Si

ministre e Drejtësisë nuk kam qenë e informuar lidhur me shkresën që është dërguar por, megjithatë, unë sidoqoftë e çmoj shumë vizitën që e ka realizuar Komisioni më 10.9.2008, sepse Burgu i Dubravës është i hapur, jo vetëm për këtë Komision, por edhe për Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut dhe shumë organizata joqeveritare që ta vizitojnë dhe të njihen me punën e atij shërbimi.

Por, një gjë duhet ditur, duhet ditur se kujt duhet t'i adresohen vërejtjet dhe kritikët për moszbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, sepse siç u përmend këtu, këtë ligj nuk është e detyruar ta zbatojë vetëm Ministria e Drejtësisë, por ndërlidhet edhe me punën e gjykatave, për çka do të flas më vonë dhe këto shqetësime u ngritën gjatë diskutimit dhe nuk ishin pjesë e raportit.

Sidoqoftë, mirë është që, megjithatë, Komisioni e ka realizuar, thashë, vizitën dhe ka dhënë një raport çfarë e kemi ne përpara.

Ky komision parlamentar, si dhe të gjitha organizatat e tjera joqeveritare që merren me të drejtat e njeriut, i kanë të hapura dyert për atë që nuk paraqet konfidencialitet që ta vizitojnë Burgun e Dubravës dhe qendrat e paraburgimit.

Ministria e Drejtësisë është shumë transparente në punën e saj dhe ka lejuar vizita në Burgun e Dubravës, në Qendrën Korrektues në Lipjan dhe në 6 qendrat e paraburgimit, të cilat vizitohen, jo vetëm nga ky komision, por edhe nga, siç e thashë: Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, OSBE-ja, EULEX-i dhe organizatat tjera joqeveritare, sepse është e interesuar që edhe nëpërmjet kritikave ta përmirësojë punën në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe në qendrat e paraburgimit dhe të burgosurit të trajtohen sipas standardeve ndërkombëtare dhe tërësisë së rregullave minimum për trajtimin e të burgosurve të adoptuar nga Kongresi i Kombeve të Bashkuara për parandalimin e krimeve dhe trajtimin e keqbërësve, të mbajtur në Gjenevë më 1955 dhe të miratuar nga Këshilli Ekonomik e Shoqëror, me rezolutat e tij 663/C, datë 31 korrik dhe më 1957 numër 2076, datë 13 maj 1977.

Komisioni ka gjetur se nuk ka arritur t'i sigurojë rregulloret për rendin e brendshëm dhe institucionet korrektuese. Mirëpo, Komisionit i janë prezantuar këto rregulla dhe ka mund t'i lexojë aty për aty ato, por meqë këto rregulla janë konfidenciale nuk lejohet që ato të nxirren jashtë Shërbimit Korrektues, sepse me to rregullohen çështje që lidhen me sigurinë e të parandaluarve, të dënuarve: mënyrat e menaxhimit të burgosurve me rrezikshmëri të lartë, mënyra e kontrollimit të zonës apo perimetrave, rrethojat e sigurisë, hyrje-daljet, fshehtësia e informacionit, shpërndarja dhe zbulimi i informacionit, përcjellja e të burgosurve me rrezikshmëri, e tjera.

Është me rëndësi që komisionari i Shërbimit Korrektues, me autorizimet e ministrit, më 1.7.2007, pra, para se të jem unë ministre, ka nxjerrë të gjitha rregulloret – 18 rregullore të cilat janë të nivelit më të ulët se sa udhëzimet administrative dhe punon në bazë të tyre, sepse këto rregullore nuk janë në kundërshtim me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale. Unë këtu kam para veti numërimin e gjitha rregulloreve dhe të udhëzimeve administrative dhe për të mos ju marrë kohë, nuk do t'i lexoj të gjithë titujt e rregulloreve.

Vërejtja vijuese i referohet mosrespektimit të afatit gjashtëmuor për nxjerrjen e udhëzimeve administrative, afat ky i caktuar me nenin 196 të Ligjit për ekzekutimin e

sanksioneve penale. Mirëpo, duhet pasur parasysh faktin se ligji në fjalë është miratuar në vitin 2005, kur nuk ka qenë fare e themeluar Ministria e Drejtësisë dhe kur kompetencat e Shërbimit Korrektues të Kosovës i ka pasur UNMIK-u. Edhe pas themelimit të Ministrisë së Drejtësisë, këto institucione i ka menaxhuar UNMIK-u dhe posa ka filluar transferimi i kompetencave në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe në disa departamente dhe sektorë të kësaj ministrie, janë nxjerrë të gjitha rregulloret dhe udhëzimet administrative si mekanizma për zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale. Këto kompetenca nuk janë transferuar menjëherë, por në etapa, përkatësisht në faza të ndryshme. Udhëzimet më të rëndësishme që ka nxjerrë dhe që dalin si obligim nga ligji janë: Udhëzimi administrativ për shërbimin korrektues, datë 1.10.2007; Udhëzimi administrativ për kalimin e kohës së të burgosurve në lokale të veçanta, datë 1.4.2008; Udhëzimi administrativ për menaxhimin zyrtar të arkivit të Shërbimit Korrektues, datë 7.7.2008; Udhëzimi administrativ për strukturimin e pozitave menaxhuese të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Udhëzimi administrativ për lejimin dhe zbatimin e gjysmë lirisë për të burgosur, që është nxjerrë pas raportit të hartuar dhe nuk ka mund të përfshihet në këtë raport, gjithsesi. Gjithsej janë nxjerrë 5 udhëzime administrative dhe 18 rregullore si akte nënligjore.

Në raport përmendet mosnxjerrja e Ligjit për falje. Edhe kjo çështje ka përfunduar dhe është e tejkaluar.

Sa i përket Ligjit për amnistinë, ky ligj nuk gjen bazë kushtetuese për t'u nxjerrë, për t'u draftuar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe për këtë arsye ministria e Drejtësisë nuk mund të mbajë përgjegjësi për mosdraftimin e Ligjit për amnisti. Posa të ndryshohet Kushtetuta dhe të parashihet, edhe Ligji për amnistinë do të hartohet. Është e vërtetë se tani nuk po praktikohet lejimi i dërgimit të pakove, siç është cekur në raport, gjë që parashihet me nenin 69 të Ligjit. Kjo po realizohet në tjetër mënyrë, që për mendimin tonë është mënyrë më e përshtatshme dhe më e avancuar sesa ajo që e parasheh ligji. Kjo po realizohet me dorëzimin e parave nga familjarët dhe të afërmit me të cilat të burgosurit vetë e formojnë pakon sipas përzgjedhjes së tyre, gjë që ata i siguron nga helmimi dhe ushqimi i sjellë me pako dhe futja e drogës në artikuj ushqimor që do t'u silleshin me pako. Ekziston spitali i burgut, ndonëse pat vërejtje këtu se nuk ka spital. Burgu ka spitalin e vet për trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve, i cili ofron shërbim 24 orësh, ku punojnë teknikë dhe specialistë. Në kohën kur Komisioni ka vizituar burgun, ne kemi shpallur disa herë konkursin për mjekë, mirëpo për shkak të pagës së ulët, nuk kanë ardhur mjekë. Megjithatë, shërbimi shëndetësor nuk ka munguar, sepse ata në marrëveshje me Ministrinë e Shëndetësisë janë dërguar nëpër qendra të ndryshme mjekësore dhe u është ofruar ndihma e nevojitur apo e duhur, megjithatë në Qendrën spitalore tani për tani punojnë teknikë dhe specialistë....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Le t'i vazhdohet diskutimi ministres!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: ... e cila ofron shërbim 24 orësh, ku punojnë teknikë dhe specialistë. Në rast nevoje, thashë, këta persona dërgohen edhe në qendra spitalore jashtë spitalit.

Kjo është arritur me memorandumun e nënshkruar ndërmjet këtyre dy ministrive. Spitali i burgut është i pajisur me të gjithë aparaturën e nevojshme, duke përfshirë edhe rëntgenin,

edhe skanerin, edhe pajisjet për shërbimet dentale, edhe pajisjet tjera, kështu që mund të them se është më mirë i pajisur se sa disa institucione shëndetësore publike. Ka probleme lidhur me ekzekutimin e dënimeve me kusht, me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues në institucione përkatëse apo, thënë më shkurt, ka pengesa për dërgimin e personave me te meta mentale që kanë kryer vepra penale. Kjo po ndodh për faktin se në Kosovë ende nuk kemi një institucion të ndërtuar për rastet e tilla, ku do të duhej së pari t'i nënshtroheshin shërimit këta persona, e pastaj nëse do të shërohen, do të duhej t'iu nënshtroheshin edhe dënimeve, sepse shërimi është masë, nuk është dënim.

Megjithatë, në spitalin e burgut dhe në repartet e veçanta të qendrave spitalore në psikiatri, secili spital e ka ndarë nga një dhomë të veçantë për këto nevoja deri në kohën kur do të ndërtohet institucioni i përmendur. Unë kam kërkuar me buxhetin e Kosovës të jepen mjete për ndërtimin e këtij institucioni, sepse një vërejtje e tillë jepet edhe në raportin e progresit, mirëpo, meqë ka implikime buxhetore, nuk ka mund të realizohet kjo dispozitë e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Masa e trajtimit të personave të varur nga droga, të cilët kanë kryer vepra penale, realizohet në spitalin e burgut. Ata vendosen në repart të veçantë, për trajtim të veçantë dhe në rast të krizave, personave të tillë iu jepet falas metadoni dhe u ofrohet trajtimi adekuat nga mjeku. Dhe, më besoni se këta persona që kanë qenë të varur nga droga, pikërisht duke i falënderuar trajtimit adekuat, kanë arritur që në lokalet e burgut të Dubravës, përkatësisht të spitalit të gjejnë shërim.

Disa vërejtje tjera lidhur me dërgimin e personave në mbajtjen e dënimeve të shqiptuara nuk kanë lidhmëni me Ministrinë e Drejtësisë, por më tepër u referohen gjykatave. Fjala ishte për shqetësimet e ngritura edhe nga diskutimet këtu, siç është vonesa e dërgimit të personave të dënuar në mbajtje të dënimit. Shërbimi Korrektues i Kosovës, Ministria e Drejtësisë dhe Qendra Korrektuese, nuk janë të detyruar t'i marrin vetë personat në mbajtje të dënimit, por janë gjykatat ato të cilat duhet t'i thërrasin ata persona në mbajtje të dënimit dhe nëse ata brenda afatit nuk i përgjigjen ftesës së gjykatës për të filluar mbajtjen e dënimit, atëherë është policia që ata do t'i dërgojë në mbajtje të dënimit dhe prej atij momenti, atëherë të gjitha përgjegjësitë i kalojnë Shërbimit Korrektues, përkatësisht Burgut të Dubravës dhe Qendrës Korrektuese në Lipjan.

Është e vërtetë se edhe gjykatat kanë pengesa në dërgimin e thirrjeve, sepse ka migracion shumë të madh brendapërbrenda Kosovës, adresat nuk janë të sakta, adresat ndryshojnë herë pas herë....

KRYESUESI: Ju lutem, ministre...

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Vetëm edhe diçka. Unë nuk e di se si nuk i pengon Komisionit për Çështje Gjyqësore që Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka dhënë asnjëherë raport, nuk i ka raportuar asnjëherë këtij Parlamenti për mangësitë që janë në gjykata dhe në prokurori, të cilat Ministria e Drejtësisë nuk i menaxhon. Është detyrë e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial që të vijë një herë në vit dhe t'i raportojë dhe të diskutohen të gjitha mangësitë me të cilat hasim në gjykata. Ata janë, përkatësisht gjykatat duhet t'i shqiptojnë masat alternative dhe shndërrimin e dënimit me gjobë në burg dhe anasjelltas. Nuk mund t'i shndërrojë këto Shërbimi Korrektues, sepse nuk e ka këtë kompetencë. Nga ana tjetër, gjykatat duhet të shqiptojnë sa më shumë dënime alternative dhe mos të përkufizohen vetëm, të mos përqendrohen vetëm me dënime me burg. Kodi Penal i

parasheh edhe dënimet me punë të dobishme për shoqërinë, por nuk është kjo përgjegjësi e Shërbimit Korrektues dhe e Ministrisë së Drejtësisë, por e gjykatave. Më duhet të them se ka edhe vendime që nuk janë hartuar edhe për 60 muaj, ka edhe të akuzuar....

KRYESUESI: Ministre, ndoshta do të ishte mirë ta përfundoni fjalën!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Mirë, do ta përmbyll. Unë megjithatë i vlerësoj të gjitha vërejtjet që i ka bërë Komisioni si vërejtje që janë të dobishme dhe japin kontribut që të përmirësohet edhe më tutje Shërbimi Korrektues dhe qendrat e paraburgimit, të Burgut të Dubravës dhe Qendra Korrektuese në Lipjan. Kam pasur edhe shumë çka për të thënë, sepse të gjitha po i adresohen Ministrisë së Drejtësisë, ani pse Ministria e Drejtësisë ka kompetenca shumë të kufizuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministre! 16 minuta i keni pasur, dhe besoj janë mjaft. Për replikë, deputeti dhe kryetari i Komisionit, Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Jo ndoshta për replikë, por është mirë t'i qartësojmë disa çështje.

Së pari, mos ta marrim se nuk ka asnjë tendencë, e nderuara ministre. Ne kemi monitoruar një ligj. Në raport i kemi shkruar të gjitha urdhëresat të cilat kanë qenë dashur të nxirren nga ju brenda afatit të paraparë ligjor. Nuk po flasim për kohën e hyrjes në fuqi të ligjit, sepse e kemi cekur në raport, por po flasim nga momenti i themelimit të Ministrisë së Drejtësisë, keni pasur afat 6 mujor për t' i nxjerrë udhëzimet apo urdhëresat – shkruan në ligj, por po i pranojmë edhe si udhëzime administrative të cilat nuk janë bërë.

Çështja e gazetës. Nuk ka asnjë tendencë, e nderuara ministre, por ju e dini që në seancën e kaluar ka qenë në rend dite të shqyrtohet monitorimi i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe në mungesë tuajën është shtyrë ky diskutim për sot dhe askush nuk mund t'ua ndalojë as gazetarëve të cilët i kemi prezentë çdo kund....

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Replika, është një minutë, sa unë e di. Atëherë, vazhdojani fjalën deputetit Bahri.

BAHRI HYSENI: Janë çështje shumë me rëndësi. Domethënë, nuk është çështja e gazetës që ka dalë nga anëtarët e Komisionit, por pika e rendit të punës është shtyrë në mungesë të ministres dhe, natyrisht, rendi i punës ka qenë publik, dokumentet dikush edhe nga deputetët ka mund t'i lë në hallë.

Askush nuk ka thënë dhe raporti nuk thotë se mungon spitali në entet ndëshkimore. Ekziston spitali, por nuk ka mjekë të përhershëm dhe permanentë. Këtë e kemi thënë në raport.

Askush nuk po e akuzon as ministren, as Qeverinë për udhëzimet të cilat bien në barrë t'i nxjerrin gjykatat dhe organet tjera, por konkretisht po flasim për udhëzimet administrative të cilat janë obligative për Ministrinë e Drejtësisë dhe po më vjen mirë që nga momenti i hartimit të dokumentit qenkan nxjerrë edhe dy udhëzime administrative dhe përgëzojmë për këtë punë.

Është diçka çështje që u ngrit këtu edhe me Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Deri në nxjerrjen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës nuk e kemi pasur mundësinë ta thërrasim apo të kërkojmë raport prej Këshillit Gjyqësor të Kosovës, këtë çështje do ta bëjmë, por është çështje që nuk ndërlidhet me raportin.

E vërtetë është se në raport e kemi shkruar se nuk kemi pasur mundësi për t'i marrë rregullat e brendshme të cilat janë në entet ndëshkimore, por nuk e kemi shkruar as si rekomandim dhe as si të gjetur faktike, sepse kemi konsideruar se këto rregulla të brendshme duhet të ruhen dhe për shkak të konfidencës, por e kemi shkruar që rregullat e brendshme, të cilat janë nxjerrë nga organet brenda burgut, kanë qenë dashur domosdo ta aprovohen nga Ministria e Drejtësisë, sepse nuk është shumë në parimet demokratike që dikush të nxjerrë vetë rregulla dhe t'i implementojë në praktikë apo për këto rregulla të aplikojë sanksione vetë, sepse ligji nuk e thotë ashtu.

Prandaj, e nderuara ministre, ndoshta, ka qenë më mirë t'iu përmbahemi rekomandimeve që i kemi dhënë, se janë çështje të cilat i ka përcaktuar ligji dhe jo ne, dhe të mos marrim çështje të cilat nuk i kemi dhënë në rekomandime, sepse disa çështje të cilat ju i ngritët, janë jashtë rekomandimeve dhe jashtë të gjeturave faktike që i kemi shkruar.

Ta them të vërtetën, çështja e dërgimit të shkresave, çështja e procedimit, çështja e mbajtjes në paraburgim, janë çështje të cilat i përcakton shumë qartë Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, mirëpo ne e kemi kuptuar edhe çështjen e kompetencave të cilat nuk kanë qenë prej fillimit në Ministrinë e Drejtësisë dhe nuk kemi dashtë t'i fusim në raport.

Çështja e shkresave dhe çështja e projektvendimeve të cilat nxirren nga kryetarët e gjykatave, sidomos për çështje të caktuara, është në kompetencën tuaj për ta shqyrtuar, sepse lidhet pikërisht me ekzekutimin e sanksioneve penale kur duhet të ekzekutohen, prandaj janë disa çështje të cilave duhet t'u përmbahemi. Pra, qëllimi i Komisionit për Legjislacion nuk ka qenë për të sfiduar apo kërkuar diçka që nuk është në Ligjin e ekzekutimeve të sanksioneve penale, por kemi një qëllim të mirë që ligjet të cilat i nxjerrim, t'i zbatojmë në praktikë, sepse moszbatimi i ligjeve në praktikë ka sjellë situata në të cilën po mbesin në sirtarë dhe, natyrisht, po iu shkaktojnë dëm edhe institucioneve dhe njerëzve të cilët janë privuar nga liria. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! 15 minuta pauzë, për kafe dhe në 12,30 do ta vazhdojmë punën. Për replika dhe debate, vazhdojmë pastaj, zoti deputet...!

KRYETARI: Në radhë është deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë këtë raport e kam lexuar me kureshtje dhe kam ardhur te përfundimi se është një raport serioz, profesionalisht është i hartuar, i mbështetur në saje të hulumtimeve, të analizimeve kritike të rrethanave të konstatuara në vend. Më pastaj, është hartuar ashtu dhe janë dhënë rekomandime, bile-bile nëse nuk e teproj po, natyrisht, pa qëllim të keq dhe nuk teprohet, nëse ndokush do ta merrte, kisha aluduar që në të ardhmen të përfillet kjo metodologji e komisioneve tona kur japin raporte. Një raport që e jep një pasqyrë krejt të qartë të tematikës që i referohet ekzekutimit të sanksioneve penale dhe të shumë defekteve, unë do të isha ndalë vetëm në dy.

Një. Në e dimë fare mirë se Kushtetuta do të mbetet Kushtetutë, po të mos miratonin numër enorm të akteve ligjore. Por edhe numri më i madh i akteve ligjore do të mbeteshin ligje, akte juridike, akte ligjore, po që se nuk do të miratoheshin akte nënligjore që quhet legjislacion sekondar. Aty hynë rregulloret, udhëzimet profesionale, administrative e tjera.

Këtu në raport është thënë se prej 16 akteve nënligjore që ishte dashur të miratoheshin, janë miratuar vetëm tri, që do të thotë është një lëshim i madh sepse, prezanton dhe reflekton negativitete. Nuk është punë e vështirë për t'u bërë aktet nënligjore, kërkon vetëm angazhim, prandaj do të isha angazhuar që të bëhen të gjitha ato akte.

Dhe, në pikën e dytë, ju lutem, do të bëj një krahasim. Ngjashëm me këtë, sikundër të ndodhte që një deputet në hollin e Kuvendit të Republikës së

Kosovës të arrestohej, shembull po e zëmë, ose një qytetar po e marr, po e relativizoj pak më tepër, ad-hoc dhe të mbahej në burg me vite. Ashtu është edhe i burgosuri në vuajtjen e dënimit që nuk ka aktgjykim të formës së prerë. Nuk është fjala për ata që kanë pranuar të shkojnë në vuajtje të dënimit para se ta merrte formën, por është fjala për një numër të konsideruar të të dënuarve që vuajnë burgun, s'kanë fare aktgjykim, e mos të flasim se nuk kanë aktgjykim të formës së prerë. Nuk e di se ku mund të ndodhë kjo pos te ne. Aktgjykimi që nuk e ka marrë formën e prerë, është vetëm një presupcion i rrëzueshëm – presupcio legis tantum, që do të thotë është një hipotezë që përderisa Gjykata e Apelit nuk e vendos in meritum ankesën, e refuzon bie fjala, atëherë do të bëhej aktgjykim i formës së prerë, titullues, mund ta ndryshojë. Deri atëherë, madje nuk bën të quhet as ai i dënuari që është fajtor, po ekziston dyshimi i bazuar. Prandaj, këto dy pika janë tepër neuralgjike dhe tepër serioze që duhet shoqëria jonë, Qeveria në këtë rast, t'u kushtojë kujdes të veçantë. Dhe në këtë kontekst, në të mirë të realizimit të sendërtimit, materializimit të sanksionale penale, edhe nga raporti edhe nga diskutimet e mëparshme u pa se Ministria e Drejtësisë nuk ka ingerenca. Pra, nuk ka prerogativa të mjaftueshme, ose më së paku e më së lehti të them, më së buti, Këshilli Gjyqësor dhe Ministria nuk i kanë raportet reciproke të definuara sa dhe si duhet dhe do të duhej medoemos që të bëhej një rregullim me Ligjin për Qeverinë. Unë do të isha angazhuar kurdoherë që Ministria e Drejtësisë të ketë autorizime më tepër se është e vërtet se në pika të caktuara është e hendikepuar nga, po e zëmë, Këshilli Gjyqësor dhe doli nga diskutimet edhe nga raporti se Këshilli Gjyqësor, praktikisht e neglizhon Kuvendin, nuk i referon, nuk i raporton që nuk i përgjigjet dhe është tepër keq që Kuvendi, që është organi më i lartë i një vendi, i një shteti, në këtë rast i Kosovës, që të mos ketë, si të them, praktikisht kurrfarë pamje, kurrfarë influence në Gjyqësorin, që më së paku është 1/3 e segmentit shoqëror të vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla, le të përgatitet deputeti Gani Buçinca, në emër, me kartelë të Gani Kocit.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

E nderuara ministre,

Të nderuar deputetë,

Raportin e sotëm të Komisionit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale e mirëpres dhe dëshiroj të falënderoj Komisionin, sidomos duke marrë parasysh rëndësinë që ka ky ligj për parandalimin e kryerësve të veprave penale dhe riedukimin e kryerësve të veprave penale. Unë e kam lexuar me

kujdes raportin dhe nga raporti konstatohet se Ligji nuk është zbatuar plotësisht në praktikë dhe se nuk është efektiv sa duhet. Gjithashtu, në raport janë prezantuar nga Komisioni disa ndryshime të ligjit. Meqenëse zbatimi i këtij ligji përfshin tri nivele, do të thotë, Ministrinë e Drejtësisë, institucionet implementuese dhe gjyqin, unë gjithashtu do të përqendrohem në këto të tria, në disa vërejtje të caktuara.

Sa i përket Ministrisë së Drejtësisë, në raport theksohet mosnxjerrja e akteve nënligjore. Unë e dëgjova ministren, ajo i numëroi së paku pesë akte nënligjore, megjithatë edhe nëse janë nxjerrë pesë, nevojiten edhe njëmbëdhjetë të tjera të cilat duhet të nxirren.

Gjithashtu, sa u përket rregullave të brendshme, që kanë të bëjnë me institucionet korrektuese dhe Shërbimin sprovues, Ministria sipas ligjit duhet të bëjë miratimin e këtyre rregullave, sidomos në qoftë se këto rregulla veç ekzistojnë, ngase e kemi parë nga raporti se Komisioni nuk ka arritur të bëjë vlerësimin e këtyre rregullave, siç thuhet, për shkak të konfidencialitetit.

Një rëndësi të veçantë dëshiroj t'i kushtoj sidomos kujdesit shëndetësor, i cili nga raporti del se nuk ka kapacitete të mjaftueshme, qoftë nga ana e institucioneve shëndetësore por, gjithashtu, edhe nga ana e institucioneve korrektuese dhe sidomos në pjesën e cila ka të bëjë me trajtimin e rehabilitimit të detyrueshëm të përdoruesve të drogës dhe të alkoolit, kurse personalisht besoj se duhet të përfshihen edhe të sëmurit psikik. Prandaj, inkurajoj Ministrinë, gjithashtu, që të angazhohet në këtë aspekt si dhe institucionet shëndetësore.

Ndërsa, sa u përket periudhave kohore, gjithashtu, në disa raste paraqiten vështirësi në zbatimin e ligjit për shkak të periudhës së shkurtuar kohore, sidomos në pranimin dhe dorëzimin e urdhrit, gjegjësisht pranimin e urdhrit dhe paraqitjen e personit të dënuar.

Megjithatë, Komisioni ka propozuar, gjithashtu, që të ngrihen kapacitete, si në Ministrinë e Drejtësisë, gjithashtu edhe në gjykata. Ministrisë së Drejtësisë i ka propozuar që të ngrihet një njësi e veçantë, e cila do të hartojë strategji të projektit dhe të programit për zbatimin e këtij ligji. Ndërsa, si njësi të veçantë, gjithashtu, propozon një njësi në kuadër të gjyqësisë. Sa i përket gjyqësisë, nga raporti del se gjykatat nuk kanë kapacitete të mjaftueshme, as njerëzore, as materiale.

Në fund, kam një vërejtje. Mendoj që duhet përmirësuar raporti në pjesën ku flitet për identifikimin e problemeve, janë futur edhe ndryshimet e propozimit të këtij ligji. Në identifikim të problemeve nuk shkon ndryshimi i propozimit. Mendoj që ndryshimi i propozimit duhet të futet në rekomandime, prandaj propozoj që kjo të përmirësohet.

E kam edhe një pyetje për Komisionin, për arsye se në hyrje thotë se segment i veçantë i qëllimit të mbikëqyrjes është harmonizimi i ligjit me konventat ndërkombëtare dhe *acquis communautaire*. A është bërë kjo nga komisioni dhe, nëse është bërë, cilat janë të gjeturat?

Në fund, unë i përkrah rekomandimet e Komisionit plotësisht. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Gani Buçinca, me kartelë të Gani Kocit e ka fjalën.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar zonja ministre,

Unë e përshëndes raportin dhe, t'ju them të drejtën, sot e ndjeva veten shumë mirë si deputet në Kuvendin e Kosovës kur po shoh se, më në fund, Kuvendi i Kosovës po merr rolin që e ka dhe si detyrim kushtetues për ta kryer funksionin e vet që të kontrollojë zbatimin e ligjeve në Kosovë. Besoj se në këtë sferë në të ardhmen do të përqendrohemi të gjithë së bashku dhe mund t'ju them se raporti ishte mjaft profesional, objektiv dhe jep të dhëna shqetësuese për ne si institucione të Kosovës, por edhe për vetë qytetarët e Kosovës.

Unë nuk do t'i përsëris ato që i thanë kolegët e mi, mirëpo do të përqendrohem vetëm në tri aspekte.

E para, shqetësuese është çfarë sistemi gjyqësor po ndërtojmë në Kosovë. Unë mendoj se një sistem gjyqësor në Kosovë, i cili nuk i ka në themel të drejtat dhe liritë e individit dhe të drejtat e minoriteteve, nuk do t'i bënte nder as synimeve tona demokratike, pra do të humbte kuptimin e vet. Pastaj, një sistem gjyqësor, i cili në praktikë e sistemit gjyqësor në Kosovë nuk zbatohet ose nuk niset nga parimet e të drejtës humanitare, padyshim e vënë përball Kosovën edhe para faktorit ndërkombëtar edhe botës demokratike, në një pozicion shumë të vështirë. Në këtë drejtim, mbajtja në burg, vuajtja e dënimit të njerëzve pa vendime gjyqësore të formës së prerë, për mua janë shumë shqetësuese, ashtu qysh janë edhe shqetësuese mbajtja në burg e njerëzve duke i shkelur procedurat e ligjeve në fuqi, pa kurrfarë vendimi gjyqësor. Kjo është shumë shqetësuese dhe për këtë nuk duhet justifikuar se nuk jam unë përgjegjës, nuk është ky përgjegjës, kemi pak kompetenca. Ma merr mendja se Ministria duhet t'i fillojë menjëherë kontaktet me të gjitha ato institucione relevante në Kosovë dhe menjëherë të lirohen të gjithë të burgosurit të cilët mbahen në burgje pa vendime gjyqësore, qoftë të formës së prerë, qoftë në hetuesi, pa afat të përcaktuar, ose duke i shkelur edhe vetë ligjet që janë në fuqi këtu në Kosovë. Për këtë qëllim, ma merr mendja se ne duhet të intensifikojmë punën si Parlament dhe të dalim në mbrojtje të qytetarëve të Kosovës, sidomos kur është në pyetje liria personale e çdo individi.

Këtu ishte një problem, problemin tjetër të cilin desha ta ceku. Ne nuk mund të përballojmë si shtet i ri në themelim, në forcim të institucioneve, nuk mund të përballojmë ekonomikisht këtë gjendje të cilën e kemi në institucionet korrektuese. Unë, ma merr mendja, këtu duhet të dalë Ministria me një propozim që do të japë zgjidhje si duhet financuar institucionet korrektuese në Kosovë? Nuk mund të jetë një i burgosur barrë e buxhetit të Kosovës dhe i familjes së tij. Mirëpo, çdo kund në vendet demokratike të burgosurit realizojnë të ardhura personale në burgje. Mirëpo, për këtë qëllim unë jap një propozim i cili zbatohet edhe në vendet demokratike. Qeveria duhet të dalë me një propozim, me një ligj të posaçëm se si duhet financuar institucionet korrektuese në Kosovë. Duhet të bëjë investime në kapacitetet prodhuese dhe të ketë detyrim Qeveria që ato prodhime të cilat prodhohen nëpër burgje, t'i konsumojë vetë Qeveria nëpër ministri të ndryshme. Për shembull, inventari për shkolla mund të prodhohet në burgjet tona dhe njerëzit duhet të punonin në burg dhe t'i siguronin mjetet e jetesës, të financonin vetveten aty dhe të realizojnë të ardhura e t'u ndihmonin edhe familjeve të veta qysh ndodh në Perëndim. Dhe, unë nuk di si është ky ligj i harmonizuar me ligjet e komunitetit evropian kur nuk e ka pasur parasysh mënyrën se si duhet të vuajnë dënimin të burgosurit në Kosovë. Do të thotë, të krijohet një projekt, një ligj i veçantë që e rregullon këtë sferë ku do të investohet në burgje, në sferën prodhuese dhe Qeveria të jetë obligative, Ministria e Shëndetësisë ka nevojë për inventar, Ministria e

Arsimit ka nevojë për inventar, FSK-ja ka nevojë për inventar. Shumë artikuj që i konsumon Qeveria do të mund t'i merrte nga këto kapacitete prodhuese të institucioneve korrektuese në Kosovë. Këtë na duhet ta bëjmë sa më shpejt, në atë mënyrë që t'i rrisim kapacitetet, të risim mundësinë që ne t'i rrisim edhe kapacitetet hapësinore, se u pa se ato mungojnë në Kosovë.

Njëra ndër çështjet tjera që desha t'i ceku këtu, padyshim duhet që të rishikohet ligji, a ka më shumë kompetenca Këshilli Gjyqësor i Kosovës apo Ministria e Drejtësisë? Dhe, unë besoj që me një rishikim, me një angazhim dhe me një strategji të veçantë, unë mendoj se ka nevojë ndoshta edhe të amendamentohet ligji, kështu që Ministria e Drejtësisë të marrë më shumë përgjegjësi në këtë sferë dhe të përmirësohen gjërat edhe për këtë ne duhet të jemi shumë azhur, të jemi shumë të shpejtë për të ndërhyrë dhe për t'i mbrojtur të drejtat qytetare, por edhe të drejtat ekonomike. Nuk mund sot të tolerohet që të burgosurit të marrin ushqim nga shtëpitë e tyre, ku e deponojnë ata ushqimin. Mirëpo, atyre duhet t'u krijohen kushte që të jetojnë prej pagës së vet të cilën e realizojnë duke punuar në burg, se edhe risocializimi i tyre pastaj do të jetë shumë më i lehtë, se nuk shkojnë ata atje në pushim vjetor të burgosurit, përveç atyre kategorive që paraqesin rrezikshmëri të lartë. Një prej formave për ta zbutur këtë problem është edhe memorandum i me komunitetin e biznesit, sidomos në rajonet ku janë të vendosura institucionet korrektuese. Pra, aty mund të bëhen marrëveshje që të burgosurit gjatë ditës të shkojnë dhe të punojnë nëpër firma të ndryshme, qofshin edhe ato private. Ju falënderoj! Unë e përkrah raportin dhe përgëzoj Komisionin për punën e bërë.

KRYETARI: Deputeti Adem Salihaj, ke folur, por urdhëro edhe një herë.

ADEM SALIHAI: Kam replikë, Kryetar! Po, dy minuta do t'i shfrytëzoj. Ministrja ceku se nuk e ka pasur në dijeni shkresën tonë si Komisionin për ta vizituar Burgun e Dubravës. Mund të jetë kështu, por është një problem i Ministrisë. Ne jemi drejtuar herën e dytë me një vendim dhe Ministria ka shprehur pakënaqësi pse nuk po kërkojmë ose lusim, por po bëjmë në formë të tillë. Çështja tjetër- pakot. Pakot janë të lejuara me ligj dhe nuk mund ta vlerësojë as Ministria, as Shërbimi Korrektues a do të aplikohet ky nen i këtij ligji apo jo, a është i mirë a i keq. Pakot janë të garantuara për të burgosurit dhe atyre duhet t'u mundësohen, është çështje e tyre a do t'i marrin apo s'do t'i marrin, kurse Ministria nuk mund dhe nuk ka të drejtë ta suspendojë një nen të caktuar të ligjit. Po ashtu, edhe çështja e spitalit. Është objekti, janë pajisjet, por nuk funksionon si spital dhe Shërbimi Korrektues dhe Ministria duhet ta bëjnë atë që është e domosdoshme që ky objekt me të gjitha ato pajisje të funksionojë, vërtet, si spital. Pajtohem që janë objekti dhe pajisjet, por ai nuk funksionon si spital i mirëfilltë i burgut dhe burgjet e Kosovës kanë nevojë për një spital-burg, sepse aty duhet të trajtohen të sëmurët dhe ata të tjerët të cilëve u janë shqiptuar masat e shërimit, jo masat e dënimit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi të lajmëruar të tjerë për debat. Ministre, më duket, po e kryejmë. Shkojmë në procedurën e votimit. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Në sallë kemi 66 deputetë. Votojmë tash.

Pa kartela 2 vota "për". Faleminderit!
"Kundër" pa kartelë? Nuk ka.

Atëherë, me 61 votë “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet Raporti i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Kalojmë në pikën e radhës. Ministrja ka kërkuar që ta shqyrtojmë pikën e pestë të rendit të ditës para pikës 4. A jeni dakord?
Faleminderit!

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Departamentit për Mjekësinë Ligjore

Në bazë të Rregullës 35, pika 1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë të Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuar, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kam nderin dhe kënaqësinë që në emër të Ministrisë së Drejtësisë t’ia paraqes Kuvendit të Republikës së Kosovës, për miratim, Projektligjin për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore, i cili del si rezultat i punës dhe i përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e saj. Në fillim, dua të theksoj se dispozitat e këtij ligji janë në harmoni të plotë me dispozitat e legjislacionit të BE-së dhe të shteteve më të zhvilluara, gjë për të cilën flet edhe Deklarata e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së, e lëshuar nga Agjencioni për Integritet Evropian.

Fusha e mjekësisë ligjore është në gjendje mjaft delikate sa i përket funksionimit. Vështirësitë janë evidente, kryesisht për shkak të mungesës së legjislacionit përkatës që do të rregullonte fushën e mjekësisë ligjore në përgjithësi. Prandaj, bazuar në këtë, përmes këtij projektligji Ministria e Drejtësisë synon që të normohet fusha e mjekësisë ligjore dhe të rregullohet funksionimi i kësaj mjekësie në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, në pajtim me parimet e rregullat e shteteve më të zhvilluara evropiane dhe parimet ndërkombëtare. Ky projektligj bën bashkimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe të Zyrës për Persona të Zhdukur dhe të vetë mjekësisë ligjore. Domethënë, tri institucione fuzionohen në këtë departament, të cilat deri tani kanë funksionuar si subjekte të ndara. Kjo ka shkaktuar edhe probleme të mëdha sa i përket kryerjes së punëve profesionale, zhvillimit dhe promovimit të kuadrove të reja, vonesës në zgjidhjen e lëndëve gjyqësore e shumë çështjeve të tjera, si dhe identifikimin e personave të pagjetur.

Projektligji për Mjekësinë Ligjore paraqet, jo vetëm mekanizëm ndihmës, por edhe një domosdoshmëri si për faktin që është ligj i ri dhe modern, por edhe për faktin se ky ligj është ndërhyrje komplementare e fuqishme në përmirësimin e gjendjes ekzistuese, pa të cilin sot nuk mund të paramendohet sundimi i ligjit as në vendet më të përparuara të botës. Zyrtarët e Ministrisë së Drejtësisë, së bashku me zyrat e Qeverisë dhe ekspertët e bashkësisë ndërkombëtare nga fusha e mjekësisë ligjore, siç janë: EULEX, Ambasada Amerikane, USAID, ISO e tjera, në takimet e përbashkëta kanë punuar në hartimin e këtij projektligji në mënyrën më të mirë dhe më profesionale. Projektligji për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore rregullon strukturën organizative të këtij

departamenti, duke përfshirë menaxhimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Mjekësisë Ligjore.

Ky projektligj ka për qëllim të rregullojë në tërësi objektet e ekspertimit në fushën e mjekësisë ligjore siç janë: personat, kufomat, provat materiale, materialet e çështjeve hetimore -gjqësore, mbetjet mortore të personave të pagjetur e tjera.

Ministria e Drejtësisë tani është duke punuar edhe në hartimin e Projektligjit për autopsinë, i cili, po ashtu, është i rëndësishëm shumë të madhe dhe planifikojmë që brenda gjysmës së parë të këtij viti t'ia prezantojmë Qeverisë për miratim dhe në këtë mënyrë të plotësohet infrastruktura ligjore në fushën e mjekësisë ligjore, që do të ndikojë në parandalimin e kryerjes së mjekimeve të pandërgjegjshme. Gjithashtu, do të ndihmojë në përcaktimin e shkakut të vdekjes, në zbulimin dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale përmes identifikimit të kryerësve dhe përcaktimit të shkallës së përgjegjësisë penale nëpërmjet dhënies së mendimeve profesionale lidhur me përgjegjësinë penale të kryerësve të veprave penale.

Ky projektligj përcakton edhe parimet themelore dhe krijon mekanizma efikas për kryerjen e të gjitha aktiviteteve nga fusha e mjekësisë ligjore për realizimin e të gjitha obligimeve të kërkuara nga organet e hetuesisë dhe të Gjyqësorit. Fuqizimi i këtij projektligji është i një rëndësie të veçantë, sepse do t'i hapte rrugën shtimit të efikasitetit në punën e Prokurorisë dhe të gjyqësorit, në përgjithësi, për zbulimin e veprave të ndryshme penale, gjë e cila do të ndikonte edhe si preventivë, si dhe do të shtonte besimin e qytetarëve në punën e gjykatave, të prokurorive dhe të shërbimeve mjekësore në përgjithësi.

Ky projektligj nuk është shumë voluminoz dhe përmban gjithsej 11 nene që paraqesin tërë kompozicionin e Projektligjit, i cili është hartuar duke respektuar edhe teknikat juridike të hartimit të legjislacionit.

I nderuar zoti Kryetar i Parlamentit,

Të nderuar deputetë,

Miratimi i këtij projektligji është në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e drejtësisë dhe është me interes të përgjithshëm shoqëror, prandaj propozoj dhe ju lus që ta miratoni në lexim të parë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Pra, kërkon fjalën me kohë. Atëherë, kryetari i Komisionit, Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi e ka shqyrtuar para se të vijë në parim projektligji për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore. Duke pasur parasysh që ky projektligj ka qenë njëherë në Kuvend dhe e kemi kthyer te sponzorizuesi, jemi angazhuar edhe ne nga Kuvendi i Kosovës edhe nga Administrata, por edhe ne nga Komisioni, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe faktorët e tjerë që i përmendi ministrja dhe kemi para vetes një projektligj për të cilin konsideroj se i plotëson të gjitha kërkesat, parimet që i ka paraparë si projektligj që të aprovohet në parim.

Projektligji ka një strukturë dhe një teknikë të pranueshme juridike. Është i hartuar në mënyrë profesionale, është mjaft përmbajtësor. Ndoshta e vetmja çështje që duhet të ngrihet dhe duhet të kihet parasysh dhe do ta kemi parasysh, është çështja e harmonizimit të gjuhëve, sepse konsiderojmë që dallojnë versionet në gjuhën serbe dhe gjuhën angleze.

Po e ngre edhe një shqetësim të cilin e kanë pasur anëtarët e Komisionit për të mos u hyrë në hak, është neni 8, ku flet për dispozitat e EULEX-it, paragrafi 3 pika 1, kur flet që duhet Departamenti i Mjekësisë Ligjore të ketë edhe një bashkëkryesues nga përfaqësuesi ndërkombëtar apo nga Zyra e EULEX-it. E kemi diskutuar këtë çështje në komision. Ka pasur mendime që së paku ta ngrehim si shqetësim, mirëpo konsideroj që në takimet që kemi pasur me përfaqësuesit e EULEX-it dhe me faktorin ndërkombëtar, mendoj që nuk prish punë edhe nëse është kështu, duke marrë parasysh që një pjesë e gjyqtarëve dhe e prokurorëve të faktorit ndërkombëtar kanë edhe kompetenca ekzekutive, prandaj duke marrë parasysh se kanë kompetenca ekzekutive të cilat ua kemi lejuar me Ligjin për përzgjedhjen e lëndëve për sistemin gjyqësor, konsideroj që edhe nëse mbetet kështu, nuk është pengesë që ligji të aprovohet. Prandaj, si Komision, konsiderojmë se ligji duhet të aprovohet, në parim. Natyrisht, ndoshta pak për çështjet buxhetore do të flas kryetari i Komisionit për Buxhet dhe do të marrim sqarime të mëtutjeshme. Faleminderit!

KRYETARI: Një sqarim për kryetarët e komisioneve. Është mirë që kryetarët e komisioneve sa herë që duhet ta marrin fjalën për ligjet e caktuara, le t'i bëjnë kërkesat me shkrim, ose le të lajmërohen me kohë, por më mirë me shkrim le t'i bëjnë kërkesat. Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ka një rend dhe ka një rregull që kur trajtohet së pari një ligj, janë disa rende që kryetarët e komisioneve ose komisionet që ta thonë fjalën e vet për atë ligj dhe pastaj grupet parlamentare dhe në atë cilësi edhe ne jemi lajmëruar kështu. Ne mund ta bëjmë edhe me shkrim, nuk na prish punë ajo, ose paraprakisht ta deponojmë atje, por mos të bëjmë shumë procedura.

Se ka qenë e nevojshme të kihet një ligj i tillë, është më se evidente dhe mirë që është bërë një ligj i tillë. Ne, në raste të caktuara kemi folur edhe me ministren, ndoshta edhe gjatë kohës së miratimit të buxhetit rreth nevojës së krijimit të Departamentit për Institutin e Mjekësisë Ligjore, ose Departamentin e Mjekësisë Ligjore dhe është mirë që ligji ka paraparë që t'i fuzionojë dy institucione që kanë funksionuar deri tash, Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe Zyrën për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore që kanë funksionuar, njëri jashtë Ministrisë së Drejtësisë. Ekzistojnë buxhete për këto dy mekanizma që me miratimin e këtij ligji, me funksionimin e këtyre dyjave, në njëfarë mënyre plotësohet një pjesë që është e nevojshme për funksionimin e këtij departamenti. Por, shikuar edhe nga shkresa që i është bashkëngjitur nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, miratimi i këtij ligji krijon një kosto shtesë për buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe kjo kosto shtesë nuk është paraparë as në buxhetin e miratuar për vitin 2009, por as në kornizën buxhetore që parasheh dy vjet të tjerë- 2010 dhe 2011. Do të ishte mirë me këtë, meqë s'është ministri i Ekonomisë dhe Financave, së paku ministrja të na sqarojë se si e mendon që të plotësohet kjo kosto shtesë kur nuk ekziston në buxhetin miratuar dhe as në kornizën buxhetore dhe nuk është një kosto shumë e vogël që mund të quhet, është diku mbi 1 milion e 200-300 mijë euro, s'po i them shifrat këtu të sakta tash që të lodhemi me shifra. Shikuar nga ajo që ka kosto buxhetore, kosto shtesë buxhetore, vërtet, ne mund të miratojmë një ligj të tillë, por implementimi i tij nuk do të jetë i

mundshëm në fazën që ne dëshirojmë dhe ne kërkojmë. Prandaj, që të na hiqet kjo dilemë dhe, ndoshta, të shpresojmë që në rishikim të buxhetit në muajin qershor të plotësohet kjo, ne si Komision do të duhej të kishim paraprakisht, po them, një premtim të tillë, në mënyrë që të lëshohet ky ligj dhe të miratohet ky projektligj, sepse është më se e nevojshme dhe më se e domosdoshme. Ne, edhe më herët kemi pasur ligje tjera dhe unë nuk di si Qeveria miraton ligje të tilla, në parim, në Qeveri dhe i sjell në Kuvend dhe me koston shtesë që nuk e ka paraparë në buxhetin ekzistues të vitit ekzistues dhe as në vitet tjera dhe as në kornizën afatmesme të shpenzimeve.

KRYETARI: Edhe një herë, sa herë që deputetët tjerë, përveç shefave të grupeve lajmërohen, është mirë të lajmërohem me shkrim që ne të vazhdojmë punën pa pengesa. Jo gjithërë, unë e di rendin e diskutimeve në Parlament, po jo gjithërë kryetarët e komisioneve paraqiten për diskutim. Prandaj, sa herë paraqiten, le të lajmërohen paraprakisht, në mënyrë që ne të mos shtyhem tash kush po ka të drejtë. Sa herë që nuk janë shefat e grupeve këtu apo edhe janë këtu, por lajmërohet dhe në emër të grupit flet një deputet tjetër, ne duhet ta kemi paraprakisht me shkrim. Tash, për shembull, unë nuk di kë ta thërras në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Tash duhet t'ju pyes juve kush e merr fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike?

(Ndërhyrje)

Mirë, e sqaruat! Të shkojmë te LDK-ja. Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Projektligji për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore është shqyrtuar me kujdes të veçantë në Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Është një ligj i ri dhe i kompletuar, i cili mbulon këtë pjesë të domosdoshme të legjislacionit, duke rregulluar strukturën organizative, udhëheqjen, kompetencat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Mjekësi Ligjore në kuadër të Mjekësisë së Drejtësisë. Projektligji në tërësinë e tij përmban 28 nene, struktura sipas ndarjes formale ka radhitje të mirë dhe Grupi Parlamentar i LDK-së, përmes anëtarëve në Komisionin e Legjislacionit dhe të Gjyqësisë, do t'i paraqesë të gjitha vërejtjet e tij që mendojmë se do ta mbulojnë dhe do ta kompletojnë Projektligjin e sponzoruar. Ne e përkrahim si Grup Parlamentar dhe i japim mbështetje në parim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, këtu është e lajmëruar Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar Projektligjin në fjalë dhe normalisht jemi të bindur se është i domosdoshëm për Republikën e Kosovës, mirëpo edhe neve na intereson ta dimë nga Qeveria kur sjell Projektligjin në seancën e Parlamentit, të dimë se kostoja shtesë buxhetore ku do të sigurohet?

Nuk ia vlen që një projektligj të kalojë dhe mos të jetë i sigurt implementimi i tij, andaj ne kërkojmë nga Qeveria që të bëhet ky sqarim dhe ta dimë se ku do të sigurohet kjo shtesë buxhetore për implementimin e këtij projektligji? Deri sa ta marrim sqarimin, ne për momentin nuk kemi deklaram.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të shefave të grupeve, ndoshta ministrja na sqaron. Në emër të AAK-së, fjalën e ka kërkuar deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

E nderuar ministre,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore është i nevojshëm, sepse është e nevojshme korniza ligjore, e cila në mënyrë të unifikuar do të menaxhojë sistemin e mjekësisë ligjore, por edhe do të sigurojë shërbime mjeko-ligjore dhe përkrahje për familjet e personave të zhdukur. Deri më tani kjo sferë është rregulluar përmes dy mekanizmave të veçantë – Institutit të Mjekësisë Ligjore, që ka vepruar në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, dhe Zyrës për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Me këtë projektligj, këto dy institucione formojnë një institucion, pra Departamentin për Mjekësi Ligjore, i cili do të jetë më efikas në arritjen e qëllimit të vet. Pra, qëllimi i këtij projektligji është formimi i Departamentit për Mjekësi Ligjore, që e menaxhon sistemin e mjekësisë ligjore. Po ashtu, me projektligj janë paraparë përgjegjësitë, organizimi i këtij Departamenti, që do të sigurojë ekspertizën mjeko-ligjore, hetimet mjekësore për vdekjen, përfshirë zhvarrosjen e mbetjeve mortore të njerëzve nga lufta në Kosovë, kthimin e tyre tek familjarët, por edhe njohuri të reja, trajnime dhe ndihmë autoriteteve.

Megjithatë, kam vërejtje në projektligj, sidomos në pjesën e cila ka të bëjë me nxjerrjen e akteve nënligjore, sepse nuk është e definuar se kur do të nxirren këto akte nënligjore. Po ashtu, edhe sa i përket kostos shtesë, sidomos me themelimin e Laboratorit të Forenzikës dhe të shpenzimeve të tjera, që janë diku mbi 1 milion e që nuk dihet, për shkak se nuk janë paraparë në projektbuxhetin e vitit 2009 dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve. E kuptoj se, ndoshta, personeli prej 5 vetave mund të akomodohet brenda buxhetit të Ministrisë, por jo siç e thashë edhe themelimi i Laboratorit të Forenzikës.

Sa i përket furnizimit me legjislacionin e BE-së, në të vërtetë këto ligje në BE rregullohen në mënyrë të veçantë. Nuk janë të rregulluar në mënyrë të veçantë, sepse çdo shtet rregullon legjislacionin e vet të brendshëm në këtë fushë.

Megjithatë, në qoftë se sigurohet buxheti, i cili do të sigurojë edhe zbatimin e ligjit, ne në parim do ta mbështesim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të LDD-së kush e kërkon fjalën? Adem Salihaj apo Naser Rugova? Deputeti Adem Salihaj e ka fjalën.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i LDD-së e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka vlerësuar se krahasuar me projektligjin e mëparshëm, të cilin ia kemi kthyer Ministrisë së Drejtësisë, ky projektligj ka disa përmirësime dhe struktura e tij i plotëson disa kritere që duhet t'i ketë Departamenti i Mjekësisë Ligjore. Megjithatë, edhe në këtë projektligj ka vërejtje të caktuara. Po e zëmë, deklarata për implikimet buxhetore është, por mjetet nuk janë siguruar dhe nuk janë paraparë në kornizën afatmesme buxhetore. Pastaj, siç e tha edhe kryetari i Komisionit, është një dilemë e madhe dhe shumë serioze, a është ky projektligj në harmoni me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, a duhet të vazhdojë

ende ajo faza që ka qenë në kuadër të UNMIK-ut për bashkëkryesim të institucioneve të ndryshme të Kosovës? Këtu parashihet një bashkëkryesues dhe kjo është një dilemë serioze që prek në çështje kushtetuese dhe ne duhet ta sqarojmë këtë para se ky projektligj të aprovohet në leximin e dytë apo në atë të tretin.

Mendoj se janë këto çështje serioze të cilat ne duhet t'i trajtojmë në proces. Ne nuk mund të deklarohejmë sot saktësisht pa i hequr këto dilema që i kemi, veçanërisht në raport me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Megjithatë, nëse në parim aprovohet, ne do ta japim kontributin tonë në komisionin funksional të Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit "7+" , deputetja Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI: Hvala, gospodine predsedniče!

Pozdravljam sve prisutne!

Cilj ovog Nacrta zakona jeste osnivanje odgovarajućeg zakonskog okvira za Odeljenje sudske medicine kao nezavisnog organa odgovornog za pružanje sudsko-medicinskog veštačenja u vezi smrtnih slučajeva, utvrđivanje sudbine i lokacije nestalih lica i ekshumacije ljudskih ostataka u vezi sa konfliktom na Kosovu, kao i vraćanje posmrtnih ostataka porodicama. Nacrt zakona takodje uređuje i organizacionu strukturu koja obuhvata odsek za sudsku medicinu, odsek za izgradnju kapaciteta i obuku i odsek za nestala lica, kao i ovlašćenja svakog od ovih odseka. Zasnovan je na jednoj najboljoj evropskoj praksi u cilju pružanja sudsko-medicinskih usluga i podrške porodicama nestalih lica.

S obzirom da je ovaj nacrt zakona u tesnoj vezi sa Nacrtom zakona o nestalim licima, a koji je u zakonodavnoj strategiji za 2009.godinu, smatramo da bi bilo efikasnije i značajnije da se ova dva nacrta zakona razmatraju istovremeno.

Parlamentarna grupa „7+“ u načelu podržava ovaj nacrt zakona i daće svoj doprinos u toku njegove dalje procedure. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, deputeti Bojan Stojanović, e ka fjalën.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke je razmotrila ovaj predlog nacrta zakona i svakako da ga podržavamo jer se radi o jednoj oblasti koja nije zakonski regulisana. Sve sugestije i primedbe koje mogu da doprinesu poboljšanju kvaliteta zakona mi ćemo kroz svoj rad u skupštinskim komisijama predložiti i nadamo se da će biti usvojene. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar “Zajedno” fjalën e ka kërkuar deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa! Pozdravljam sve prisutne i posebno ovo predsedništvo!

Mi smo nacrt zakona razmotrili, u načelu podržavamo ovaj nacrt zakona. On je jako potreban današnjici Kosova i mislimo da ova dva zakona treba da idu u paketu: Nacrt

zakona o osnivanju Odeljenja sudske medicine i Nacrt zakona o nestalim licima. Mislimo da su ova dva zakona jako potrebna i kada je u pitanju ova budžetska potreba, mislimo da bi bilo potrebno da se uradi u daljem radu rebalans budžeta, gde obavezno moramo da stavimo finansiranje ova dva zakona. Hala puno!

KRYETARI: Faleminderit! Ministre, i dëgjuam shefat e grupeve parlamentare. Ministrja, zonja Nekibe Kelmendi e ka fjalën.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Unë do të përgjigjem vetëm lidhur me koston financiare që u ngrit këtu e që u përmend shuma prej rreth 1 milion e 200 mijë e diçka euro.

Mendoj se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të gjitha mjetet buxhetore që kanë qenë të ndara për institucionet që i bashkëngjiten Departamentit të Mjekësisë Ligjore i kalojnë Ministrisë së Drejtësisë, kështu që sigurohet një shumë e caktuar e mjeteve financiare për implementimin e këtij ligji. Por, ajo që paraqet nevojë imanente për sigurimin e mjeteve financiare është siguri i 1 milion eurove për blerjen e laboratorit për analiza ADN dhe i mjeteve financiare për blerjen e pajisjes për ruajtjen, për databazën e mostrave të gjakut sa u përket personave të pagjetur. Për këtë arsye, ne pas fillimit të grevës “Thirrjet e nënave”, në bisedë me Qeverinë, Qeveria është zotuar se do t’i sigurojë këto mjete dhe do të blihet ky laborator, kështu që funksioni kryesor i këtij departamenti do të sigurohet tani. Nëse kjo nuk do të ndodhë menjëherë me hyrjen në fuqi, me supozim se ky ligj do të hyjë në fuqi para rishikimit të buxhetit, atëherë me rastin e rishikimit të buxhetit do të kërkohej mjetet për blerjen e këtyre pajisjeve, siç është laboratori dhe pajisja për databazën e mostrave të gjakut. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministre! Për replikë është paraqitur Gani Koci, një minutë.

GANI KOCI: Zonja ministre, nga dy ata mekanizmat që u përmendën se do të fuzionohen, buxheti i tyre për vitin 2009 është 772 mijë euro. Dhe, jo ky 772 mijë euro, po mbi këtë 772 mijë euro është ajo pjesa tjetër prej 1 milion e 177 mijë euro si kosto shtesë ku përfshihet edhe aparatura ose Laboratori i ADN-së. Prandaj, nuk mbulohet, absolutisht me buxhetet e këtyre dy mekanizmave që sot funksionojnë, nuk mbulohet kostoja e implementimit të këtij ligji pa këtë pjesën shtesë. Pjesa shtesë, edhe unë mendoj se me rishikim të buxhetit do të duhej që ajo të gjendet, sepse është shumë e nevojshme, por që tash nuk mjaftojnë vetëm ato se premtojmë ose Qeveria duhet ta bëjë këtë, sepse këtë fakt nuk e keni të përfshirë as në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Prandaj, do të duhej ndryshimet të bëhen edhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve edhe të mbulohet kjo pjesë që është e nevojshme për implementimin e këtij ligji.

KRYETARI: Konsideroj se ministrja e ka dhënë sqarimin e vet, do të thotë, me rishikim. Vazhdojmë me diskutimet e deputetëve. Fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj, le të përgatitet deputeti Naser Rugova.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ligji për Institutin e Mjekësisë Ligjore si i tillë është i domosdoshëm kur dihet fakti se fuzionon në vetvete Institutin e Mjekësisë Ligjore, që deri tash ka qenë në kuadrin e

Ministrisë së Shëndetësisë, dhe Zyrën për Personat e Zhdukur, që ka funksionuar në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Ky Institut, pavarësisht se do t'i takojë Ministrisë së Drejtësisë, është Institut multidisiplinar, sepse në vete përmbledh si shëndetësinë, arsimin, ashtu edhe drejtësinë. Ligji e ka rëndësinë e vet, sepse do t'i hapë rrugë edhe ligjit të autopsisë, të cilin ne ende nuk e kemi.

Në parim e përkrah këtë projektligji, por kam disa vërejtje të cilat besoj se komisioni do t'i marrë parasysh gjatë punës së mëtutjeshme.

E para, te neni 6, më falni, pika 2.2. do të duhej të riformulohej, sepse në formën ashtu siç është, është e paqartë. Forma definitive do të duhej të ishte: “mësimdhënien për studentët në Fakultetin e Mjekësisë dhe mjekët në studimet pasuniversitare në lëndën e Anatomisë dhe Mjekësisë Ligjore”.

Po ashtu, tek neni 8, pika 2.1. kam një vërejtje kur përmendet se – ekspertët e EULEX-it do të kryejnë çdo lloj të ekzaminimit mjeko-ligjor, duke përfshirë autopsitë në ekipe të përziera me ekspertë mjeko-ligjor vendorë dhe pastaj kur është e mundshme. Propozoj që fjala pas presjes “kur është e mundshme” të largohet, sepse besoj qëllimi i bashkëpunimit të ekspertëve nga EULEX-i është që të ndihmojë në ngritjen e kapaciteteve vendore. Domethënë, të kemi mjekë ligjorë sa më të kualifikuar dhe në momentin kur ne nuk do ta kemi EULEX-in, të ketë ekspertë të cilët do të jenë të aftë ta kryejnë punën ashtu siç duhet.

Ligji e ka edhe një të mirë, atë që e përmendi ministrja, krijimin e Laboratorit të ADN-së, të cilin ne nuk e kemi pasur deri sot dhe që për secilën analizë të bërë është dashur mostrat tona të dërgohen jashtë vendit dhe një gjë e tillë i ka kushtuar buxhetit të Kosovës nga 2.000, 3.000 e deri në 5.000 euro, prandaj krijimi i laboratorit të tillë do të ishte mjaft i favorshëm për Kosovën. Në parim, e përkrah ligjin dhe shpresoj se vërejtjet e tilla do të merren parasysh nga Komisioni gjegjës. Faleminderit!

KRYETARI: Vërejtjet mund të bëhen edhe në formë të amendamenteve. Fjalën e ka deputeti Naser Rugova, le të përgatitet deputeti Shkumbin Demaliaj.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zonja ministre, si e vetmja përfaqësuese nga Kabineti qeveritar!

A këtu qenka edhe ministri i Forcës dhe Sigurisë! Mirë atëherë!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë konsideroj se po bisedojmë për një ligj shumë të rëndësishëm, i cili rregullon marrëdhënie shumë të rëndësishme ndër-institucionale dhe shumë të rëndësishme për organe shtetërore publike që ka të bëjë me ekspertizën mjeko-ligjore, me hetimet mjekësore mbi vdekjen, si dhe me trajtimet e autoriteteve publike të Republikës së Kosovës.

Është një ligj që përfshin shumë disiplina mjaft senzitive për funksionimin e institucioneve shtetërore dhe jo rastësisht edhe legjislacioni i Bashkimit Evropian dhe *acquis communautaire* në njëfarë forme i kalon hapësira legjislacioneve nacionale, që konform specifikave të vendeve ta rregullojnë këtë pjesë specifike të legjislacionit.

Ky ligj i është rikthyer edhe një herë për ta rishqyrtuar sponzoruesit, me të drejtë. Tani është një ligj me një përbërje tjetër, me një materie më konkrete, por gjithsesi nuk është shqyrtuar si duhet. Kemi probleme serioze edhe në terminologjinë shkencore dhe definicionet adekuate. Te disa nocione në ligj duhet të japin definicione konkrete, sepse ka edhe mospërputhje sa i takon gjuhëve, kemi kuptime të ndryshme në gjuhën angleze dhe serbokroate. Ju lutem, dëgjoni me vëmendje te një definicion i rëndësishëm – toksikologjia. Kush kupton shqip le ta vlerësojë. Toksikologjia nënkupton studimet përkundër efektet e përbërjeve kimike në organizmat e gjallë. Ky është ligj i shtetit, ky është ligj që rregullon raporte ndërinstitutionale dhe sanksionon dispozita shumë senzitive për funksionimin normal të një shteti, të një qeverie, të institucioneve. Dhe, nuk e di, sponzoruesit e këtij ligji a e kanë ditë se çka iu kanë sjellë deputetëve të institucionit më të lartë legjislativ të vendit? Kjo është joserioze. Se këtu kemi mjaft gjuhëtar që nganjëherë merren me këto terminologji dhe nocione dhe na mbajnë shumë ligjërata. Tani kur është çështja e një nocioni për një ligj specifik, duhet të dalin këtu dhe të japin kontributet e tyre dhe interpretimet ashtu si duhet. Pastaj, paqartësitë të rrezikut financiar, që ka të bëjë me ngritjen e një pjese të kapaciteteve të Departamentit të Mjekësisë Ligjore nga ekspertët e EULEX-it. Ende ky ligj nuk ka definuar qartë se kush i ka kompetencat dhe kush do të procedojë me ekspertizat, edhe një herë po them, senzitive. Këto paqartësi paraqesin pengesa serioze në funksionimin normal të Departamentit të Mjekësisë Ligjore dhe zbatimin në praktikë të këtij ligji. Në ligj gjërat duhet të precizohen qartë, sepse po krijohen vakuume ligjore dhe pastaj po kritikohemi edhe nga institucionet relevante të Bashkimit Evropian dhe ato të tjera ndërkombëtare për moszbatueshmërinë e ligjit në Kosovë.

Kur është fjala, zonja ministre, te Laboratori për mostrat e ADN-së, që të gjithë e dimë se sa i takon identifikimit të mbetjeve mortore edhe me mijëra njerëz që nuk është zbardhur fati i tyre, mostrat e gjakut për përcaktimin e ADN-së bëhen në laborator në Tuzell e në Sarajevë. Ju lutem, duke ditur këtë çështje shumë të ndjeshme për gati 2 mijë familje që ende presin që të zbardhet fati i më të dashurve të tyre, duhet Qeveria të marrë një vendim konkret, sepse është nevojë imediate shtetërore dhe obligim kushtetues që ky laborator dhe tek e fundit një departament i mjekësisë ligjore i një shteti nuk mund të ekzistojë pa e pasur laboratorin e përcaktimit të mostrave të ADN-së, sepse në këtë institucion, në këtë departament të mjekësisë ligjore do të kryejnë trajnime edhe ekspertë vendorë, por edhe studentët e Fakultetit të Mjekësisë dhe fakultetet e tjera tani që lidhen me kriminalistikën, e tjera. Po, është një laborator që do ta zhvillonte shumë edhe balistikën që ka të bëjë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, e tjera.

Unë besoj se është një materie në këtë projektligj dukshëm më e mirë se ajo që na ka ardhur më herët, por insistoј që komisioni funksional dhe hartuesit e këtij projektligji t'i kenë parasysh këto vërejtje serioze, sepse e pamundëson zbatimin e tij në praktikë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Shkumbin Demaliaj, le të përgatitet deputeti i fundit për diskutim Riza Smaka.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Kolegë deputetë,

Lidhur me Projektligjin në fjalë, për të mos i përsëritur të gjitha ato që i thanë kolegët deputetë më herët, objektivisht shihet se ka dyfishim ose edhe trefishim të përgjegjësi

në këtë rast, meqenëse mekanizmat tonë institucional sot ekzistojnë dhe punojnë në këtë drejtim. Nuk di, gjatë projektligjit thuhet se do të barten këta mekanizma institucional brenda këtij departamenti, mirëpo duke ditur se shteti ynë nuk ka bërë kurrëgjë në ngritjen e politikave kadrovike, besoj se ato kuadro që i kemi si ekspertë të mjekësisë ligjore, dy ose tre në Kosovë, them ekspertë kushtimisht, njëri do të bëhet drejtor, dy shefa të sektorëve dhe askush nuk do ta kryejë punën e vet më tutje. U përmend Laboratori i Forenzikës që është në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, po edhe laboratorë tjerë dhe ata që mendohet të blihen me këto mjete buxhetore, po edhe në projektligj po shihet se duhet të futet edhe një komision për persona të zhdukur. Duhet të na vij keq, e dimë se është tepër emocionuese, por në qoftë se Kosova nuk e ka të rregulluar një ligj për çështjen e të zhdukurve, edhe me konventa ndërkombëtare është e rregulluar kohëzgjatja se sa do të mund të jetë një person i shpallur i zhdukur dhe duhet të jetë një kohëzgjatje kur humb ai efekt. Është shumë emocionale për familjarët që nuk i kanë gjetur ende të dashurit e tyre, mirëpo ne po shkojmë drejt një kaosi ligjor, gjithnjë në rrëshqitje. Edhe kjo kushtimisht rëndon më shumë edhe më shumë përgjegjësinë e institucioneve të Kosovës se pas dhjetë vjetësh duhet të organizohet një ligj që do të rregullojë një departament që do të bëjë diçka për zgjidhjen e fatit të tyre. Këtu u fol shumë për buxhetin brenda kësaj kornize afatmesme 2009-2011. Pra, nuk parashihet asnjë cent në kuadër të buxhetit të Republikës së Kosovës për këtë departament, e tha edhe kryetari i Komisionit për Buxhet. Mund të flitet për bartje buxhetore në këtë rast, por përfundimisht ne nuk kemi asnjë memorandum mirëkuptimi si Kuvend, por as si komisione deri më tash nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë për një çështje të bashkëpunimit a të mirëkuptimit lidhur me këtë çështje se a do të barten këta resorë? Sepse të largohet një institucion apo një institut nga QKUK brenda oborrit të shëndetësisë dhe të dalë diku në rrugë apo në një objekt me qira, nuk e shoh si diçka që mund të jetë një dritë apo një reflektim i mirë që mund t'i çojë këto institucione përpara. Faleminderit shumë, Kryetar! Sido që të jetë, besoj se unë do ta votoj në parim këtë projektligj, mirëpo e shoh se komisionet do të kenë punë shumë në të ardhmen, që të nxjerrin në dritë, se më mirë do të ishte të hartohet një akt nënligjor lidhur me këtë çështje se sa të themelohet një departament që vetëm do të krijojë shpenzime buxhetore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë deputet!
Fjalën e ka deputeti i fundit për diskutim, Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri Kryetar,
Ministra,
Deputetë të nderuar,

Disa vërejtje parimore me qëllim që të japim një kontribut sado të vogël, si për komisionin funksional, ashtu rrjedhimisht edhe për Kuvendin, kur të miratohet ky që të aplikohet pa probleme të mëdha. Dikush e lavdëroi tepër, unë mendoj se nuk duhet ta lavdërojmë as tepër, as ta kritikojmë me qëllimin tendencioz, përkundrazi, të japim vërejtje kritike. Konkretisht, ju lutem, ka shumë defekte në gjuhë. Ka diferenca të mëdha ndërmjet tri teksteve në tri gjuhë. Bie fjala, në serbisht, boshnjakisht thuhet “delokrug”, aty që është rreth-veprimi i ligjit, a është fjala në shqip “qëllimi i ligjit”, në anglisht është purpose, që do të thotë nuk përputhen, materialisht, nuk është fjala për cikërrime, por për tema krejtësisht në shpërputhje.

Më pastaj, ka dispozita kalimtare, nuk ka dispozita përfundimtare, nuk ka dispozita ndëshkimore. Nuk mund të ketë kurrfarë efekti juridik akti ligjor që nuk ka dispozita

ndëshkimore. Ai mbetet në nivelin e deklaratave vulontariste, kështu e kështu, por nëse nuk aplikohet, çka? Kurrëgjë.

Edhe ne e kemi, po e zëmë, ju lutem, e kemi Institutin e Mjekësisë Ligjore në kuadrin e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Nuk kemi ne kapacitete që t'i dublifikojmë. Nuk ka këtu në dispozita që e përcakton diçka në atë drejtim që të harmonizohen e të shfrytëzohen, po e zëmë, kapacitetet e njëjta në funksionin e përbashkët. Mendoj që do të duhej të bëhet një rishikim në atë drejtim. Dhe, po e zëmë, ky ligj kam përshtypjen kur është hartuar në nivelin e projektit, nuk është lexuar fare nga hartuesit. Bie fjala, thirret në Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale. Ne e kemi Kodin e Procedurës Penale. Domethënë, nga kjo shihet se nuk është lexuar fare, a shkresa më e thjeshtë nga autori së paku një herë do të duhej të lexohej.

Edhe si shembull eklatant se si nuk mund të jetë dispozita ligjore, është neni 10. Ja çka thotë – aktet nënligjore për zbatimin e plotë të këtij ligji, domethënë po bëka edhe të paplotë, mund të nxirren nga Ministria e Drejtësisë fakultativisht. Po, jo mund, por Ministria e Drejtësisë duhet të miratojë një varg aktesh nënligjore. Domethënë, këto janë vërejtje parimore që sponsori le t'i marrë vetë dhe të japë propozim amendamente dhe le ta bëjë punën ashtu si duhet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë, deputet!

Mendoj se nuk kemi të lajmëruar për diskutim, edhe një ministër na erdhi. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Konstatohet se Kuvendi më 56 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, miratoi në parim Projektligjin për themelimin e Departamentit për Mjekësinë Ligjore.

Në bazë të Rregullores së Punës të Kuvendit, ngarkohen këto komisione:

- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional;
- Komisioni për Buxhet e Financa;
- Komisioni për Komunitete dhe
- Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Gjatë këtij votimi, në sallë janë 63 deputetë. Ne do të bëjmë pauzë deri në orën 15,00.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI NAIM MALOKU: Të nderuar deputetë, ju lus që t'i zini vendet e punës. Vazhdojmë me punimet e seancës.

Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës

Konstatimet hyrëse.

Në bazë të rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Kao što ste verovatno i videli iz samog zakona, do sad je bio primećen nedostatak ovog zakona, jer znate i sami da je bilo i sad još uvek imamo odredjeni broj, po meni jedan značajan broj stranaca koji rade na Kosovu. Prema tome, regulisanje ovog zakona bi u znatnoj meri unapredilo tu regulativu i znala bi se po kojim osnovama, po kojim zakonima i kako mogu da rade u našem društvu.

Inače, ovaj zakon je podrška akta 49. koji je u Ustavu kao i amandmana 41. Zakona za strance u Ministarstvu unutrašnjih poslova.

Zakon je sam bio predviđen da bude usvojen krajem 2008. godine, ali je malo taj Zakon, recimo mesec ili dva, bio odložen, odnosno imali smo neke konstruktive komentare, pa smo ga malo i doradili tako da njegova osnovna namena je podrška zakonima koji bi trebalo da čine jednu neophodnu celinu.

Broj zaposljenih stranih državljana nije mali i oni sada funkcionišu bez jasno utvrđenih pravila i obaveze. Ta pravila i obaveza koje su trebale da budu regulisane prema našem društvu, nisu bila pristupačna, odnosno nisu bila na snazi, a ovaj bi zakon ujedno trebalo sve regulisati. Ovaj zakon inače sadrži 27 amandmana, koji sadrže 8 načela i uslove za zapošljavanje stranih državljana i utvrđuje posebne uslove za zapošljavanje, utvrđuje načela za odobravanje radnih dozvola, kao i sva ostala bitna pravila.

Poštovane dame i gospodo, narodni poslanici,

Mislim da zakon sam po sebi je vrlo jasan i lak samim tim što nema nikakve budžetske implikacije, bilo bi vrlo značajno da bude usvojen, jer time bi možda postavili još jedan od onih osnovnih temelja našeg društva, tako da koristim priliku da vas u ime Ministarstva pozovem da glasate zakon jer još jednom ponavljam. jedan je od zakona koji će utvrditi načela osnove našeg društva. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Nga kryetarët e komisioneve parlamentare nuk ka të lajmëruar. Në emër të Komisionit funksional, pra për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, fjalën e ka deputeti Sadik Idriz!

SADIK IDRIZ: Hvala, predsjedavajući,

Poštovani ministri,

Kolege poslanici,

Komisija za zdravstvo, rad i socijalno staranje je prije nego što je ovaj zakon došao ovde u Parlament, na dva sastanka Komisija je razmatrala i ostala je opet sa jednom dilemom koju će danas verovatno i članovi Komisije da iznesu. Potreban je ovaj zakon, zato što je jedna oblast dosta značajna, neregulisana, a to je zapošljavanje stranaca i

ovaj Zakon ima znači osnovu u Ustavu Kosova, ima osnovu u Zakonu o strancima, znači ima sve te potrebne premise. Takodje je uskladjen sa Evropskom regulativom zato što Evropska zajednica nema neki pravni akt koji je obavezan u vezi zapošljavanja stranih državljana na teritoriji Evropske zajednice zato što svi imaju potpuno jednaka prava u tim zemljama i onda postoje i traktati koje takodje preporučuju da u pogledu zapošljavanja nema diskriminacije.

Takodje je značajno da ovaj zakon nema budžetских implikacija, nego će imati više benefita nego troškova. Jedina dilema je ta, što u ovom trenutku mi na Kosovu nemamo Osnovni zakon o radu, još nije usvojen Osnovni zakon o radu, bazični zakon koji je najavljen u strategiji Vlade za ovu godinu, ali ga još nismo dobili. Mi smo razgovarali i sa Pravnom kancelarijom Ministarstva za rad. Oni su imali jednu preporuku koja opet nije ubedljiva da implementacija ovog zakona bude nakon usvajanja Zakona o radu, znači u ovom trenutku bi to bio samo jedan posao.

Kao Komisija, nismo doneli poseban zaključak da li da se ovaj zakon vrati ili ne, nego smo ostavili da svaka parlamentarna grupa odluči o tome i da je to pravo svake grupe da predloži. Ipak, mislim, znači u svoje ime i u ime Parlamentarne grupe „7+“, da bi trebalo ovaj zakon da prodje, znači u načelu da bude usvojen i da kasnije naša komisija i druge komisije daju svoje mišljenje o ovome. Ali, ipak, u ime Komisije ostaje svakoj parlamentarnoj grupi da da svoje mišljenje o ovom Zakonu. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nga komisionet tjera parlamentare, kam emrin e deputetit Bahri Hyseni. Mos në emër të Komisionit? Jo! Ju faleminderit!

Në emër të grupeve parlamentare, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj. E keni fjalën!

MIMOZA AHMETAJ: Ju Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka analizuar në detaje Ligjin, Projektligjin për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës dhe e ka parë si të domosdoshme që edhe ky ligj ta plotësojë legjislaturën ekzistuese të Kosovës.

Ajo që e bën të domosdoshëm ligjin, përveç të them së pari se ky ligj është, ky del, është bazuar në nenin 49 të Kushtetutës dhe nenin 41 të Ligjit për të huajt nga Ministria e Punëve të Brendshme. Ligji është i domosdoshëm me qëllim të eliminimit të dukurive të kundërligjshme në çështjet e punësimit në Kosovë. Në Kosovë nuk dihet saktë numri i të huajve që jetojnë dhe punojnë. Ka biznese të ndryshme, duke filluar nga punëtoritë, kompanitë e ndërtimit që kanë punëtorë të huaj, fabrikat, duke vazhduar me mjekë, profesorë e deri te dyqanet e zejtaritë e tjera, të cilat në mungesë të ligjit, deri tani nuk kanë kryer obligimet e tyre ndaj shtetit të Kosovës.

Kohë më parë, ajo që e bën, do më thënë, të domosdoshme ekzistencën e këtij ligji, është edhe argumenti që kohë më parë është nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë të Punës, që të gjithë të huajt që dëshirojnë të aplikojnë për leje qëndrimi në Kosovë, duhet patjetër të kenë leje pune, përndryshe atyre nuk do t'u jepet leje qëndrimi në Kosovë.

Kosova ka përafërsisht 250 deri në 300 biznese të vogla të regjistruara në Ministrinë e Tregtisë që nga paslufta dhe vetëm në vitin e kaluar janë regjistruar 78 prej tyre. Për regjistrim, këto biznese paguajnë nga 20 euro në Ministri të Tregtisë dhe të Industrisë, ndërsa për lejen e punës që e marrinë komunë paguajnë 100 deri 200 euro, varësisht nga lloji i biznesit që e ushtrojnë. Llogaritet se diku 30% nga numri i përgjithshëm i këtyre bizneseve kanë leje pune, ndërsa të tjerat punojnë në të zezë. Situatën e bën edhe më të rënduar fakti se shumë të huaj që vijnë dhe punojnë, vijnë dhe punojnë në bizneset e vendorëve dhe për ta nuk ka evidencë të saktë.

Ligji nuk iu bën konkurrencë punëtorëve të Kosovës, sepse në nenin 16, pika 1.5, të dokumentacioni i nevojshëm për aplikim përmendet që, përveç të tjerave, aplikuesi duhet të posedojë edhe vërtetimin nga zyra e punësimit përmes së cilës vërtetohet se në mesin e punëkërkuesve kosovarë nuk ka të atillë të cilët i plotësojnë kushtet e punësimit ku do të punojë shtetasi i huaj.

Ligji jo që nuk ka implikime buxhetore, por ai edhe do të mund ta ndihmonte buxhetin e Kosovës, kur merret parasysh taksa e regjistrimit, e cila paguhet për regjistrim të biznesit, si dhe pagesa për marrjen e lejes së punës, pastaj gjobat me të cilat do të gjobiten si punëdhënësi, ashtu edhe punëmarrësi në qoftë se gjenden që punojnë pa leje të punës. Do të ishte shumë me e pranueshme sikur ligjit t'i paraprinte Ligji bazë i punës, të cilin besoj shumë shpejt do ta kemi në Kuvend.

Ajo që do të duhej të ndryshohej në ligj, është edhe emërtimi i ligjit, sepse ligji si i tillë ka më tepër të bëjë me dhënien e lejes së punës për të huajt, se sa me punësimin e tyre. Ligji do të duhej të plotësohej, po ashtu, edhe me akte nënligjore, ashtu siç parashihet në afatin gjashtëmujor, në mënyrë që të zbatohet sa më drejtë dhe në mënyrë sa më efikase.

Edhe një argument tjetër është se ne si parti, e thashë edhe në fillim që e përkrahim këtë ligj, duke dhënë kontributin tonë në komisionet gjegjëse si dhe gjatë punës në komision do të përfillen rekomandimet të cilat dalin nga Zyra për harmonizim dhe standardizim ligjor. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, për momentin nuk kam të lajmëruar për fjalë. Nurishahe Hulaj e ka fjalën! Bujar Bukoshi e ka fjalën, më falni.

BUJAR BUKOSHI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah, e mbështet në parim këtë Projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka deputeti dhe shefi i Grupit Parlamentar, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra, kolegë,

Grupi Parlamentar i AKR-së nuk e mbështet këtë projektligj për arsye të vetme, sepse ne edhe më tutje nuk kemi Ligj të punës në Kosovë dhe po pretendojmë që t'i zgjidhim problemet të cilat ju takojnë një kategorie krejt tjetër. Ne do ta mbështesim një ligj të

tillë edhe pse jemi shumë të vetëdijshëm që ka nevojë në Kosovë për një ligj të tillë, sepse sikur u tha edhe këtu, ka me dhjetëra punëtorë të jashtëm, ose shtetas të jashtëm, të cilët punojnë në Kosovë përkundër faktit se mungon një ligj, por një draftligj të tillë do ta mbështesim pasi që këtij Kuvendi t'i silltet Ligji për punë, në të cilën do të rregullohen marrëdhëniet e punës edhe elementet e tjera që kanë të bëjnë me punësimin në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Gjylnaze Syla e ka fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër i Punës dhe i Shëndetësisë, më duket se është edhe ministri i Tregtisë, Të nderuar deputetë,

Deri me sot çështja e punësimit të shtetasve të huaj nuk është rregulluar në Kosovë, andaj krijimi i një kornizës ligjore e cila do të rregullonte këtë çështje, do të ishte e mirëseardhur, por që korniza ligjore të jetë e tillë që të rregullojë këtë fushë.

Atë çka synon ky projektligj është mënyra, kushtet dhe procedurat e punësimit të shtetasve të huaj, ndërsa në qendër të këtij ligji është dhënia e lejes dhe kufizimi i dhënies së lejes nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Gjithashtu, në projektligj thuhet se arsyeja e hartimit të tij është krijimi i infrastrukturës ligjore, në pajtim me legjislacionin e BE-së dhe konventat ndërkombëtare. Do të thotë, qëllimi mund të jetë i mirë, por nuk realizohet dhe nuk e arrin qëllimin e vet ky ligj për shkak të argumenteve të cilat do t'i tregoj më poshtë.

E para, nuk e arrin ky Ligj qëllimin e vet sepse nuk vë kontrollin e punësimit të huajve, por të vendorëve. Këtë e dëshmon neni 13, pika 1.3, ku OJQ-të mund të punësojnë të huajtë pa kufizime.

E dyta, nuk stimulohet punësimi vendor, sepse ndërmarrjet e huaja mund të punësojnë jo vetëm stafin menaxherial, por mund të sjellin gjithë personelin në Kosovë. Ashtu qëndron në nenin 13, pika 1.5.

E treta, ligji nuk mund të zbatohet, sepse dispozitat e këtij ligji i referohen Ligjit për punë në Kosovë, neni 17 dhe 18, i cili është ligj bazë për punën, por që Kosova nuk e ka këtë ligj.

E katërta, nuk definojnë aktet nënligjore që duhet të nxirren për marrëdhënien e punës të shtetasve të huaj, neni 24.

E pesta, është e paqartë se cili ligj apo akt nënligjor shfuqizohet me këtë projektligj, neni 27.

E gjashta, sa i përket pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së, legjislacioni i BE-së nuk e rregullon çështjen e shtetasve të huaj dhe punësimin e tyre për arsye se shtetasit të cilët janë anëtarë të vendeve të BE-së mund të punësohen në cilindo shtet të BE-së. Pra, BE-ja nuk ka akt juridik të obligueshëm në lidhje me punësimin e shtetasve të huaj në territorin e BE-së. Prandaj, kërkojmë nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale që ta bëjë të mundshëm zbatimin e këtij ligji dhe rregullimin e kësaj sfere ashtu që të definohet së pari, të silltet në të vërtetë Ligji bazë i punës në Kuvend, në të cilin thirret

edhe ky ligj, siç është marrëdhënia e punës. Po ashtu, duhet të definohet se punëtorët e huaj që vijnë në Kosovë, do të punojnë përkohësisht. Me fjalë të tjera, në qoftë se, për shembull, duhet të ndërtohet një autostradë, atëherë duhet të definohet se vetëm punëtorët që mungojnë në tregun e punës në Kosovë mund të punësohen, por jo ata që tregu i Kosovës i ka. Që kjo zgjidhje të sigurohet, atëherë, duhet që ky ligj të përmbajë dispozitën ligjore që përcakton se këta punëtorë të huaj, do të kenë kontratat e punës në vendin e tyre. Në këtë mënyrë do të krijohen vendet e punës për punësimin e punëtorëve nga Kosova.

Kështu si është hartuar ligji, nuk është efikas dhe, siç thashë, nuk e arrin qëllimin e vet, prandaj ne nuk mund ta mbështesim në parim. Por, në qoftë se Ministria e sjell Ligjin e punës, ligjin bazë me vërejtje të cilat i përmenda më lartë, kur t'i sjellë këto, do ta votojmë në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetja Qamile Morina e ka fjalën.

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ministra të nderuar,

Deputetë të nderuar,

Lidhja Demokratike e Dardanisë, Projektligjin për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës e ka shqyrtuar me vëmendje. Ne konsiderojmë se Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Projektligjin për punësimin e shtetasve të huaj e ka nxituar ta procedojë në Kuvend para Ligjit bazë të punës, i cili është paraparë në strategjinë legjislative të këtij viti.

Qeveria do të duhej që në krijimin e infrastrukturës ligjore të ndjekë parimin e prioritetëve. Prioriteti do të përcaktohej gjithashtu duke pasur parasysh numrin e punëtorëve tanë krahasuar me numrin e punëtorëve të huaj.

Synimi ynë nuk është që të minimizojmë rëndësinë e çfarëdo ligji, ngase çdo ligj është i rëndësishëm nëse është ekziston mungesa e tij. Kemi parasysh që hartimi i këtij projektligji mbështetet në nenin 49 të Kushtetutës së Kosovës dhe në nenin 41 të Ligjit për të huajt. Por, gjithashtu e kemi të qartë që projektligji në fjalë nuk do të ishte i plotë dhe nuk do të kishte fuqinë ligjore pa Ligjin bazë të punës.

Në këtë mënyrë, projektligji nuk do ta arrijë qëllimin e vet e që është të zvogëlojë ekonominë joformale dhe të vendos kontroll në këtë sektor. Vërejtjet tona konkrete për çështjet që mendojmë që e pengojnë fuqinë ligjore të këtij ligji janë: qëndrimi i përfaqësuesve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ka qenë që projektligji në fjalë do të jetë i zbatueshëm pas hyrjes në fuqi të Ligjit të punës.

Shtrohet pyetja, nëse ky Ligj nuk ka fuqi juridike derisa të aprovohet Ligji i punës, atëherë pse ta kemi në agjendë tani. Pastaj, kapitulli i katërt i projektligjit përmban dispozitat për themelimin e marrëdhënies së punës, si kontrata e punës, formën e lidhjes së kontratës, që gjithashtu duhet të bëhet në pajtueshmëri me Ligjin e punës.

Në arsyeshmërinë e hartimi të Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj, thuhet se është në pajtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ky fakt është i paqëndrueshëm, ngase legjislacioni i Bashkësisë Evropiane rregullon punësimin e shtetasve brenda

shteteve të Bashkimit Evropian, kurse Bashkësia Evropiane nuk ka ndonjë akt juridik të obligueshëm për punësimin e shtetasve të huaj në territorin e Bashkësisë Evropiane. Dhe, ajo që është substanciale, është që Projektligji duhet taksativisht të caktojë kriteret për nevojat e tregut të punës për punëmarrësit dhe për vetë të punësuarit, që i mungon këtij Projektligji, në mënyrë që të mbrojmë shtetasit tonë dhe të krijojmë përparësi të lartë pune për ata në tregun vendor.

Në fund, Lidhja Demokratike e Dardanisë konsideron se Projektligji për punësimin e të huajve nuk është prioritet, nuk ka fuqi ligjore pa Ligjin bazë të punës. Me qenë se në këtë mënyrë nuk e arrin qëllimin, si i tillë nuk duhet të kalojë në Kuvend. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Për Grupin Parlamentar “7+” ishte deputeti Sadik Idriz.

Për Grupin Parlamentar SLS, deputeti Bojan Stojanović e ka fjalën.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Želim da kažem da je Parlamentarna grupa SLS razmotrila predlog verzije Zakona za zapošljavanje stranih državljana i svakako, kad god se radi o nekoj oblasti koja nije regulisana, mi smatramo da treba doneti zakone. Stoji činjenica i kao opravdana sugestija o tome šta će ovaj zakon ukoliko nema Zakona o radu. Međutim, mislim da je taj Zakon o radu malo složeniji i treba da se više pažnje posveti njemu, tako da treba dati Ministarstvu vremena. Ali, neće ići na štetu s obzirom da nema budžetske implikacije da se ovaj zakon usvoji u prvom čitanju, tako da komisije imaju malo više vremena da odrade sve ove stvari koje ovde stoje kao pozitivne sugestije, kako bi zakon bio što bolji. Mi ćemo podržati ulazak ovakvog zakona u skupštinsku proceduru. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Për Grupin Parlamentar “Zajedno”, nuk ka të paraqitur për fjalë. Kalojmë në... Po, më falni, është Vezira Emrush për Grupin Parlamentar “Zajedno”.

Verzira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa, gospodine predsjedavajući! Ponovo pozdravljam sve kolege!

Danas pred sobom imamo Zakon o zapošljavanju stranih državljana. Ja sam istomišljenica sa pojedinim grupama ovde da pre ovog zakona, mora da Skupština donese Zakon o radu i jako potreban Zakon o penzijskom i invalidskom osiguranju, gde se definišu prava svojstva iz rada i radnog odnos i post radnog odnosa. Bez ova dva zakona, mislim da nema veliku logiku usvajanje Zakona o zapošljavanju stranih državljana. Znamo da se sa ovim zakonom definišu strani državljani koji imaju pravo na rad ili razvoj biznisa na Kosovu. Ali mi nismo pre toga definisali svoje građane na Kosovu, te mislim da su bazična ova dva zakona, imaju prioritet i oni su onsova za ovaj zakon, kao što je ovo u paketu isto sa ovim zakonom i Zakonom o strancima.

Mišljenja smo da treba da se zakon, ne kažem da se ne usvoji, ali da se dobro analiza i da apelujemo ovde u Skupštini da Vlada što brže uradi Zakon o radu i Zakon o penzijskom i invalidskom osiguranju. Hvala lepa!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, le të përgatitet deputeti Shkumbin Demaliaj.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues,

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për të punësuarit apo shtetas të huaj, konsideroj që është i domosdoshëm dhe nuk duhet të bëjmë një krahasim me Ligjin që është gjithashtu i domosdoshëm për punën dhe arsyet duhet të jenë të qarta.

Të gjithë e kuptojmë që e kemi një vonesë për Ligjin për punën, është i domosdoshëm, është interes i institucioneve të Kosovës ta kemi sa më parë këtë ligj, por megjithatë ky Ligj për punën ka implikime buxhetore dhe aktualisht ekzistojnë disa rregullore që së paku në, jo në pjesë të përgjithshme, por në disa pjesë parciale rregullojnë çështjen e punës, kurse sa i përket çështjes së shtetasve të huaj të cilët po punojnë në Kosovë, nuk kemi asnjë rregull, së paku edhe në çështjet parciale ta rregullojë. Edhe sponzorizuesi, mendoj, nuk e ka pasur shumë qëllimin e punësimit të shtetasve të huaj në Kosovë, duke marrë parasysh që Kosova nuk ka shumë kapacitet për të punësuar njerëz, sepse i ka diku 50% vetë popullatën e vet të papunësuar, por ka pasur për qëllim të rregullojë një pjesë apo një kategori e njerëzve të cilët po punojnë në Kosovë, nuk kanë fare leje të punës, nuk kanë licenca, nuk i paguajnë askujt as taksë, as tatim, prandaj me qëllim të rregullimit të kësaj kategorie, të cilët i sjellin edhe të hyra buxhetore Buxhetit të Kosovës, me qëllim që të mos lejohet në Kosovë të krijohet anarki, siç është tash rasti, vijnë mjekët bëjnë operacione të ndryshe dhe askujt nuk i japin përgjegjësi, as nuk kanë leje pune, as licencë. Me qëllim të rregullimit të kësaj dukurie dhe me qëllim që së paku të jetë një infrastrukturë ligjore e cila i detyron njerëzit të cilët kërkojnë punë apo kryejnë aktivitete të punës në Kosovë, ta marrin një leje pune, t'i zbatojnë procedurat dhe rregullat të cilat i kornizojnë, në këtë qëllim konsideroj se duhet të aprovet ky ligj dhe është i domosdoshëm, sepse aktualisht mendoj që nuk janë dhjetëra, por janë qindra punëtorë të cilët punojnë dhe nuk dihet fare se çka bëjnë dhe kujt paguajnë, ku i kanë licencat, ku i kanë lejet e punës, e lëre më, të mos flasim që Buxheti i Kosovës nuk fiton nga këta njerëz asgjë.

Unë kisha për ta ngritur një shqetësim që komisioni funksional duhet ta ketë parasysh me rastin e amendamentimit. Gjjobat të cilat janë paraparë në këtë ligj, janë shumë të ulëta dhe mendoj se duhet të ndryshohen. Gjjobat janë 200 euro, nëse një shtetas i huaj nuk i përmbahet rregullave dhe ligjit, nëse nuk i përmbahet mandatit që ka fituar me leje të punës, prandaj konsideroj se këto gjoba duhet të jenë të larta, sepse çdo shtetas i huaj i cili do të kryente edhe punë ilegale dhe nuk do t'i përmbahej këtyre rregullave të përcaktuara me Ligj, do të ishte në gjendje me paguar këtë gjobë 200 euro. Gjjobat duhet të jenë shumë të larta, duke marrë parasysh që në Kosovë kryhen edhe aktivitete të cilat kushtojnë. Po flas edhe për aspektet tjera që janë për mjekët, e kështu me radhë. Dhe, i kam disa vërejtje të cilat në parim duken teknike, por duhet t'i rregullojë komisioni funksional. Për shembull, zbatimi i drejtë i ligjit, ku e kanë parë. Nuk ka zbatim të drejtë dhe të padrejtë të ligjit, por ligji duhet të zbatohet ashtu siç është i shkruar dhe kjo mendoj se duhet të rregullohet. Nuk po hyjë edhe në përmbajtje komplet, sepse është gabim e normuar, dhe neni 27 -dispozitat shfuqizuese. Çdo ligj apo akt tjetër nënligjor, i cili do të bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, do të shfuqizohet në afatin e përcaktuar ligjor. Mendoj, kjo nuk duhet qëndruar, nuk ka dispozita shfuqizuese, por ky ligj është ai që i shfuqizon të gjitha rregullat të cilat bien në kundërshtim me këtë ligj, prandaj është mirë që edhe kjo çështje të mos ekzistojë.

Duke marrë parasysh këto rekomandime që i dhamë, unë konsideroj se ky ligj është i domosdoshëm dhe duhet të aprovohet në parim sot. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputeti Shkumbin Demaliaj, le përgatitet për fjalë deputetja Flora Brovina.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Zotin ministër e përshëndes, si dhe ministrin tjetër, kërkoj falje. Është prani e vogël e ministrave sot,

Të nderuar deputetë,

Është me rëndësi kjo përshëndetje për ministrin, sepse nuk është faji i tij pse sot vjen në Kuvend një ligj, duke munguar ligji bazik, që është Ligji për punën, por janë defektet sepse në kuadër të strategjisë legjislative ka qenë e rregulluar kështu, sepse ne kemi pasur më herët edhe Ligjin për punë në Kuvend, por është kthyer mbrapa.

Arsyeja e kthimit mbrapa të Ligjit të punës, e tha edhe kolegu më herët, është kostoja financiare, gjë që është e paqëndrueshme. Sot, Qeveria gjatë publikimeve të veta që i bën pas vendimeve që merr, por edhe vendimet tjera politike në Kosovë, që rëndojnë situatën kushtimisht në të gjithë resorët, edhe kur flitet se kush është organ më vendimmarrës në Kosovë sot, a është UNMIK-u apo Qeveria, sot Qeveria nuk e ka të zgjidhur problemin me ligjin e vet. Ende funksionon me Rregullore të UNMIK-ut, nuk ka ligj për Qeverinë në Kosovë.

E dyta, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin e punës në Kosovë, i rregullon të gjitha çështjet, mirëpo është Rregullore e UNMIK-ut. Ndërkaq, vetëm pengon mundësinë e të hyrave në arkën shtetërore, duke përkufizuar sepse te neni 24 i kësaj Rregulloreje me dispozitat që janë në fuqi, pengon shumë punën e Inspektoratit të punës për të kryer implementimin e punës që e obligon vetë Ligji për Inspektoratin dhe Ligji për siguri në punë. Kështu që është e drejtë e rezervuar e PSSP-së që ai të nxjerrë një urdhëresë administrative për mundësinë e lejimit të gjobave në procesin e punës dhe të punësimit atëherë kur bëhen shkeljet ligjore. Do të thotë, kjo është vetëm një pengesë që dikush sot të ushtrojë veprimtari ilegale edhe në procesin e punës i kontrolluar nga dikush. Do të thotë, në qoftë se nuk është e gatshme Qeveria ta ofrojë edhe një herë atë ligj, ne si grup parlamentar jemi të gatshëm që ta sjellim një projektligj, por atëherë kërkojmë mbështetjen e të gjithë deputetëve ta aprovojmë, sepse nuk ka aq kosto të madhe financiare, por është pengesë për arkën shtetërore të Kosovës. Kështu që kësaj i mungon edhe një harmonizim, sepse Qeveria në kuadër të Ligjit për siguri në punë ende nuk ka themeluar Këshillin nacional të sigurisë në punë, që është e përcaktuar me ligj që të mund të harmonizohet ky legjislacion me ligjin bazik.

Kështu, regjistrimi i bizneseve në Kosovë, me një rregullore apo me një vendim të OSBE-së, në fillim të fillimit të institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse, me atë vendim ka qenë që nëpërmjet Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë stimulimi i bizneseve të bëhet edhe të regjistrohet me një vlerë prej 5 eurosh, për të mundësuar regjistrimin e këtyre bizneseve.

Sot ka me qindra biznese kineze vetëm në Prishtinë që nuk mund t'i monitorojë askush. Kemi edhe martesë, do të thotë, fallco në Kosovë për t'ua mundësuar këtyre të huajve që të punësohen në Kosovë edhe nuk kanë mbikëqyrje nga askush.

Unë e përkrah këtë Projektligj dhe do ta votoj, sepse është i tanishëm, sepse për Rregulloret të UNMIK-ut edhe për ligjet e Kosovës, është bërë njëjtë, sepse Qeveria është kah do kështu. Kur i duhen rregulloret e UNMIK-ut, punon me to dhe fajin ia lë EULEX-it, kur i duhen ligjet e Kosovës, i fut ato në fuqi, por kryesisht Ligji është i mirë dhe është i domosdoshëm sepse në Kosovë pa ligj, jashtëligjshëm nuk duhet të veprojë askush i huaj. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Flora Brovina, le përgatitet deputeti Naser Rugova.

FLORA BROVINA: Ju faleminderit!

I përshëndes ministrat këtu dhe juve kryesues,

Kolegë dhe kolege,

Natyrisht që e kuptoj domosdoshmërinë, qoftë politike, qoftë si kontroll, qoftë edhe si përfitim material në buxhetin e Kosovës, edhe pse këtu nga ministri për Punë dhe Çështje Sociale nuk e kuptuam mirëfilli sa është ky numër, se bizneset regjistrohen në Kosovë. Nëse janë të paregjistruara, ka mundësi që të ndëshkohen dhe edhe ato të regjistrohen, pra të dënohen. Prandaj, kishte qenë shumë e mirë ne ta dinim saktë se sa është numri i njerëzve që hyjnë dhe formojnë marrëdhënie pune të paligjshme, pa mbështetje ligjore këtu. Kjo nuk u tha.

E kuptoj se ky ligj ka mbështetjen kushtetuese, ka edhe mbështetjen në Ligjin për të huaj, por këtij ligji i mungon ligji bazik, u tha nga shumë diskutues, i mungon Ligji i punës dhe, nëse në këtë ligj thuhet se ligji mund të hyjë në fuqi pasi të aprovohet Ligji i punës, atëherë edhe njëherë e shtroj pyetjen, ç'na duhet një ligj i pafuqishëm, do me thënë i cili nuk mund të funksionojë menjëherë, ose do të funksionojë parcialisht.

E dyta, jam anëtare e Komisionit për Punë dhe Çështje Sociale tani në mandatin e tretë dhe nga anëtarë të këtij Komisioni, të cilët vazhdimisht kanë bërë presion në Qeveri që të sillet Ligji i punës, madje duke i refuzuar edhe disa ligje të vogla që dalin nga ligji bazik, siç është Ligji për grevat, Ligji për organizimin sindikal e të tjera. Edhe ky Ligj hyn në ligjet që mund të përfshihet në Ligjin e punës, do me thënë një nen i veçantë në Ligjin e punës mund të jetë për të punësuarit e huaj në Kosovë dhe të mos bëhet kaq e pamundshme që të zbatohet.

Në anën tjetër, për mua shtrohet një dilemë. Tani, kur të nxirret Ligji i punës, a do t'u adaptohet ai ligjeve, ligjit sikur ky, ligjeve të vogla apo ligji bazik do të jetë ai që i mundëson ligjet e vogla, do me thënë ligjin sikur është ky për punësimin e të huajve. Në të vërtetë, Ligji ka një defekt tjetër, e ky është vetë titulli i ligjit. Ligji në të vërtetë nuk i mundëson të gjitha rregullat e punës, pushimin e lehonisë, pushimin mjekësor dhe të tjera, por mundëson regjistrimin e dhënies së lejes së punës, pra. Prandaj, ligji duhet ta ndryshojë titullin për të qenë ligj që të funksionojë dhe është domosdoshëm.

Sa i përket mbështetjes në ligjet e Bashkimit Evropian, Bashkimi Evropian siç u tha, nuk ka ligj të tillë që i privilegjon të huajt, por ka ligjin e punës ku përfshihen edhe të drejtat e të huajve sikur të gjithë qytetarëve të tjerë. Prandaj, ekziston dilema dhe sigurisht shumë e vështirë do të jetë për anëtarët e komisionit bazik që të bëjnë ndryshimet e duhura që ligji të jetë funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Naser Rugova, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Po e diskutojmë një ligj gjithashtu shumë të rëndësishëm për lidhjen e kontratës së punës të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.

Ky ligj, neni 1 rregullon mënyrën, kushtet dhe procedurat e punësimit për shtetasit e huaj dhe të personave pa shtetësi në Republikën e Kosovës. Mirëpo, Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe sponzoruesit e ligjeve, në këtë rast Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ky Kuvend, a e kemi miratuar një ligj fundamental për punën, ligjin bazik, Ligjin e punës? Jo! Atëherë, të gjitha këto aktivitete tjera, humbje kohe, nën presione me apo pa arsye, e sjellin këtë Parlament të nderuar si përfaqësues të zgjedhur të qytetarëve të Republikës së Kosovës, në lajthitje dhe në dilema deri në jo seriozitet. Nuk është e thënë që një strategji legjislative, kur nuk shkon konform kërkesave dhe trendeve politike dhe socio-ekonomike, të respektohet njëqind për qind dhe unë nuk e di pse kjo Qeveri nuk e ka parë të arsyeshme në këtë strategji legjislative për vitin 2009, të futet ligji kryesor, ligji kryesor mbi të cilin edhe ndërtohen raportet e dialogut social në vendin tonë, duke i ditur rrethanat dhe gjendjen e rëndë ekonomike dhe papunësinë në vend dhe lëshohemi në ligjet derivateve, që janë të rëndësishme, që janë të rëndësishme, askush nuk po i konteston. Po, si mund të shkojmë te “Zh”-ja a e kaluar “A”-në! Kjo po e tregon seriozitetin, qasjen dhe prioritetet e kësaj Qeverie sa i takon punësimit dhe të gjitha procedurave që lidhen me të.

Legjislacioni i BE-së lidhur me punësimin e të huajve. Lëvizja e lirë e punëtorëve është e drejtë e garantuar në Traktatin e komunitetit evropian. Kjo vlen për 27 shtete anëtare të Bashkimit Evropian dhe, ne, pa e miratuar Ligjin bazik, nuk mund të shkojmë në ligjet derivateve, sepse do të na duhet herët ose vonë që ky ligj të amendohet përsëri dhe të inkorporohen ato amendamente bazike që do të dalin nga Ligji i punës. Dëshëm ose nuk dëshëm, dëshën partnerët e koalicionit ose jo, herët ose vonë do të obligohemi ta miratojmë Ligjin e punës, se nuk ka shtet në botë, shtet që funksionon normalisht, që nuk ka ligj bazik për punën. Në këtë kontekst, ne nuk mund të miratojmë ligje, qofshin edhe kërkesa nga obligimet që dalin nga kriteret e Kopenhagës dhe *acquis communautaire* pa ligje bazike të cilat i rregullojnë parlamentet nacionale, janë çështje të rregullimit të marrëdhënieve me anë të legjislacionit nacional.

Arsyetimin për Projektligjin po e citoj: “Arsyeja e hartimit të Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj, është krijimi i infrastrukturës ligjore në pajtim me konventat ndërkombëtare dhe me legjislacionin e BE-së”. Në rregull, ne duhet t’i harmonizojmë, por pa ligj bazik dhe ne ende nuk jemi as vend kandidat potencial për anëtarësim në BE, unë nuk di si mund t’i miratojmë këto. Çdo i huaj që vjen në Kosovë dhe hap biznes, duhet të regjistrojë biznesin e tij në Zyrën e Departamentit për regjistrimin e bizneseve. E kemi këtu edhe ministrin e Tregtisë, Industrisë dhe, po ashtu, çdo i huaj që hap biznes këtu, është i obliguar që të paguaj tatimin, regjistrimin e kompanisë dhe sigurisht që ekziston një evidencë. Edhe një herë po e potencoj dhe, mirë që është ministri i Tregtisë dhe i Industrisë këtu, unë jam i bindur dhe kam të dhëna që të gjitha bizneset që veprojnë, shtetasit e huaj apo kompanitë e huaja janë të regjistruara në Kosovë, sepse ato nuk mund të funksionojnë ilegalisht, dhe të punësuarit dhe punëtorët që duhet t’i

nënshtrohen legjislacionit nacional tani, parashtrohet pyetja cilit legjislacion për punën, kur nuk kemi fare Ligj për punën. Këtu, edhe deputetë të koalicionit qeverisës po e kundërshtojnë këtë ligj. Deputetët që kanë përvojë dhe që janë me nga shtatë-tetë vite në Komisionin funksional për Shëndetësi, Punë dhe Çështje Sociale.

Andaj, të nderuar deputetë, po e citoj edhe një paragraf të këtij ligji: “Ky Ligj ju drejtohet të gjitha institucioneve të nivelit qendror dhe lokal të Republikës së Kosovës, të cilat në çfarëdo forme janë të implikuara në punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës”. Ky nen është i paqartë dhe nuk prejudikon, nuk precizon në mënyrë të qartë, si një ligj i një shteti, se çka do të thotë ky nen. Nuk parashihihen as udhëzime administrative që janë të domosdoshme për zbatimin e këtij ligji në praktikë.

Qeveria e Republikës së Kosovës, thotë neni 4, në përputhje me politikën e emigracionit, gjendjes dhe lëvizjes në tregun e punës, në fund të çdo vitit cakton numrin e lejeve të punës për vitin e ardhshëm, që është nonsens dhe bie në kundërshtim me Traktatin e komunitetit të Bashkimit Evropian për shtetasit e huaj në përputhje me nevojat dhe mundësitë e punësimit të të huajve në vendin tonë. Cilat prioritete? Çfarë prioritetesh ka caktuar Qeveria dhe Ministria dhe të gjitha këto prapë lidhen me ligjin bazik.

Andaj, unë ju bëj ftesë, thirrje deputetëve që ligje të tilla të rëndësishme, unë e di që është e nevojshme të jetë një legjislacion adekuat për shtetasit e huaj që punësohen në vendin tonë, ama pa ligje bazike po humbim kohë dhe do të jemi të detyruar prapë të debatojmë në të ardhmen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Unë e kam një kërkesë, që vërtet deputetët që e marrin fjalën, në vazhdim mos ta ngatërrojnë këtë ligj me Ligjin e punës, që vërtet ndryshojnë shumë. Fjalën ia kisha dhënë deputetit Riza Smaka dhe le të përgatitet deputetja Nurishahe Hulaj.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri Kryetar!

Zotëri ministra,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Ky dokument ka mjaft lëshime dhe defekte edhe juridike-materiale, edhe juridike-formale, edhe gjuhësore. Fillimisht, titulli po e zëmë, thotë: Projektligji për punësimin e shtetasve të huaj. Në vazhdim gjithkund thotë, të huaj, e të huajt mund të jenë patrid, mund të jenë apatrid, a shtetasit e huaj mund të jenë vetëm patrid. Do me thënë, është gabim juridik material që nuk mund të kapërcehet. Këtë e them në parim, që nëse shkon, komisioni funksional ta ketë parasysh këtë çështje, ndër të tjerat.

Ju lutem, paragrafi i dytë, një formulim përnjëmend qesharak, i nenit 2. Ja, çka thotë: “Ky ligj iu drejtohet të gjitha institucioneve të nivelit qendror dhe lokal të Republikës, të cilat në çfarëdo forme janë të implikura në punësimin e shtetasve të huaj”. Çdo ligj që e miraton Kuvendi iu adresohet jo nivelit lokal edhe qendror, po të gjitha entiteteve, prandaj ky është një formulim krejtësisht i panevojshëm edhe i papërshtatshëm.

Ka shprehje, ka terma të cilat nuk përkasin kurrësi me gjuhën jurisprudente. Bie fjala, te neni 9, në serbisht thuhet: “Obnova radne dozvole”, duhet të thuhet “produženje”, po e zëmë, ose zakonisht këtu thuhet “dokument”, “dokument”, në gjuhën juridike letrare serbe-boshnjake, thuhet: “isprava”, “isprava”, ose në anglisht bie fjala, te neni 12

“exemotion”, “exemotion” është përjashtim, ndërsa fjala për ndërprerjen e lejes së punës do të duhej të ishte shprehja: “cessation” ama kjo është, ju lutem esenciale.

Neni 21 thotë, ky një formulim që kish për të krijuar lajthitje në praktikë: “Kundër vendimit mbi refuzimin e kërkesës për dhënien e lejes së punës për shkak të plotësimit të numrit të lejeve të përcaktuara nga Qeveria, nuk lejohet ankesa”. Shtetasi i huaj, në këtë rast, i cili është i pakënaqur me pamundësinë e ankimit, mund të iniciojë procedurë gjyqësore pranë gjykatës kompetente. Ju lutem, pranë gjykatës me kërkesë nuk iniciohet asnjë procedurë, por me kërkesëpadi, më pastaj cila gjykatë, që do të ishte një dispozitë konfuze që në start abinicio. Edhe, përfundimisht, në gjuhën shqipe, në nenin 22, gabimisht, “gjobat” duhet të ishte “dënim me të holla” në gjuhën shqipe, ndërsa në gjuhën serbishte-boshnjakishte prapë gabimisht thuhet: “kazne”, do të duhej “novčane kazne”, e në anglisht prapë gabimisht, thotë: “Penalties”, “penalties” e do të duhej “fine” sepse është fjala për dënim kundërvajtës, dua të them se shprehjet kur nuk janë adekuate, krijojnë konfuzion në interpretim, a interpretimi është procesi logjik më i rëndësishëm gjatë aplikimit, sidomos për këtë ligj kur ky u referohet shtetasve të huaj.

Edhe, përfundimisht, ju lutem, neni 27 thotë: “si çdo ligj apo akt tjetër nënligjor, i cili do të bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, do të shfuqizohet në afatin e përcaktuar ligjor”. Një formulim krejtësisht qesharak. Një formulim që me të vërtetë nuk ia jap as tonin si të them elementar të një rregulloreje e jo më të ligjit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Nurishahe Hulaj, le të përgatitet deputeti Driton Tali.

NURISHAHE HULAJ: I nderuari Kryetar i Kuvendit, Kabinet qeveritar dhe deputetë të nderuar,

Projektligji për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, është një projektligj i paraqitur me një strukturim mesatarisht të mirë. Ka 28 nene, nuk ka grupin punues që e ka punuar këtë projektligj, nuk është i ndarë në kapituj.

Opinion i ligjor për Projektligjin: Deklarata e IS thotë se legjislatura e BE-së nuk e rregullon çështjen e punësimit të shtetasve të huaj, ndërsa opinion i përgjithshëm thotë: Lëvizja e lirë e punëtorëve është e drejtë e garantuar me Traktatin e komunitetit evropian, neni 39, i cili përcakton eliminimin e barrierave në lidhje me punësimin, ku shtetasi i huaj i një vendi anëtar i BE-së, pa kurrfarë diskriminimi direkt apo indirekt mund të punësohet në shtetin tjetër anëtar të BE-së.

Bashkësia Evropiane nuk ka ndonjë akt juridik të obligueshëm në lidhje me punësimin e shtetasve të huaj në territorin e BE-së, ndërsa Rregullorja ekzistuese në Kosovë, Rregullorja e Punës nuk iu referohet shtetasve të huaj. Në anën tjetër, në Kosovë, siç e cekën kolegët e mi, nuk ekziston një ligj bazik i punës.

Komentet e bëra në projektligj, pasqyrojnë qëllimin e shprehur nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës që të bëjnë përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së, dhe ne konsiderojmë se paralel me këtë projektligj të përkrahen edhe politikat e mundësisë së bërjes së Ligjit të punës si ligj bazik në Kosovë. Projektligji i paraqitur rregullon mënyrën, kushtet dhe procedurat e punësimit për shtetasit e huaj dhe të personave pa shtetësi, duke përfshirë dhënien e lejes, llojet e lejeve, mbarimin e lejes së punës dhe çështjeve të tjera.

Do t'i përmend dy askete për këtë projektligj. E para, ky projektligj identifikon me leje pune shtetasit e huaj dhe, e dyta, mundëson përjashtimet nga detyrimet për pajisje me leje pune. Projektligji në versionin anglisht, ka shumë lëshime për të cilën mbetet shumë për t'u punuar në komisionin funksional. Vlerësimi i ndikimit buxhetor, është i përballueshëm dhe nuk pritet të ketë pengesa buxhetore gjatë zbatimit, por eventualisht nëse paraqiten pengesa, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale do ta plotësoj këtë çështje.

Projektligji thirret kryesisht në rregullore, në direktiva, rezoluta, traktate evropiane, të cilat nuk kanë karakter obligativ, ndërsa në nivel vendor të Republikës së Kosovës thirret në Rregullore të Qeverisë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, rregulla 49. Ligji për të huaj, Ligji për shtetësinë, i cili nuk është në fuqi ende në Kosovë.

Nevoja për këtë Projektligj, meqenëse në Republikën e Kosovës ka shumë shtetas të huaj të cilët punojnë në të zezë, pa kurrfarë kritere për punë, pra ky projektligj do të mundësonte rregullimin e kësaj kategorie të cilëve ju mundësohet leja e punës dhe punësim në kushtet e ekonomizimit dhe të privatizimit.

Rëndësia e projektligjit: eliminon punësimin në të zezë, është me rëndësi edhe në kuadër të ratifikimit të marrëdhënieve ndërshtetërore që do të bëjë Republika e Kosovës në të ardhmen, Qeveria cakton numrin e lejeve të punës sipas propozimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, lejet lëshohen nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale sipas kategorive a, b, c, d, e të tjera.

Ngelet shumë që ky projektligj për t'u zbatuar në tërësi, meqenëse mund të jetë i zbatueshëm vetëm aplikimi për leje pune, kryesisht mbulohet me hartimin e akteve nënligjore, që do të rregullonin marrëdhëniet e punës për këtë projektligj dhe parashihet që këto akte nënligjore të lëshohen 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Prandaj, konsideroj se i mbetet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që të angazhohet në maksimum për ta mbuluar tërë këtë Projektligj për të qenë i zbatueshëm dhe për të realizuar të drejtën e atyre kategorive që janë të parapara me këtë ligj.

Edhe unë jam që titulli i ligjit të ndryshohet dhe kisha për të thënë kështu të jetë ky titull: Projektligji për dhënie leje për punësimin e shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi në Republikën e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Do të thotë, vërejtjet mund të shkojnë me amendamentim. Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputeti Ibrahim Selmanaj.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të qenët i fundit, nuk po na jetë çka të themi tjetër, por mbase, ngase jam lajmëruar, të them se në parim unë e përkrah këtë ligj, edhe pse kolegët e mi nga opozita po më qortojnë, por mendoj se ky ligj ndonëse thotë për punësimin e shtetasve të huaj, do me thënë e ka titullin e gabuar apo jo adekuat me atë se çka brenda shqyrton, sepse më shumë shqyrton statusin e të huajve. Mendoj se neve na vyen ky ligj, mendoj Kosovës, por edhe të huajve iu vyen që ta kenë një pasqyrë për statusin e tyre, kushdo që të vjen të investojë. Mendojmë te këta ndërmarrësit e vegjël, jo te ata të mëdhenjtë apo të

mesmit, ngase me ata është punë tjetër, që ta kenë edhe ata parasysh statusin e tyre në kuptimin e lejes së qëndrimit në Kosovë.

Pajtohem me të gjithë deputetët të cilët e ngritën nevojën që Ligji i punës të vijë sa më shpejt në Parlament dhe ta shqyrtojmë, por po them edhe njëherë, pajtohem edhe me të tjerët që thanë se ky ligj nuk duhet lidhur me Ligjin e punës, për shkak se rregullon një çështje tjetër. Ky ligj është shkruar shumë keq, andaj pajtohem edhe me ato kritika që u dhanë, qoftë në gjuhën shqipe, qoftë në gjuhët e huaja, po mendoj në gjuhën angleze dhe në gjuhën serbokroate apo boshnjake. Por, megjithatë, po them se është një ligj që të paktën shtetit dhe qeverisë së Kosovës i ndihmon për evidentimin dhe monitorimin e të huajve në Kosovë edhe duke pasur parasysh se ndërmarrësit e huaj, kushdo që të hapë biznes në Kosovë, duhet të regjistrohen në MTI, por unë e kam parasysh se në çfarë mënyre ata regjistrohen në MTI, që është një regjistrim tjetër nga ajo që në njëfarë mënyre këtu e jep atë bazamentin e statusit të personave të huaj, të cilët dëshirojnë të jetojnë në Kosovë. Unë po pajtohem me atë se këtë ligj nuk duhet, edhe njëherë po e potencoj, që domosdo ta lidhim me Ligjin e punës për shkak se të paktën në atë që, hiqe titullin, në atë që është trajtuar në këtë ligj, nuk trajton tjetër pos, po e them edhe njëherë, statusin e të huajve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, për diskutim korrekt. Fjalën e ka deputeti Ibrahim Selmanaj, le të përgatitet Gani Buçinca në emër ose me kartelën e Gani Kocit.

IBRAHIM SELMANAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Pothuaj se, marrë në përgjithësi, shumica e deputetëve e kanë mbuluar temën edhe shqetësimet që janë rreth ligjit në fjalë. Shqetësimin që do ta shfaq unë, në këtë rast, është si do të implementohet ky ligj dhe kush do ta implementojë, ndërsa nuk mund t'i ikim faktit se sa i nevojshëm dhe i domosdoshëm është Ligji i punës dhe përpos disa fjalëve të mira të shkruara se është i harmonizuar me ligjet e Bashkimit Evropian, shqetësues është fakti se cilat janë rekomandimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe cilat janë konsekuencat e mëtutjeshme.

Është edhe një element i cili e rëndon Kosovën, pavarësisht deklarimeve publike të ministrit dhe të Qeverisë së Kosovës se ne jemi të gatshëm të thurim kontrata për punëtorët, për numrin e të papunëve dhe mundësinë që Kosova të thurë kontrata me shtetet të cilat kanë nevojë për punë të ndryshme. Mungesa e Ligjit të punës është parakushti themelor dhe Kosova nuk është e gatshme dhe kjo është shqetësuese.

Nuk mund të mburremi me faktin dhe krahasimet me zhvillimet të cilat kanë ndodhur, zoti kryetar! Ne jemi shtet tash që një vit, e kemi festuar edhe atë me krenari dhe jemi mburrë me faktin se jemi nënshkrues të asaj pavarësie të Kosovës, po jemi një vit shtet, zoti Kryetar, dhe mungon Ligji i punës. Nuk ka arsyetim nga deputetët të cilët kanë folur pak më herët se është kostoja financiare, e cila nuk e mbulon Ligjin e punës. Realisht, jemi të papërgatitur dhe mungon një strategji e qëndrueshme që qytetarëve të Kosovës t'u ofrojmë një platformë dhe një siguri dhe garanci për punë. Ka shumë të meta në ligj dhe punët duhet t'i marrim për së mbari, jo së mbrapshti. Ky ligj nuk rregullon asnjë çështje dhe është shqetësues. Nuk rregullohet çështja e punës me rregullore, nuk rregullohet as dialogu social me rregullore dhe është mungesë e pakos së ligjeve dhe unë jam kundër këtij ligji, ligj i cili nuk rregullon asnjë çështje.

Po më vjen mirë se..., jo po më vjen mirë se po qeshin, valla. Nuk është qesharake kjo që ndodhë edhe nuk është hera e parë, por ndoshta me vetë faktin se sa seriozisht i kemi marrë punët edhe si Qeveri, edhe kjo të bien deri te rezultati dhe te puna që e keni nisur shumë keq.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër! Po, ke qenë tri vjet ministër dhe i di arsyet pse në Parlament nuk është Ligji i punës.

Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, me kartelë të Gani Koci.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar ministra,

Me të vërtetë ishte pak edhe argëtues ky diskutimi i fundit dhe unë çuditem edhe habitem se si disa deputetë e shfrytëzojnë çdo mundësi për të pasur këtu diskutime teatrale edhe melodramatike në Kuvend. Unë e përshëndes Kryeministrin e ministrin, i cili e ka sponsorizuar Ministrinë dhe ministrin në këtë ligj dhe, mund të them se ky ligj me pak ndërhyrje mund të bëhet një ligj i mirë, i cili përkohësisht e rregullon çështjen e punësimit të të huajve në Republikën e Kosovës dhe njëkohësisht krijon në bazë të mirë që të kemi një kontroll kush hyn dhe si qëndron në Kosovë.

Përshëndes të gjithë ata të cilët e përkrahën dhe kam një vërejtje dhe një sugjerim, se ky ligj nuk ka të bëjë me biznesin në Kosovë, regjistrimin e bizneseve, po ka të bëjë me individë të cilët punojnë në Kosovë dhe të cilët, si të tillë, duhet t'i gëzojnë edhe disa të drejta elementare me konventa ndërkombëtare. Ata të cilët punojnë në Kosovë, duhet të kenë, duhet t'ju ofrojmë shërbime shëndetësore, para së gjithash, duhet t'ju ofrojmë një mënyrë legale të qëndrimit këtu dhe, në këtë kontest, ma merr mendja se ky ligj i plotëson disa nevoja emergjente që të huajt këtu të qëndrojnë në mënyrë legale në Kosovë, por mos të qëndrojnë në mënyrë ilegale.

Ju kisha propozuar të gjithë atyre që e përkrahën, edhe komisionit funksional, që një prej dispozitave të këtij ligji duhet të parasheh sigurimet shëndetësore në ndonjë kompani private për të gjithë, para se të lëshohet leja e qëndrimit dhe e punës në Kosovë, që çdo shtetas i huaj të bëjë sigurimin shëndetësor në një kompani private të shëndetësisë për aq kohë sa është edhe leja valide, leja e punës valide. Unë e mbështes këtë ligj dhe besoj se edhe partnerët e koalicionit, por edhe disa deputetë që janë më të arsyeshëm nga opozita dhe është mirë që ligji sa më parë të aprovohet dhe fillojë të zbatohet në Kosovë.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti i fundit, sipas kësaj që kam unë në ekran, meqenëse po vazhdon, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Mendoj se shumë aspekte të këtij projektligji janë përmendur sot, ka edhe aspekte të mira, ka edhe aspekte negative. Një aspekt, më sa kam dëgjuar unë, nuk është përmendur i ligjit, e ky aspekt është marrëdhëniet tona me vendet fqinje në lidhje me Ligjin për punësimin e shtetasve të huaj.

Mendoj se kur flasim për punësimin e shtetasve të huaj në një vend sikur Kosova, e cila nuk është, i cili shtet nuk është, do të thotë, një shtet në të cilin ka emigrim prej

vendeve të largëta për punësim, sikur që ka në vendet e zhvilluara industriale, mirëpo kryesisht njerëz të cilët mund të quhen të huaj ose pjesa dërmuese e shtetasve të huaj, të cilët mund të jenë të punësuar në Kosovë, janë prej vendeve fqinje dhe kryesisht janë prej Maqedonisë dhe, tani prej Serbisë administrative, dhe ata për Kosovën me ligj janë shtetas të huaj, qofshin prej Maqedonisë Perëndimore, qofshin prej Luginës së Preshevës, qofshin prej cilës do pjesë tjetër, kur flasim për ligjin, ata për ne janë shtetas të huaj.

Tani, nëse ne nuk kemi kurrfarë marrëdhëniesh kontraktuale me cilindo prej vendeve fqinje, që edhe ata të kenë kritere të njëjta për punësimin e shtetasve të Kosovës në ato vende, atëherë mendoj se këtij ligji duhet, përpos aspekteve financiare, buxhetore, sociale e cilat do qofshin ato, duhet t'i shtohet edhe një analizë politike e aspekteve, po them edhe një herë, të marrëdhënies kontraktuale me vendet fqinje.

Aspektet buxhetore, aspektet sociale, kur e dimë që kemi papunësi të madhe e të gjitha të tjerat, janë shumë valide, po, po ju thërras edhe një herë që të kemi kujdes me këtë ligj për shkak se përmban në vete edhe çështje të cilat as që janë përmendur sot këtu dhe të cilat mund të kenë implikime ose të shkaktojnë implikime, të cilat nuk janë studiuar me sa po shoh unë, ose të paktën nuk janë paraparë me asnjë nen ose paragraf në këtë ligj. Ky ishte intervenimi im i vetëm. Unë për këtë ju thërras që ta shtyjme këtë ligj, që ta kemi Ligjin e punës paraprakisht, që të studiohen edhe aspektet tjera dhe që të kemi marrëdhënie kontraktuale me vendet tjera para se ta aplikojmë një ligj të tillë në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka ministri Nenad Rashiq. Dy minuta, nuk ka shumë.

NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Zahvaljujem se i poslanicima koji su već unapred odogorili na neka pitanja koji su takodje drugi poslanici postavili. Ja absolutno razumem vas i razumem što se tiče vašeg zahteva za ovaj Zakon o radu, i verujte mi da ja bih bio najsrećniji da taj Zakon o radu danas usvajamo. Ali, nažalost, znate i sami da imamo mnogo poteškoća, unutar, ponoviću po stoti put, unutar limitiranog budžeta. I znate i sami da predloge koje smo imali od naših strateških partnera iz međunarodne zajedice, kao što su Međunarodni monetarni fond, kao što su Svetska banka, te savete smo morali da podržimo i da saslušamo. Jer, još jednom kažem, svi, siguran sam u to, znate šta znači ukoliko dobijete instrukcije, odnosno savete od strane tih organizacija.

Prema tome, Zakon o radu će biti ove godine. Biće, mi ćemo imati prvi draft uskoro. Možda bih smeo da kažem do kraja marta, ali ipak neka to bude sredinom aprila i taj zakon će biti dobro regulisan. Ono što se možda ponekada čini da kasnimo sa zakonom, jer samo zbog razloga zato što hoćemo zakon da bude ispravan i u skladu sa preporukama zemalja iz Evropske unije.

Ovaj Zakon o kome danas pričamo, ne favorizuje strance, nego daje osnovu kako oni mogu da budu deo našeg društva, a mi vodimo računa o tome izdavajući im dozvole za rad i stavljajući im pravnu osnovu da bi bili ovde. Mi i dalje sa ovim zakonom proširujemo tu našu lepezu pravnog delovanja. I tehnički je bolje da ovaj zakon prodje sada, da ne bi na njega čekali posle. Ovim tehničkim delovima pravimo jednu veliku našu bazu, koji će, zdravlje mi kažemo, zakonom, sa Zakonom o radu biti

završena, odnosno jedan deo naše pravne baze će biti ispunjen. Ja vas pozivam sve stvarno, mislim da je zakon dobar, ne sumljam, čitao sam ga i ja, znam da ima manjih tehničkih problema, ali naravno zato postoji i analiza zakona, zato postoje i ispravke. Svaki ko radi taj i greši. Uglavnom, naše najbolje namere su prenešene u taj zakon.

Još jednom vas molim da podržite zakon, jer je bitan za naše kosovsko društvo. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Më lejoni të them, të nderuar deputetë, kur kemi në rend dite ligjet në parim, është mirë ta ndryshojmë renditjen e diskutimeve, në fillim të diskutojnë deputetët, pastaj kryetarët e komisioneve dhe, në fund, shefat e grupeve parlamentare...

(ndërhyrje nga salla)

... po de, le t'i dëgjojnë shefat e grupeve parlamentare diskutimet, pastaj le ta thënë qëndrimin e grupit.

Lus regjinë dhe deputetët, të përgatiten për votim dhe votojmë, tash:

Pa kartelë „për“ 2. „kundër“ pa kartelë 1.

Me 48 vota „për“, 20 „kundër“, 1 abstenim, miratohet në parim Projektligji për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, ngarkohen këto komisione:

- Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional,
- Komisioni për Buxhet dhe Financa,
- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
- Komisioni për Komunitete, dhe
- Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit i paraqesin me rekomandime.

Kalojmë në pikën e radhës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij Projektligji.

Ftoj ministrin e Tregtisë dhe të Industrisë, zotin Lutfi Zharku, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantoj Projektligjin.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që shkurtimisht t'i paraqes arsyet për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe derivate të naftës si dhe qëllimin dhe rëndësinë që ka për sistemin e gjithëmbarshtëm ekonomik të Kosovës.

Periudha trevjeçare e aplikimit të këtij ligji, ka vërtetuar se ligji aktual ka mjaft mangësi, prandaj edhe nuk të aplikohet në mënyrë efektive, kurse shpesh paraqiten edhe situata të padefinuara dhe të paqarta, gjë që vështirëson vendimmarrjen e institucioneve tona, kurse në rastet e caktuara, politikat tona programore nuk mund të zbatohen për shkak të kufizimeve aktuale ligjore.

Ndryshimet dhe plotësimet fillojnë me shtimin e veprimtarisë së përpunimit të derivateve të naftës, si nevojë e biznesit, dhe heqjen e veprimtarisë së transportit nga ky ligj, pasi që kjo fushë është e rregulluar me Ligjin mbi transportin e mallrave të rrezikshme. Plotësimet e Ligjit vazhdojnë me heqjen e kufizimeve të panevojshme ligjore me rastin e emërimit të Këshillit të Naftës, përcaktimit të njëjtë të mandatit për të gjithë anëtarët, definimit të qartë të kompetencave, përgjegjësi, raportimit dhe procedurës së shkarkimit të anëtarëve të tij, si dhe të ndalimit të emërimit në këshill të zyrtarëve të cilëve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës me procedurë disiplinore.

Zgjidhjes së kontesteve eventuale me rastin e licencimit të kompanive iu është kushtuar kujdes i posaçëm dhe duke e institucionalizuar Komisionin e Ankesave si organ për vendosje.

Përcaktimi strikt i llojit të licencave dhe të tarifave me ligjin aktual ka qenë barrierë në rregullimin e tregut, prandaj propozohet që kjo çështje të rregullohet me akte nënligjore në përputhshmëri me nevojat e tregut.

Kryerja e të gjitha obligimeve publike, përfshirë edhe qiratë për shfrytëzimin e objekteve publike, si dhe sigurimi obligativ për dëme ndaj palëve të treta, janë propozuar si kushte shtesë për licencim të kompanive. Në anën tjetër, është propozuar heqja e obligimit që këshilli t'i njoftojë kompanitë se iu ka skaduar licenca, kurse është propozuar të shtohet obligimi i subjekteve që ato të paraqesin kërkesë për përtëritje të licencës 30 ditë para skadimit të saj.

Risi e propozuar është edhe heqja e marrjes së vendimit për licencim nga ana e këshillit me procedurë të votimit. Sa i përket standardeve të naftës, është propozuar që ato të përcaktohen me anë të akteve nënligjore në përputhshmëri me zhvillimin ekonomik të vendit dhe të standardeve të BE-së, natyrisht, duke pasur çdoherë parasysh që aplikimi i tyre të mos shkaktojë çrregullime në furnizimin e tregut apo favorizim të një prodhuesi apo vendi. Duke marrë parasysh zhvillimet në tregun e naftës gjatë vitit të kaluar, që kryesisht kanë të bëjnë me lëvizjen e çmimeve, kemi propozuar që Qeveria të ketë të drejtën e ndërhyrjes në treg me masa të caktuara, siç janë përcaktimi i çmimeve shitëse maksimale apo minimale, me shumicë dhe pakicë, ose të përcaktojë marzhat maksimale për shitje me shumicë dhe pakicë. Megjithatë, këto masa nuk mund të aplikojnë për më gjatë se 90 ditë si dhe duke e ruajtur në maksimum konkurrencën e lirë.

Me propozimet e reja përcaktohet në mënyrë decizive ndalimi i përdorimit të mjeteve matëse të pakalibruara gjatë shitjes së naftës dhe të derivateve të saj, si dhe shitja me shumicë personave të palicencuar.

Në fund, rëndësi e veçantë i është kushtuar inspektimit të tregut, duke propozuar fuqizimin e kompetencave të inspektoratit, si dhe është bërë ripërcaktimi i gjobave duke marrë parasysh llojin e shkeljes, si dhe veprimtarinë e shitjes me shumicë apo pakicë.

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij Projektligji në lëmin e ekonomisë dhe të tregtisë, si dhe me qëllim të rregullimit të tregut, e në veçanti mbrojtjen e konsumatorit, rekomandoj që Projektligji pas shqyrtimit të miratohet. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Në emër të Komisionit dhe të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka kërkuar deputeti Haki Shatri.

HAKI SHTRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në emër të Komisionit për Ekonomi e Tregti, Komisioni e ka shqyrtuar këtë ligj dhe konsideron se ka nevojë për këtë ligj. Argumentet për këtë i dëgjuam në ekspozenë e ministrit para pak sekondash.

Po ashtu, mendojmë si Komision që ligji i ri që propozon ndryshime dhe plotësime në ligjin në fuqi, ofron mundësi për eliminimin e mangësive të konstatuara gjatë implementimit të ligjit në fuqi dhe shpresojmë që ndërmjet dy leximeve, kur Komisionit t'i vijë në kompetencë, do t'i përmirësojmë ato që konsiderojmë të nevojshme.

Më lejoni të them që ky është mendimi i Grupit Parlamentar të LDK-së, të votohet ligji në parim.

KRYETARI: Faleminderit, deputet Shatri!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Safete Hadergjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës dhe gjatë shqyrtimit ka vërejtur se ky Projektligji për plotësim ndryshimin i ka disa të meta, disa mangësi, sepse ne kemi pritur që ky Projektligj duhet t'i përmirësojë disa të meta të cilat kanë ekzistuar në ligjin e mëparshëm për derivatet e naftës.

Kështu, nëse nisemi nga neni i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit në fuqi dhe ky nen ka të bëjë me qëllimin e këtij ligji, që thotë se qëllimi i këtij ligji është rregullimi i sektorit të naftës dhe të derivateve të naftës, që ka të bëjë me tregtinë, licencimin dhe monitorimin e rregullt të tregut me naftë dhe derivate të naftës përmes nxitjes së konkurrencës dhe eliminimit të praktikave të palejuara tregtare.

Nëse vërtet është ky qëllimi i plotësim ndryshimeve të këtij ligji, atëherë nëse i shikojmë të gjitha nenet e ndryshuara, mund të vijmë deri te përfundimi se nuk është luajtur ky rol gjatë plotësim ndryshimeve të këtij ligji, sepse të gjitha ndryshimet dhe plotësimet të cilat i janë bërë këtij ligji, janë bërë në atë drejtim që t'i hiqen disa kompetenca Këshillit të Naftës dhe ato kompetenca kryesisht janë kaluar tek ministri.

Në nenin 4.8, i cili hiqet, nenin 10, po ashtu hiqet, neni 11.4, 11.5 dhe 11.7 kanë qenë të përcaktuara kompetencat e Këshillit të Naftës që me këtë plotësim ndryshim i hiqen këto kompetenca këtij këshilli. Nëse Këshilli i Naftës është i panevojshëm, atëherë nuk e di pse duhet të ekzistojë në këtë ligj dhe nëse është i panevojshëm, atëherë të hiqet krejt, apo nëse është i nevojshëm për të ekzistuar, atëherë duhet të jenë të definuara edhe kompetencat e këtij këshilli se çka ka për detyrë të bëjë.

Sektori i naftës është një sektor shumë i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës, sepse sjell të hyra në buxhet, por njëkohësisht është edhe sektor përmes së cilit bëhen manipulime të shumta dhe përmes të cilit bëhet edhe rritja e ekonomisë informale. Ne duhet gjithsesi të kemi një ligj, i cili do të ndihmojë që të parandalohet ekonomia informale dhe njëkohësisht të kenë përfitime të ndryshme konsumatorët edhe sa i përket kualitetit të naftës apo çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me këtë sektor, të cilin duhet ta rregullojë ky ligj.

Megjithatë, në këtë ligj është paraparë nëse i shohim te përkufizimet, parashihet edhe formimi i një komisioni, i cili në atë përkufizim thuhet se ky komision vendos në shkallën e dytë kundër vendimit të Këshillit të Naftës. Këshilli i Naftës, sipas ligjit zgjidhet nga ana e Qeverisë dhe nuk e di tash se kush e përbën këtë komision, i cili do t'i bëjë shqyrtimin në shkallën e dytë të vendimeve të Këshillit të Naftës.

Megjithatë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka vendosur që ta përkrah, në parim, duke llogaritur se në komisionin funksional do të bëhet një punë shumë serioze dhe shumë profesionale, gjatë amendamentimit do të bëhen plotësimet e duhura që ligji të jetë funksional, i zbatueshëm dhe vërtet ta rregullojë këtë sektor shumë të rëndësishëm të ekonomisë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, Kryetar!

Përsëritet për të gjithë ministrat që janë prezentë këtu,

Dhe gjithë kolegë deputetë,

Duke marrë parasysh se Grupi Parlamentar i AKR-së ka shqyrtuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të tregtisë me çmim të derivateve të naftës, në Kosovë mund të them se është një projektligj që kaherë është dashur të bëhen ndryshime dhe plotësime. Duke marrë parasysh rregullimin e tregut, mbrojtjen juridike, eliminimin e ekonomisë joformale, që është pika më e ndjeshme për një zhvillim ekonomik të Kosovës, në përgjithësi, Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah, në parim, nismën e këtij ligji, mirëpo gjatë shqyrtimit të këtij ligji mund të shihet shumë qartë se gjitha interesat për zhvillimin e këtij sektori kanë për të qenë barë e ministrit. Se a do të mund të jetë ministri për kontrollin e naftës, të derivateve të naftës, cilësinë e tyre, 90 ditë ndërprerje do të thotë rezervat e naftës në sasi prej 5%. Diçka e mirë në këtë nen është në nenin 2 të këtij projektligji është se janë hequr të gjitha kompetencat që kanë qenë te Ligji 2004/6 për transportin e mallrave të rrezikshme, gjë që kanë mbetur kompetencë e Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, mirëpo prapë se prapë ky projektligj në tërësi, besoj që do të bëhet komplet gjatë shqyrtimit në komision dhe me gjitha vërejtjet e gjithë deputetëve brenda komisionit do të marrë formën e duhur, se është një ligj mjaft i ndjeshëm, ku mund të ketë deformime gjatë zbatimit të këtij ligji edhe mund t'i sjellë ekonomisë së Kosovës mjaft dëme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ethem Çeku e ka kërkuar fjalën.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës, në parim, i mbështet ndryshimet që janë propozuar. Në komisione, po ashtu, do t'i japim opinionet tona sa u përket disa ndryshimeve. Nga çështjet të cilat neve na preokupojnë më së shumti, është çështja që ka të bëjë me kontrollin e kualitetit të naftës që do të hyjë në Kosovë, do të thotë Ministria i ka përcaktuar dhe duhet t'i përcaktojë rregullat e aktualitetit që duhet të hyjë dhe gjobat që ka të bëjnë me çështjen e licencës.

Në përgjithësi, ne e mbështesim dhe do të shohim në komisionet parlamentare të japim kontributin tonë. faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë!

Në emër të LDD-së, deputetja Besa Gaxherri, e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë dhe ministra që jeni prezentë, Natyrisht, ky ligj ka qenë më se e domosdoshme të silllet në rishqyrtim apo plotësim dhe në këtë aspekt Lidhja Demokratike e mirëpret këtë ndryshim të këtij Ligji. Sa iu përket propozim ndryshimeve, lë për të dëshiruar, por megjithatë pasi ka ardhur në procedurë, unë mendoj se kemi shansin edhe të gjitha grupet parlamentare, por edhe deputetët pra, në përgjithësi, që vërtet këtë ligj ta bëjmë një ligj funksional, duke pasur parasysh që tregtia me derivate në Kosovë ka parregullsi dhe paligjshmëri totale. Andaj, unë mendoj se në këtë aspekt kësaj radhe këtë ligj duhet ta kompletojmë dhe vërtet të punohet ashtu si duhet. Lidhja Demokratike e Dardanisë e mbështetë në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Zylfi Merxha, e ka fjalën.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zotni Kryetar i Republikës së Kosovës!

Ju përshëndes juve, stafin tuaj, edhe ministrat që s'i kam këtu sot t'i shoh, që i dua shumë, pak janë, por i përshëndes.

Ne këtë ligj në parim e mbështetim, edhe pse s'kanë pompa romët, po mirë është, le të kalojë. Mirëpo, herën e dytë do ta plotësojmë aty ku kemi zbrazëtira. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet, qytetarë të gjithë jemi.

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, e do dikush fjalën? Nuk ka.

Në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, nuk ka. Atëherë, kalojmë te deputetët. Prej deputetëve, fjalën e ka kërkuar deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Veç desha të ndërhyjë këtu te kollumi i dytë. Flas për Projektligjin në gjuhën angleze, duhet patjetër që të ketë ndërhyrje për shkak se anglisht lexuesi apo anglishtfolësi po nëse nuk e dinë gjuhën shqipe, nuk e kupton se çka është shkruar këtu. Përkthyesi ka tentuar që t'i ngel besnik përkthimit tekstual, por në gjuhën angleze ka humbur kuptimin dhe shpeshherë ka vakuume të pakuptueshme dhe është shumë vështirë të kuptohet. Po them edhe një herë, kushdo që e lexon në gjuhën angleze, po nuk e diti gjuhën shqipe, nuk e

merr vesh. Dhe, kështu është nen pas neni. Në disa nene ka kuptim, por shumica e neneve janë të pakuptimshme, po them edhe një herë. Andaj, apeloj që t'i jepet dikujt që gjuhën angleze, nëse nuk e ka gjuhë të parë, të paktën që është më familjar se sa përkthyesi teknik dhe i cili e njeh këtë lëmi për shkak se ka edhe mangësi të tjera, po them, përdoret fjala "petroleum" aty ku duhet të përdoret "oil", përdoret "fuel" ku duhet të përdoret "oil" e tjera e tjera. Tash, për të mos e zgjatur, po them edhe një herë, mirë kishte për të qenë t'i jepet edhe një shikim këtij projektligji nga dikush që e njeh këtë industri dhe anglishten e ka më familjare se sa përkthyesi që e ka bërë këtë punë. Faleminderit!

KRYETARI: Shqip a ishte mirë, Driton? Faleminderit!

Për diskutim është deputetja e fundit e lajmëruar, deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Fjala ime do të jetë e shkurtër, por mendoj se ky ligj është shumë i rëndësishëm, duke marrë parasysh efektet që ka në ekonominë dhe tregtinë e Kosovës, por edhe në eliminimin e ekonomisë joformale dhe parandalimin e praktikave të këqija, si dhe nxitjen e konkurrencës dhe furnizimin e tregut me derivate të naftës të cilësisë së lartë. Këto do të ishin ndryshimet e propozuara. Shqetësimi im ka të bëjë se këto ndryshime kanë të bëjnë me ndryshimin e përgjegjësisë të këshillit, të cilat i kalojnë Ministrisë. Po ashtu, nuk është definuar sa duhet funksionimi i këshillit dhe një ndarje e qartë e përgjithësisë në mes të ministrit dhe këshillit.

Sipas mendimit tim, zgjidhja do të ishte më e mirë sikurse këshilli të kishte më shumë përgjegjësi se sa ministri, e jo që këto përgjegjësi të centralizohen. Po ashtu duke marrë parasysh rolin që ka komisioni funksionimi i tij të definohet qartë.

Prandaj, besoj që këto vërejtje do të merren parasysh në komisionin përkatës dhe se anëtarët e komisionit do ti shqyrtojnë zgjidhjet që i përmenda. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Duhet presim pak deri të kthehen deputetët që janë duke pirë kafe. Mirë, faleminderit! Tash i kemi të pranishëm 65 deputetë, kështu që mund të hyjmë në procedurën e votimit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash:

Kush nuk ka kartelë? 2 pa kartelë që votojnë "për". Mirë, të tjerë s'ka.

Konstatoj se me 54 vota "për", 1 "kundër" dhe 4 abstenime, miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivatet e naftës në Kosovë.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, ngarkohen këto komisione:

1. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional,
2. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa,
4. Komisioni për Komunitete, dhe
5. Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Dhe, në radhë është pika e shtatë e rendit të ditës:

7. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve

Komisionet e përhershme parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit numër 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e Projektligjit dhe amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Komisioni për ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të shkojmë në votim, fjalën e ka kërkuar deputeti Driton Tali. Jo, mirë! Këtu e pata të regjistruar unë. Atëherë vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara.

Amendamenti 1.

Lus regjinë të përgatitet për votim dhe votojmë tash:

Pa kartelë 2 vota janë “për”, pa kartelë “kundër” dhe abstenim, s’ka. Faleminderit!

Konstatohet se me 52 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Regjia, le të përgatitet për votim, votojmë tash:

(Ndërhyrje e deputetit Driton Tali)

Kemi hyrë në votim. Driton, ke të drejtë po je vonuar.

Konstatohet se me 48 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Tash Driton, a e do fjalën. Urdhëro! Për amendamenti 3.

DRITON TALI: Unë desha edhe për amendamentin 2, zoti Kryetar, po nuk ma dhatë mundësinë. Te rreshti i dytë, pasi ma dhatë fjalën, tash po flas për amendamentin 2, thuhet, apo po i lexoj veç dy rreshtat e parë: “Tregtari është i detyruar që sipas përcaktimit të konsumatorit, brenda mundësive”, duhet të hiqet kjo “brenda mundësive”, por “duhet mallin me gabim ta ndërrojë”, d.m.th. pa “brenda mundësive” por “patjetër”, sepse flasin për të drejtën e konsumatorit.

Te amendamenti 3. pika 4. thuhet: “Personi i huaj që ka vendqëndrim në Republikën e Kosovës i gëzon të gjitha të drejtat si konsumator”. Kjo është apriori e vetëkuptueshme. Çdo konsumator është i barabartë dhe i ka të drejtat, andaj qoftë i huaj me leje qëndrimi, pa leje qëndrimi, i ka të drejtat e konsumatorit dhe mendoj që kjo pikë duhet të hiqet krejt, ngase kemi të bëjmë me konsumatorë. Konsumatori edhe nëse është në pushim në

Kosovë, për vizitë një javë ditësh apo njëditëshe, është konsumatorë dhe i ka të gjitha të drejtat si konsumatorët e tjerë. Faleminderit! Nuk mund të bëjmë ne diskriminim të konsumatorëve.

KRYETARI: Faleminderit, shumë!

Do të thotë, amendamenti 3. pika 4 të shlyhet.

Një herë të shkojmë te propozimi i Komisionit.

Komisioni, a pajtohet për këtë, mendoj që ka të drejtë. Sipas radhës, shkojmë të votojmë për propozimin e komisionit funksional.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

“Për” pa kartela, 1 votë, pa kartela “kundër” 1. Faleminderit!

Konstatohet se me 38 vota “për”, 19 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

“Për” pa kartela 2 vota, pa kartela “kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Konstatohet se me 56 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Para se të votojmë, fjalën e ka kërkuar deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Unë propozoj që edhe këtë amendament ta heqim, se kjo nuk tregon asgjë, pos që është deskriptive, është shpjeguese. Thotë: “Lirimi i mallrave sipas paragrafit 1 të këtij neni të shumtën e rasteve bëhet për shkak të përfundimit të sezonit”. Nuk është ligj ky, unë s’di pse e kanë shtuar këtu. Lirisht mund ta heqim dhe kurrëgjë nuk ndryshon. Është e vetëkuptueshme, është punë për ndërmarrësin kur bëhet lirimi i mallit dhe nuk ka sens ekonomik. Faleminderit!

KRYETARI: Bahri Hyseni e ka kërkuar fjalën.

BAHRI HYSENI: Edhe unë mendoj, zoti Kryetar, që duhet marrë propozimin shumë singlerisht dhe duhet të hiqet, sepse është një udhëzim dhe ne po bëjmë ligje, nuk po bëjmë udhëzime. Faleminderit!

KRYETARI: Megjithatë, ne e kemi propozimin e komisionit funksional. Shkojmë në votim sipas propozimit të komisionit funksional, nëse nuk votohet, shkojmë në votimin tjetër.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 29 vota “për”, 25 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 45 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 53 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Më falni, fjalën e ka kërkuar deputeti Adem Hajdaraj.

ADEM HAJDARAJ: Është një lidhje fjalish këtu e pakuptimtë, se nëse krahasohet me të serbishtes, është fjalë për fjalë e kopjuar, e përkthyer. Që, për shembull, Amendamenti 9, thotë: “Në vend të subjektit që i promovon mallrat ose shërbimet e veta, përgjigjen agjencitë publicitare sipas këtij ligji për publikimin e tyre të padrejtë, mashtrues dhe krahasues”, e unë mendoj se duhet të jetë: “Sipas këtij ligji subjekti që i promovon mallrat dhe shërbimet e veta, nuk është përgjegjës për publikim të padrejtë, mashtrues dhe krahasues, por përgjegjësitë janë të agjencive publicitare”. Krejt atëherë nuk është në përputhje me fjalitë e mëparshme serbisht, nuk është e përkthyer direkt dhe kryefjala, kallxuesi këto shkojnë ma drejtë kështu. I ftoj deputetët që ta votojnë këtë ndryshim se është në rregull.

KRYETARI: Shumë faleminderit!

Shkojmë sipas propozimit.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 40 vota “për”, 15 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 9 i Komisionit.

Ju e dini, prioriteti gjithnjë është i komisionit funksional, të tjerët kanë të drejtë të bëjnë amendamente në emër të vet dhe nuk janë bërë, tash është vonë.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 56 vota “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Kush e kërkon fjalën për amendamentin 11, mund t’ia japë. Fjalën e ka kërkuar deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: zotëri Kryetar!

Ky tekst do të duhej të fshihej për shkak se e tregon vetëm një nga teknikat e mundshme për lidhje të kontratës dhe me këtë dokument nuk përcaktohet asnjë mënyrë e kontraktimit. Prandaj, kjo do të duhej të fshihej se me të vërtetë është krejtësisht e panevojshme. Këtu është fjala për kontraktimin në largësi, me internet, ajo është një teknikë dhe nuk është ky dokument që i rregullon kontratat. Propozoj të fshihet.

KRYETARI: Zoti deputet, për cilën amendament e ke fjalë?

RIZA SMAKA: Këtu, neni 14, ... vazhdon amendamenti 10.

KRYETARI: Jo, të 11-tin e kemi tash, amendamentin 10 e votuam.
Shkojmë tutje.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 46 vota “për”, 1 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 56 vota “për”, 2 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 2 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 53 vota “për”, 3 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15 dhe i fundit.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, 3 “kundër” dhe 3 “abstenime”, miratohet amendamenti 15.

Dhe, tani votojmë Ligjin në tërësi.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, 1 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve, me amendamentet që i votuam paraprakisht.

Pika e radhës, pika e tetë:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes

Komisionet parlamentare të përhershme kanë shqyrtuar Projektligjin për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes dhe Kuvendi i kanë rekomanduar miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Fjalën e ka kërkuar kryetari i Komisionit, deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Komisioni Parlamentar për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka kryer punën e vet dhe me kohë i ka proceduar të gjitha amendamentet të cilat ka menduar se do ta begatojnë ligjin në fjalë. Mirëpo, duke pasur parasysh që zhvillimet të cilat kanë ndodhur dhe lirisht mund të them që mungesën, ndoshta, fillimisht të përcaktimit të konceptit zhvillimor të Qeverisë së Kosovës në raport me zhvillimin ekonomik dhe me energjetikën në vend, ka

dalë ndërkohë një propozim e cili ka ardhur që ka të bëjë me nenin 11 pika 1 dhe, pikërisht, nëse jeni të pajtimit dhe besoj që edhe grupet parlamentare do ta përkrahin një propozim që ky Ligj ka nevojë edhe për një konsultë të vogël brenda Komisionit parlamentar, në mënyrë që të procedohet në seancën e radhës. Nuk ka të bëjë me amendamentet të cilat janë propozuar deri më tash, po ka të bëjë me një propozim i cili ka ardhur lidhur me ligjin, i propozuar nga Qeveria, për nenin 11.1, që ka nevojë edhe për një konsultencë edhe me Qeverinë, edhe me partnerët të cilët po e ndihmojnë punën e qeverisë.

Prandaj, kisha propozuar, në emër të Komisionit, që shqyrtimi i amendamenteve të shtyhet për seancën e radhës, sepse ka nevojë edhe për një konsultë brenda Komisionit, me Qeverinë, gjegjësisht me Ministrinë e Mjedisit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ju e dëgjuat kryetarin e Komisionit, ai po kërkon edhe një kohë shtesë, po megjithatë për këtë duhet të vendos Kuvendi.

Regjia le të përgatitet për votim dhe votojmë tash kërkesën e kryetarit të Komisionit për shtyrjen e kësaj pike të rendit të ditës për seancën e radhës.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 5 “kundër” dhe 2 abstenime, do të thotë, shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave në bashkëpronësi

Komisionet e përhershme parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave në bashkëpronësi dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raporti me rekomandime i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve. Nuk ka të lajmëruar, andaj shkojmë në procedurën e votimit.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 50 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

Unë kërkoj që vërtet të lajmëroheni me kohë, para se të përfundojë votimi i amendamentit, do të thotë, të bëhet me kohe ose para se të qitet në votim një amendament. Armend, e ke fjalën për amendamentin 2 a 1, njëshi shkoi. Për dyshin, urdhëro! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë e pata, do me thanë, prej fillimit, ndoshta duhet të shikohen me vëmendje këto ndryshime, apo unë personalisht si deputetë kam nevojë që, ndoshta, nga komisioni funksional të dëgjoj disa arsyeshmëri që janë bërë, disa ndryshime të amendamentit, të cilat nuk janë në përputhshmëri me njëra-tjetrën.

Po ia filloj prej amendamentit numër 2, nëse më lejohet, zoti Kryetar, te qëllimi, ku është ndërruar qëllimi i rregullimit, do me thanë, të ligjit. Po e lexoj, nëse nuk është e tepërt: “Ky Ligj zbatohet për të gjitha ndërtesat të cilat kanë disa njësi dhe shërbejnë për banim” ose ushtrim të aktiviteteve afariste, kjo është shtua, “si dhe që janë në pronësi të më shumë se një pronari”. Kjo ndërlidhet me amendamentin numër 9, ku është hequr apo fshirë paragrafi 5 dhe 6, në të cilat thuhet: “Komuna me aktet e veçanta përcakton veprimtaritë e lejuara që mund të kryhen në njësitë e ndërtesave”. Kjo jep për të nënkuptuar se, në katin e 7 apo 8 të një banese mund të lejohet dikush të hapë zyre apo një aktivitet afarist vetëm me nënshkrimin e 1/5 së bashkëpronarëve. Kjo është vërejtja numër 1 që është në kundërshtim edhe me ligjin, është mirë që edhe ministri i Ministrisë kompetente ndoshta mundet të ndërhyjë këtu.

Çështja tjetër, është bërë ndryshimi i administrimit në banesë rrënjësisht, ku me një nen hiqet, do me thanë, kuvendi i pronarëve, ndërsa në nenin tjetër pasues, konkretisht në nenin 24 të ligjit në fjalë, flitet “për udhëheqjen dhe marrjen e vendimeve në kuvendin e pronarëve”. Të mos bëhem i tepërt t’i lexoj, ndoshta nuk është e shumë. Është edhe te Këshilli administrues, hiqet Këshilli administrues, ndërsa prapë në ligj mbetet, flitet se kompetencat i jepen Këshillit administrues, ndërsa këtu thotë pronarët mund të zgjedhin Këshillin administrues, i cili është fshi në amendamentin 22. Prandaj, nuk e di, apo grupi punues, apo komisioni i cili ka punuar, por kjo duket, po të shikohet në shikim të parë, duket se këto ndryshime janë bërë për një grup të interesave të caktuara. Do me thënë, mundet dikush banesat t’i shndërrojë në objekte afariste, ku t’i teket, ose shitore në katin e 7, 8, 11 sipas mundësive dhe qytetarët janë shumë të pa aftë. Ceket aty, do me thanë, është anashkaluar edhe gjykata, ndërsa thotë se mund të ankohet edhe te Ombudspersoni, apo te Avokati i Popullit.

KRYETARI: Faleminderit!

Po, mendoj që në amendamentin 1 thotë që Kuvendi i pronarëve zëvendësohet në tërë ligjin me Bashkësinë e pronarëve. Megjithatë, unë kisha kërkuar një sqarim pasi po e lyp, nga kryetari i komisionit, deputeti Lulzim Zeneli, e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, Kryetar!

Komisioni e ka kryer punën e vet dhe në mënyrë shumë profesionale së bashku edhe me Ministrinë përkatëse ka amenduar ligjin në fjalë. Po duhet ta caktojmë se ky ligj ka të bëjë me shfrytëzimin dhe administrimin e ndërtesës ku është e definuar pronësia, ekzistojnë pronarët. Shumë ndërtesa, e dimë ne, ku ekziston bashkëpronësi, kanë edhe objekte afariste dhe të gjitha këto bëhen me një plan urbanistik, që pretendojmë që duhet të ekzistojë. Kemi të bëjmë me shfrytëzimin e hapësirës së përbashkët dhe ndërtesa ka Bashkësinë e pronarëve, e cila zgjedh Këshillin administrues. Gjithçka është e definuar. Nëse dikush ka për nenin, zoti Zemaj tha diçka sa u përket shumë neneve, shkojmë me rend.

Në nenin 2, nëse ka dikush rreth nenit 2 diçka, mund të diskutojmë, shkojmë me rend, nenin 3, 4, me radhë. Prandaj, gjithçka është e sqaruar, mirëpo kjo ka të bëjë vetëm me

shfrytëzimin, administrimin e hapësirës, e cila është e përbashkët për të gjithë pronarët në kuadër të një ndërtese kolektive, nuk kemi të bëjmë këtu as me definimin e pronësisë, as nuk ka të bëjë, se e kemi ligjin, që po pret dhe është në procedurë të miratimit të dytë, ku ka të bëjë me Ligjin për privatizimin e banesave, ku ekziston e drejta banesore, se tash e kemi në procedurë. Prandaj, mos t'i ngarrojmë këto çështje, nëse ka dikush për nenin në fjalë, mund të diskutojmë dhe të debatojmë deri në sqarimin e plotë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shkojmë më tej, nuk kemi debat.
Urdhëro, Armend, mere fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Zoti Kryetar,

Pa të keq, kjo është për hir se është shkelje ligjore. Amendamenti numër 9, kryerja e veprimtarive të lejuara, po 2-shi lidhet me amendamente të tjera, zotëri, unë po ta lidhi me amendamentin numër 9, i cili është fshi, kryerja e veprimtarive të lejuara në njësitë e ndërtesës kanë qenë mirë të përcaktuara dhe të gjitha janë fshi, ka mbetur pëlqimi i pronarëve duhet të jetë i verifikuar tek organet kompetente. Ndërsa, këtu është nxjerr jashtë loje edhe komuna, edhe gjykatat, unë të kisha lutur, lexoje edhe një herë nëse s'është e tepërt.

KRYETARI: Urdhëro, deputet Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: ... mund të shprehet. Mirëpo, kur kemi të bëjmë me çështje ku është e definuar e drejta pronësore dhe shkon në përputhje të plotë me rregullativën urbanistike, nuk ka të bëjë këtu diçka që ka të bëjë me administrimin dhe shfrytëzimin e banesës apo të hapësirës në bashkëpronësi banesore. Prandaj, komuna nuk është kompetencë, edhe kështu është vlerësuar që komuna të merret me çështjet e shfrytëzimit të hapësirës në bashkëpronësi të një ndërtese të caktuar. Dhe, të lutem, kjo është çështje që do ta rregullojnë bashkëpronarët përmes Këshillit administrues dhe kemi të bëjmë me një çështje e cila është shumë teknike, shumë administrative dhe nuk është aspak ligjore, në këtë rast. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe unë i bashkëngjitëm mendimit të deputetit Zemaj, ka plotësisht të drejtë, sepse këto amendamente të cilat i kemi para vetes, në shumë pjesë janë në kundërshtim me njëra-tjetrën dhe këtë ligj e bëjnë shumë të pazbatueshëm, sikurse edhe mund të shkaktojnë probleme brenda vetë këtyre njësive, krijojnë hapësira shumë të mëdha. Prandaj, sugjerimi im është që ky projektligj, këto amendamente të kthehen mbrapa edhe njëherë në komision, të shqyrtohen mirë. Unë vetëm po e përmendi nenin, shikojeni amendamentin 21, se çka flet amendamenti 21 dhe çka flasin amendamentet e tjera. Prandaj, zgjidhja e vetme konsideroj se është që të kthehet prapa edhe një herë që të rishikohet në komision dhe pastaj të vijë si i plotë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

I kemi edhe 3 deputetë që janë lajmëruar, me radhë po shkojmë. Deputetja Elhame Hetemi e ka kërkuar fjalën, pastaj Ardian Gjini.

ELHAME HETEMI: Faleminderit, Kryetar!

Pajtohem me vërejtjet sepse ka në këto amendamente, ose të paktën kur është bërë amendimi, çështje teknike. Nëse e shohim amendamentin numër 1, këtu në amendament thuhet në tërë tekstin e projektligjit termi: “Kuvendi i pronarëve” zëvendësohen në “Bashkësi e pronarëve” dhe të paktën në të shkruar teknikisht nuk është dashur në asnjë amendament tjetër të përsëritet termi apo emërtimi “Kuvend i pronarëve”. E pranoj si gabim të lëshuar.

Ndërsa, për vërejtjet tjera në amendime, unë ju kisha sugjeruar të gjithë deputetëve, edhe për këtë Projektligj, edhe për projektligje të tjera, e marrin materialin shumë më herët dhe paraprakisht amendimin ose propozim amendimet le t'i bien në komisionin funksional dhe jo në..., propozim amendamentet i bien qoftë në komisionin funksional ose në Kuvend para se t'i japin këtu për këtu, sepse është shumë problem tash të shqyrtohen në Kuvend dhe të jepen sqarime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Ardian Gjini, le të përgatitet deputeti Bahri Hyseni.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Nëse mund t'i ndihmoj Kuvendit me disa çështje këtu, do të provoj, realisht.

Mendoj se deputeti, Lulzim Zeneli, i tha disa çështje të cilat janë të vërteta. Janë 2 ose 3 premisa prej të cilave duhet të nisem edhe po ju them se është një kohë shumë e gjatë që ky projektligj është nëpër duar të Qeverisë dhe të Kuvendit, me siguri e kuptoni që edhe unë e kam kaluar një pjesë të punës me të. Çka tentohet të kryehet me këtë ligj, është kështu:

Fillimisht supozohet që prona është legale, është e legalizuar, është e ndërtuar me leje, që do të thotë se kuvendet komunale, në cilindo prej komunave të Kosovës e kanë dhënë lejen për objektin dhe e kanë përfunduar destinimin në objekt. Tani, pika tjetër që synohet të rregullohet, në fakt, çka synohet të rregullohet, duke pas parasysh këtë premisë, është se në rast se do të ketë ndryshim destinimi të cilësdo pjesë të objektit të përbashkët, duhet të ketë pajtueshmëri të pronarëve. Mendoj se komisioni ka bërë mirë që e ka ndryshuar termin “kuvend” në “bashkësi” për shkak se fjala “kuvend” ka konotacion ndryshe prej asaj çka synohet të rregullohet, si pikë e parë.

Çështja tjetër që synohet të rregullohet me këtë ligj, është mirëmbajtja e objekteve. Është e vërtetë që komunat e marrin një pjesë të përgjegjësisë për mirëmbajtje, qoftë të elevatorëve, qoftë të korridoreve, qoftë të hapësirave tjera të përbashkëta, të cilat ekzistojnë si të përbashkëta nëpër objekte të banimit kolektiv.

Dhe, çështja e fundit, për të cilën duhet të kemi shumë kujdes që të tentohet të rregullohet këtu, është që gradualisht të kalohet prej sistemit, ku pronar ka qenë shteti në objektet banesore, në atë ku pronarë janë pronarët e banesave, qoftë edhe të sipërfaqeve ose të lokaleve afariste të cilat ekzistojnë në banesa. E dimë që janë çështje kontraverze, e dimë që ka shumë elemente të cilat i bëjnë edhe njerëzit edhe deputetët që të kemi shumë kujdes me këto çështje për shkak se kanë investuar shumë, kanë paguar shumë dhe kanë probleme sot. Mirëpo, duhet të kryhen punët një nga një dhe të mos ketë konfuzion mes çështjeve të cilat tenton t'i rregullojë ky ligj dhe çështjeve të cilat i rregullojnë ligjet tjera, për shkak se nëse kuvendi i komunës jep leje ose ka dhënë leje dhe pëlqim për banesë, ndryshimi i destinimit të asaj banese do të jetë objekt i ligjit ose objekt i ligjeve tjera.

Mendoj se tentova të ndihmoj, mendoj se mendimi im është se duhet të mbetet kështu si e ka sjellë komisioni, të paktën deri këtu. Janë disa vërejtje më vonë, mirëpo nuk janë substanciale dhe nuk e prishin esencën e ligjit, as qëllimin për çka është sjellë ligji në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet Bahri Hyseni, a ke të shtosh diçka të re? Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë do të jem i shkurtër, mirëpo do të ngreh çështjen që raporti është paksa i paqartë dhe ne mund ta kalojmë, nuk është problem, por kuptoni Zyra për standardizim do ta ketë problem të bëj ligj.

Po filloj me amendamentin 3. Ne po e kuptojmë që kanë dashur t'i riformulojnë definicionet, mirëpo kanë ndryshuar, nuk e ka riformuluar, po kanë ndryshuar, për shembull, bashkëpronësi, ndërtesa e banimit dhe bashkëpronësi, e kanë ndryshua plotësisht dhe amendamenti duhet të jetë i qartë me qëllim që Zyra për standardizim ta dijë a po riformulohet apo po ndryshohet plotësisht.

Mandej, për shembull, vjen “pronar”, është e njëjtë sipërfaqja e shfrytëzueshme është e njëjtë, çka duhet të bëjmë me atë. Vijnë deri te amendamenti 9. Amendamenti 9 që po e ngreh zoti Zemaj, që e ka me të drejtë, thotë, neni 8, paragrafi 3 riformulohet. Kur e merr dhe e lexon, thotë: “pëlqimi i pronarëve duhet të jetë i verifikuar te organet...” Çka? Nuk është i riformuluar, sepse kështu shkruan edhe në paragrafin 3. Çështja është, a ta marrë mandej Zyra për standardizim pjesën tjetër, a fshihet apo nuk fshihet, duhet të jetë amendamenti i qartë. Ne mund ta kuptojmë këtu, ata nuk e kuptojnë atje.

Çështja tjetër, paragrafi 56 fshihet, në rregull këtu është. A është amendament tjetër, duhet të jetë e qartë, se në fillim ke thënë riformulohet, më pastaj 56 fshihet. Nuk ka mundësi tash me një amendament edhe diku të riformulohet, edhe diku të fshihet. Amendamenti duhet të jetë i qartë, fshihet apo riformulohet. Prandaj, konsideroj, unë e kuptoj që komisioni e ka bërë punën e mirë, mirëpo raporti si raport është bukur i paqartë.

KRYETARI: Faleminderit, jo s'ke nevojë ti hiq, se na kemi ardhur për t'i votuar amendamentet. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi në rekomandimin e dytë, në pjesën e fundit të fjalisë, thotë: “mund të procedohet për miratim në Kuvendin e Kosovës”. Prandaj, ne shkojmë dhe e miratojmë. Amendamentin e parë e kemi votuar, vazhdojmë me të dytin.

Amendamenti 2.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 43 vota “për”, 13 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Në radhë është amendamenti 3.

Për këtë amendament fjalën e ka kërkuar deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe ky treshi është logjika e dyshit, të cilin ne e votuam. Amendamenti i dytë në të vërtetë është përplotësim i lëndës dhe i rregullimit, qëllimi dhe rregullimi, sepse është amendament i shtuar, dyshi. Në frymën e këtij, të treshit, të cilin do ta votojmë ose s'do ta votojmë tani, është mirë vetëm të dihet që është një ndryshim i kuptimit, nuk është variacion, është ndryshim. Varianti i projektligjit i quan pjesët bashkëpronësi, pjesët e përbashkëta, jo banesat njëra me tjetrën, ajo i bien kulmi, korridori, toka ku është ndërtuar ndërtesa. Variacioni i propozuar “bashkëpronësi” quan njerëzit që e kanë banesën pranë e pranë. Do me thënë, kemi kuptim teksti, si është, kemi ndryshim total të kuptimit, është punë tjetër nëse deputetët donë ta votojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ju e dini që na votojmë propozimin e komisionit funksional. Nëse nuk shkon propozimi, pastaj mbetet qysh është. Atëherë, votojmë për amendamentin e tretë.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 30 vota “për”, 27 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 41 vota “për”, 15 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 44 vota “për”, 10 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 43 vota “për”, 13 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 43 vota “për”, 11 “kundër” dhe 7 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 42 vota “për”, 10 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 41 vota “për”, 11 “kundër” dhe 10 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 41 vota “për”, 11 “kundër” dhe 7 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 45 vota “për”, 12 “kundër” dhe 7 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Fjalën e ka kërkuar Ramadan Avdiu. Për cilin amendament po e kërkon fjalën? Për të 14-tin. Hala nuk kemi shkua atje.

Amendamenti 12.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 45 vota “për”, 11 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 43 vota “për”, 11 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Fjalën e ka deputeti Ramadan Avdiu, për amendamentin 14.

RAMADAN AVDIU: Këtu, mendoj se amendamenti 14 do të duhet të rishikohet për arsye se në rast të mospajtimit ose mospëlqimit me planin e mirëmbajtjes, cilido pronar të shfrytëzimit të një banese ose të një objekti në bashkëpronësi i jepet mundësia që t’i drejtohet Ombudspersonit ose Avokatit publik. Kam përshtypje se nuk e ka pasur të qartë komisioni se cili është roli dhe mandati i Avokatit publik të komunës. Ai nuk do të mundet, do me thanë, të ndërmjetësojë në rregullimin e problemit ose harmonizimin e ujdisë së banorëve të cilët e bëjnë planin për mirëmbajtjen e ndërtesës. Prandaj, është më mirë të mbetet gjykata se sa Avokati publik ose Ombudspersonit, sepse këta nuk do të mund t’i zgjidhin problemet ose mospajtimet të cilat do të mund të dalin brenda për brenda bashkëpronarëve ose edhe me rregulloret në rast se komuna do të mund t’i nxjerrë lidhur me shfrytëzim apo me mirëmbajtjen e banesave. Në rast se pronarët nuk pajtohen plotësisht, Avokati publik nuk do të mund t’iu ndihmojë. Prandaj, është më mirë t’i mbetet gjykatës se sa të futet Avokati publik që nuk është as rol, as mandat i tij.

KRYETARI: Faleminderit, shumë! Shumë mirë e ke, por ne e kemi amendamentin 14. Nëse voton Kuvendi “kundër”, atëherë e votojmë propozimin tënd, ose mbetet si është në ligj, se është dashur të bësh amendament. Pse nuk e keni bërë? Nëse e votoni amendamentin, shkon, nëse nuk e votoni, mbetet qysh është. Prandaj, shkojmë në votim.

Amendamenti 14.

Votojmë tash: Votoni kundër! Prandaj, ju lutem, ju vendosni për votim.

Konstatohet se me 22 vota “për”, 36 “kundër” dhe 6 abstenime, nuk votohet amendamenti 14.

Vazhdojmë. Deputet, Ibrahim Makolli, e ke kërkuar fjalën për amendamentin 15? Faleminderit shumë!

Amendamenti 15.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 39 vota “për”, 16 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 38 vota “për”, 12 “kundër” dhe 7 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 36 vota “për”, 13 “kundër” dhe 7 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Fjalën e ka kërkuar Bahri Hyseni, për amendamentin 18.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

E lexuat raportin që e kemi dhënë për bazë juridike, nuk e kemi dhënë për amendamente, sepse amendamentet nuk i vinë komisionit funksional. Dhe, dash po dal te amendamenti 18, po e lexoj: Titulli i Kreut XIV definohet: “Organet vendimmarrëse në ndërtesën e banimit dhe ndarja e përgjegjëseve” çka, çfarë amendamenti, nga kjo pjesë s’kemi kurrëgjë, çka po definohet, a po plotësohet. Por, ne nuk po shohim titull, në kreun tjetër, kah kjo pjesë. Prandaj, ju kisha lutur, nuk e thamë me qëllim, se ne po bëjmë një ligj për të cilin prandaj po kemi probleme edhe nuk po dekretohen, edhe Zyra për standardizim, çka po definojmë, unë nuk po shoh, se s’po e shoh edhe atë pjesën tjetër, prandaj e ngrita shqetësimin, ju po i votoni, mirëpo le të shkojë puna kështu.

KRYETARI: Faleminderit!

Amendamenti 18.

Unë po e lexoj në tërësi: Titulli i Kreut të IV definohet: “Organet vendimmarrëse në ndërtesat e banimit dhe ndarja e përgjegjëseve” ky është titulli i Kreut IV. Komisioni funksional, kryetari e ka fjalën. Deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Zoti Kryetar,

Ju e lexuat se është shumë qartë e definuar Kreu i IV, nuk ka këtu diçka të paqartë, nëse ky titull nuk nënkupton ndarjen e përgjegjëseve, nuk përputhet me diçka më vonë, atëherë mund të bisedojmë.

KRYETARI: Krahasimi, krahasimi nuk është, megjithatë. Krahasimi tabelor nuk është.

LULZIM ZENELI: Nuk ka pasur krahasime hiq, se ne e kemi definuar Kreun IV.

KRYETARI: E, mirë atëherë!

LULZIM ZENELI: Po, amendament i ri është. Po gabim, ani mund të jetë gabim teknik, që thotë definohet. Titulli i Kreut IV, thotë: definohet.

KRYETARI: Faleminderit! Edhe unë jam dakord me këtë që po thua ti. Prandaj, vazhdojmë.

Amendamenti 18.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 38 vota “për”, 25 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 34 vota “për”, 19 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 39 vota “për”, 19 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 38 vota “për”, 19 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 21.

Urdhëro, deputeti Armend Zemaj, e ka fjalën, veç ta dini që sot e keni tepëruar, se amendamentet ju e dini qysh bëhen, amendamentet bëhen me shkrim dhe vinë këtu. Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, Kryetar!

Është e vërtetë, ndoshta po e teprojmë, por ne e votuam një amendament ku hiqet tërësisht fjala “kuvendi i pronarëve”. Në ligjin bazë që unë e kam përpara, në nenin 24 shkruan: “udhëheqja dhe marrja e vendimeve në kuvendin e pronarëve”. Do me thënë, është një nen i cili bie ndesh, që u mbet në ligjin bazë, i cili flet tash për udhëheqjet dhe marrjen e vendimit në një kuvend i cili nuk ekziston, që ne e votuam, e hoqëm prej ligjit me amendamentin 19.

KRYETARI: Ju lutem, amendamenti 1 e pastron ligjin nga “kuvendi” në “bashkësi”. Prandaj, e jep amendamenti numër 1, kështu që mos u merrni tash me atë, kur ajo është sqaruar në amendamentin numër 1.

Amendamenti 22.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 35 vota “për”, 19 “kundër” dhe 8 abstenime, Kuvendi miraton amendamentin 22.

Amendamenti 23.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 41 vota “për”, 17 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 35 vota “për”, 18 “kundër” dhe 8 abstenime, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 39 vota “për”, 15 “kundër” dhe 8 abstenime, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 40 vota “për”, 15 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti i parafundit 27.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 43 vota “për”, 13 “kundër” dhe 8 abstenime, miratohet amendamenti 27.

Amendamenti i fundit - 28.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 39 vota “për”, 15 “kundër” dhe 9 abstenime, miratohet amendamenti i fundit - 28.

Tani votojmë tekstin në tërësi me amendamentet e miratuara.

Votojmë tash: Faleminderit!

Konstatohet se me 39 vota “për”, 27 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet Ligji për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave në bashkëpronësi.

Pika e dhjetë e rendit të ditës.

10. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarit në Komisionin për Ankesa Pronësore

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka shqyrtuar propozimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për emërimin e një anëtari në Komisionin për Ankesa Pronësore dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit, së bashku me dokumentacion, iu është shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetarin e Komisionit, zotin Bahri Hyseni, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Raportin me rekomandime.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, duke u bazuar në nenet 10, 11 të Ligjit 03L/079 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjedhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, në pajtim me përfundimet e Kryesisë së Kuvendit, të datës 3 mars 2009, përkitazi me shqyrtimin e propozimit që ka ardhur nga Gjykata Supreme e Kosovës, nga kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, i rekomandon Kuvendit të Kosovës kandidatin Adem Vokshi, që të jetë anëtar i Agjencisë Kosovare për zgjidhjen e kërkesave pronësore.

Kandidati i plotëson të gjitha kriteret, edhe në aspektin profesional, edhe në aspektin e përgjithshëm, ashtu siç është paraparë edhe në ligj, në nenin 10, paragrafin 7.1.

Prandaj, i rekomandojmë Kuvendit të Kosovës që ta aprovojë propozimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të grupeve parlamentare, a ka nevojë për deklaram? Nuk ka. Atëherë, shkojmë e votojmë rekomandimin e Komisionit.

Votojmë tash: Faleminderit!

Konstatohet se me 60 vota “për”, 1 “kundër” dhe 4 abstenime, Kuvendi emëroi Adem Vokshin, anëtar në Komisionin për Kërkesa Pronësore, me mandat njëvjeçar. Faleminderit!

Pika e njëmbëdhjetë dhe e fundit e rendit të ditës:

11. Propozimi për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se Grupi Parlamentar i SLS-së ka vendosur që anëtar në Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, në vend të deputetes Radmila Vujoviq, të emërohet deputeti Dragan Dimiq.

Dhe, me këtë përfundojmë seancën e sotshme. Mirë u pafshim në seancën e radhës.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve